

BIBLIOTEKA  
SHTEFIT

854-1  
A 73

FATOS ARAPI

DIKUSH ME  
BUZEQESHTE

Redaktor **Adriatik Kallulli**  
Kapertina nga **Ali Oseku**

# I

Redaktorja diçka po fliste me vete dhe as që e ndjeu trokitjen në derë. Vetëm kur unë hyra brenda, ajo ngriti kryet.

— Ti je? Kemi ditën e dorëzimit të materialit të revistës.

— E shoh — i thashë unë.

— Do të më falësh.

— Të lutem...

Ajo filloi përsëri të merrej me shkrimet dhe fotografitë e shpërndara mbi tavolinë. Unë nxora prej raftit pranë një revistë dhe nisa ta shfletoja. Nuk e dija as vetë përse kisha shkuar atje, po tanimë na është bërë shprehi që herë pas here të dalim redaksive. Takojmë ndonjë shok, shkëmbejmë ndonjë fjalë, dhe sikur qetësohemi.

Pa ngritur kryet nga materiali që po lexonte, redaktorja më zgjati një fotografi të porsastampuar. Ishte një vajzë e re, tekstiliste. Para tezgjaheve ajo gjoja punonte, por në të vërtetë pozonte.

— Si të duket?

— S'më pëlqen — i thashë unë dhe e lashë përsëri fotografinë mbi tavolinë.

— Si kështu?! — ajo përnjëherësh e la punën

dhe u kthye nga unë. — Si kështu? Ne e kemi zgjedhur për kopertinën e numrit.

— Është një bukuri që s'thotë asgjë... Ç'të thotë? — E pyeta unë. Duhej të kishit zgjedhur një bukuri të heshtur. Ato flasin shumë... dhe flasin vërtet.

— Ska gjë... e ndërrojmë... Ah! — tha redaktorja duke hedhur fotografinë mbi tavolinë. — Ti kurrë s'ke shkruar për revistën tonë. Kësaj rradhe nuk na shpëton dot.

Ajo u ngrit nga karriga dhe filloi të kërkonte midis materialit të shumtë. Më në fund gjeti një fletë të shtypur. Emra dëshmorësh të ndryshme. Disa prej atyre emrave ishin të padëgjuar për mua. Të tjerë të njohur. Të njohur? Sapo shikimi im binte mbi ta, ndjeja se diçka e brendshme, e thellë zgjohej tek unë. Sikur bloqe të tëra të kohës së shkuar, tanimë të vendosura thellë nëpër vendet e tyre, dikush nisi t'i lëvizte.

Redaktorja u përqëndrua përsëri në punën e vet. Ajo kishte ngut e nuk donte ta pengonin. As unë s'kisha më dëshirë të bisedoja me të. Lexoja i heshtur emrat e atyre që dikur i kisha njohur, po jo si emra, si bashkime të disa gërmave, por si njerëz të gjallë, kështu, si ti e si unë tani. Vetiu ditët e luftës e të fëminisë po më vinin pranë me fytyrat e atyre njerëzve.

— Q.D. — mërmërita me vete... — Q.D... — dhe largova shikimin prej listës... — Q.D... — Po ky emër?

Redaktorja ngriti kryet e vështroi nga unë.

— Q.D. — thashë unë duke i folur asaj.

— Do të na shkruash?

— Ky emër... Këtë unë... Q.D...

— Do të na shkruash? — pyeti përsëri redaktorja dhe po më vështronte me ata dy sy të vegjël, ngulitës, që unë i kisha parë kaq e kaq herë.

Ajo ditë prilli '944...

U përhap fjala se do të bëhej alarmi ajror. Qepenët e dyqaneve u mbyllën. Rrugët u zbrazën. Gratë sa mezi mblidhnin fëmijët e mërzitur, që grindeshin se nuk mund të luanin dot top leckash, as aty te praku i derës. Vetëm patrullat gjermane e mercenare, të ngrira në heshtjen e tyre, shkonin e vinin nëpër rrugët e shkretuara. SS-ët heshtnin. Pas dritareve të mbyllura me kapakë dërrasash, heshtnin dhe banorët e qytetit të vogël. Dita ishte e vrejtur dhe e ftohtë. Binte një shi i imtë, që s'pushonte. Diçka e rëndë, e heshtur dhe e pashpjegueshme rëndoi përnjëherësh mbi qytetin e vogël, me rrugë të ngushta e pullaze të ulëta.

U dëgjua një breshërimë mitralozi. Pastaj një heshtje e gjatë. Sikur krisma të kishte goditur vetë murmurimën e jetës së qytetit. As hapi i rëndë i patrullave s'u dëgjua më. Dy krisma. Njëra pas tjetrës. Dy. Të largëta. Të mbytura.

— Goditën në trup — murmuriti dikush.

Ashtu e ngrirë hyri ajo ditë në kujtesën time. E, nëpër ngricë të saj, të heshtur e të egër, patrolonin SS-ët.

Hutimin e qytetit e çori një bori. Vetura e gestapos rrëshqiti nëpër rrugën kryesore. Dhe përsëri gjithshka ra në heshtje. Pastaj një derë u hap... Edhe një... Edhe një...

Dikush doli në rrugë.

— Paskan pushkatuar pesë vetë. Te xhamia e tabakëve, paskan pushkatuar pesë vetë.

Njerëzit dilnin prej shtëpive. Gra, fëmijë, burra, shkonin nga xhamia e tabakëve. Mbi ta e ftohtë, e vretur, duke derdhur pa pushim atë shi të imtë, notonte ajo ditë prilli '944.

Redaktorja qëndronte para meje e më shikonte me ata sytë e saj të vegjël, ngulitës. Ashtu si më parë edhe tani ata sy binin mbi mua e më pyesnin: «a do të na shkruash? Qoftë edhe një shkrim të vogël». Unë heshtja. Për mua nuk ishte më i rëndësishëm një artikull për revistën. Para meje tani shpalosej vetë ajo ditë...

...Rojet gjermane e mercenare nuk lejonin njeri t'u afrohej të pushkatuarve. Ata kishin rënë te rrëza e murit. Të mbytur në pellgun e gjakut të vet. Njëri prej të vvarëve kishte rënë me fytyrë nga qielli. Ai kishte qenë sheh dhe pak më tutje i kishte mbetur çallma. E qullur krejt ajo dukej e pistë dhe e palarë. Midis tyre, përmbys, kishte rënë një grua...

Të parët filluan të qanin fëmijët. Pastaj gratë. Pastaj të gjithë. Turma afrohej te të vvarët. Njerëzit donin t'i shihnin, donin të dinin se si duke-shin ata të vdekur. Dhe qanin. Afroheshin. SS-ët i shtynin me automatik në gjoks. Një mercenar me pushkë të gjatë në sup ju afrua asaj gruas dhe e goditi me majë të këpucës. Një herë. Dy. Tri... Ai i binte me këpucë e diçka murmurinte nëpër dhëmbë. Këmbëzat e çitjaneve nuk ngjiteshin lart. Ato arrinin gjer aty te lakëza e pulpave, pastaj, të qullura, puthiteshin në këmbën e ngrirë të gruas

së vrarë. Mercenari qëndronte mbi të me pushkë të gjatë mbi sup, diçka thoshte e përsëri e qëllonte me këpucë.

Erdhi karrua. Të katër burrat njëri mbi tjetrin i hodhën mbi të. Këmbët e dikujt u varën jashtë, pastaj një kokë e dy krahë. Atë nuk e ngarkuan. E lidhën me litarë të karros prej të dyja këmbëve të z bathura dhe e tërhoqën zvarrë. Karrua ecte ngadalë duke marrë pas nëpër udhë të qullura e gjithë baltë gruan e veshur me çitjane të zeza, rënë përmbys me krahët hapur gjithnjë anësh.

Q.D. Një emër. Dy gërma. Dy kokrra gruri të mbjella tek unë, si në tokë. Ajo redaktorja me duart e veta kishte rrëmihur tokën: ato dy kokrra gruri, gati të harruara ishin aty dhe vetë kishin lëshuar sythë e po mbinin. Dhe unë nuk e kisha ditur këtë... Atë mbrëmje erdhi te ne xha Zanua, një fqinji ynë. Zbathi te praku i derës opingat, hyri në odën e zjarrit, duke shkelur me çorape, shkoi dhe u ul drejt e në qoshe.

— I vranë... ëh! Maskarenjtë... — i tha babait, që ishte ulur në anën tjetër.

Dëgjova një kërcitje të fortë të nofullave e të dhëmballëve. Ishte një kërcitje si ajo e trarëve të shtëpisë, po unë isha i vogël e më tërhiqte më tepër vetëm pamja e asaj dite. Para syve më dilte gjithnjë ai mercenari, që goditte me shqelma gruan e vrarë, shikoja karron, që shkonte ngadalë mes për mes qytetit të heshtur, karrocieri tërhiqte prej freri kalin e nëpër shi fliste me zë të ulët me veten, me kërcitjen e rrotave dhe me lllapashitjen nëpër baltë të trupit të vdekur të asaj gruaje.

Q.D. Dy gërma. Një emër. Në atë emër, — një

jetë njeriu. Atë jetë SS-ët e kishin pushkatuar atje te xhamia e tabakëve, në atë ditë prilli '944. Po ku ishte tani ajo jetë? Duke më kërkuar një shkrim për revistën, redaktorja trupvogël as që e kishte menduar se nëpër ç'rrugë po më niste. Ku ndodhej tani ajo jetë e pushkatuar prej SS-ëve? Cilët njerëz mbanin pjesëza të saj? Do të më duhej të kërkoja e të kërkoja, të kthehesha prapa nëpër ato ditë të dikurshme të fëminisë, të ngatërrohesha, të humbisja udhën e përsëri të nisesha në kërkim të asaj jete. Unë duhej ta ngjallja përsëri atë grua, ashtu siç kishte qenë dikur, me fytyrë e ëndrra e luftëra, me dashuritë e saj.

I vetëm kaloja nëpër salla e korridore të muzeumit. Në heshtjen që më rrethonte, qëndroja para eksponateve e vitrinave. Herë pas here prej fotografive më shikonte ndonjë fytyrë e njohur dikur. Ndjeja vjetët e kaluar të më afroheshin gjithnjë e më pranë. Mendimi se koha merr fytyrën e ngjarjeve e të njerëzve, dhe me atë fytyrë hyn pastaj nëpër muzera, që sërish të dalë përpara njerëzve, më kishte pushtuar të tërin. Ditët e luftës qëndronin para meje të kthyera në një fletë komunikate, në një pushkë partizane, në një xhaketë të vjetër, të shpuar nga plumbat armikë. Njerëzit i kishin futur aty. Dhe i ruanin. Nuk donin që ato ditë të zhdukeshin. Nëpër to vareshin ato fotografi me fytyra njerëzish. Të rinj, të reja, burra, gra, fshatarë, qytetarë.

Përnjëherësh diçka u drodh tek unë. Nën një dëçiturë: «Dëshmorja Q.D.».



Ja, ajo... gruaja e mbytur në gjak të vet në atë ditë prilli '944. Ja, cila qenka ajo... Për herë të parë shihja atë fytyrë. Asaj dite ajo kishte rënë përmbys me këmbët e krahët hapur mbi asfaltet e qullura. Dhe ashtu kishte mbetur gjersa karrua ishte zhdukur prej shikimit tim. Ky vegim kaq thellë ishte ngulur në kujtesën time sa, edhe kur në imagjinatë kërkoja t'i jepja asaj ndonjë fytyrë të re, më zhdukej në çast. Dhe gruaja mbetej po ashtu e rënë përmbys mbi asfaltin e qullur. Ja, cila qenka ajo... Kisha qëndruar përballë saj. U afrova më pranë fotografisë. Atëhere ndjeva se fytyra e saj po mjegullohej. Nuk po kuptoja se si në atë tis kafe të fotografisë shkrihej ajo kokë e madhe, që ishte ngritur aq lart, sa thua do të rrëzohej mbrapa. Në atë fytyrë vetëm dy vetulla të trasha harkoheshin përpjetë. Dhe nën to — sytë, që humbisnin në një mugëtirë të hirtë. Ajo fotografi do të kish qenë kopjuar nga ndonjë tjetër, e vjetër. M'u kujtuan ato fotografitë e zbehta të vorrezave të prishura nga dielli e nga shiu. Më kot po përpigësja të shquaja miset femërore të asaj gruaje. Nuk mundja. M'u duk sikur fytyra e mjegulluar, që më shikonte nga fotografia po tretej vetë në ftohtësinë e asaj dite prilli të pushkatuar nga SS-ët, atje te xhamia e tabakëve.

Dhe mbeta përsëri vetëm.

— Jo — tha këpucari. — Ditën kur ata janë pushkatuar unë nuk kam qenë në burg.

Ai kërkoi mbi tavolinë e mori, mes gozhdësh e pafkash, cigaren e ndezur.

— Nuk kishe dëgjuar për një Q.D.-ën?

— Jo.

Dhe thithi përsëri cigaren.

— Ti e ke pasur tënden? — më pyeti.

Shikova atë burrë në sy. Fundet e tyre ishin të skuqura nga konjuktivitis. S'dija si t'i përgjigjesha.

— Po...

— Eh, lufta... — tha ai. Dhe mori përsëri ndër gishtërinj bishtin e cigares. — Kushedi sa njerëz kanë humbur — tha. — Po mundet... mundet që edhe ajo të ketë qenë atëhere në burg. Mundet — tha i menduar duke tundur kokën e duke më parë në sy. Këpucën e vuri mbi gju e nisi të qep-te. — Mundet edhe ajo të ketë qenë — tha pa ngritur kokën. — Neve na kishin ndarë: burrat mënjanë, gratë mënjanë. As takoheshim e as flisnim dot njëri me tjetrin. Na nxirrnin në oborr. Vetëm gjysmë ore në ditë. Sa mbaronin burrat, dilnin gratë. Në mes rrinte rreshteri me kamxhik në dorë. Rrotulloheshim rreth tij. Duart duhej t'i mbaje pas e të mos kthejë kryet anësh, se kamxhiku të flakëronte fytyrës.

Herë pas here këpucari thithte cigaren dhe përsëri e linte midis pafkave e gozhdëve. Pastaj, kryeulur, vazhonte të qepte këpucët.

— Kishte shumë?

— Njerëz? Sa të duash... po kujt i kujtohen tani?

— Q.D. nuk e ke dëgjuar këtë emër? — pyeta unë përsëri.

— Jo.

S'kisha se ç'të bëja më aty. U ngrita e dola jashtë.

Burgu...

Dy palma të vetme nën atë qiell të hirtë, të ulët. Të vjetra, të rjepura nga shiu e dielli. Midis tyre postbloku. Aty kalonte një udhë prej zhavorri, tërë gropa maqinash të mbushura me ujë. Në fund të saj ngrihej një ndërtesë e verdhë, dykateshe. Burgu. I heshtur e i çuditshëm në heshtjen e vet. Pa dyer e pa dritare të rënda hekuri; pa kthina e qelira të errëta. Dhoma të mëdha e të gjera shtruar me dysheme dërrase poshtë. Këto dhoma, ishin mbushur plot e përplot me të burgosur, që flisnin me zë të ulët dhe heshtnin, sapo te praku dukej SS-i gardian. Burg i ngritur në një kohë burg. Ngjyra e tij shkrihej me verdhësinë e përgjithshme të atyre ditëve. Rreth tij ishin endur njerëz të veshur me rrobe ushtarake të gjelbëra. Burgu pa dyer e dritare të hekurta. Sa pak shëmbëllente ai me burgjet e tjera. E ndoshta prandaj kishte qenë më i frikshëm për banorët e atij qyteti të vogël.

Nën shkallët e atij burgu kishin pasë sajuar një skutë për gratë. Për to s'kishte vend tjetër.

U ngjita në katin e dytë. Dhomat kishin po atë ndarje, si edhe poshtë. Ecja ngadalë i menduar. Gratë, siç duket besuan që po kërkoja ndonjë prej atyre familjeve, prandaj nuk më pyetën më. Po në kokën time më tingëllonte pyetja e tyre e parë: «Cilin kërkonti?» — Ç'tu përgjigjesha? Q.D.-en? Kërkoj një ish-të burgosur? Vetëm një? Unë shkelja mbi dërrasat e dyshemesë. Ishin po ato. Po ato mbi të cilat vjete më parë kishin shkelur ata, të

burgosurit, ata SS-ët. Ndërsa kjo godinë, ku tani ajo grua, me atë fustan të gjelbër me pulla të bardha, me atë përparse pune të lidhur, sapo më kish-te pyetur: «Cilin kërkoni?»; kjo godinë ishte ngri-tur atëhere e ngrysur dhe e rreptë mbi jetën e qy-tetit të vogël.

«Cilin kërkoni?» — Ç'të përgjigjesha? Një emër, Q.D.? Një grua që nuk ishte më? Ndofta kërkvoja ndonjë inicial, gjurmë të burgosurish të dikurshëm? Gjékundi asgjë. Po ato pllaka, po ato dërrasa, po ajo ndërtesë. Dhe gjékundi asnjë shenjë jete burgu. Ndërtesa dykatëshe e verdhë ishte kthyer në një shtëpi të zakonitë banimi, ku jeta me zërat e fëmijëve e të grave tani gumëzhinte si kudo gjetiu. Mendoja që njerëzit tanë herë-herë janë më pak sentimentalë se të tjerët. Çfarë nuk do të kishin shkrojtur e gdhendur të tjerët këtu... Kurse këta fëmijë e këto gra duken që janë të ardhura në këtë qytet. Ato s'dinë asgjë. As dinë që natën flenë mbi një botë të tërë, e cila ka ekzis-tuar para disa vjetësh, po që çuditërisht tani hesht nëpër ato mure e brenda asaj ndërtese. Ato më kujtojnë udhëtarin që e zë nata jashtë e që, pa di-tur, fle mbi tokën, ku është varrosur një i vdekur. «S'ke ç'i bën», mund të thotë dikush. Ky është fati i njeriut. Dhe ndofta jo vetëm i tij, i gjithë njerë-zimit... Ai fle mbi atë tokë, ku dikur është varro-sur një i vdekur, po këtë nuk e di... Dhe ndofta kështu është më mirë, i them unë, ndofta kështu është më mirë...

Berberi kishte një fytyrë të rrumbullakët me ca sy të kaltër, të shndritshëm, me buzë të për-

thyera dhe, kur fliste, dukej sikur qeshte. Mbaroi së qethuri policin e, duke nxjerrë prej xhepi kutinë e cigareve, m'u afrua pranë, më shtriu paqetën, po i bëra shenjë që s'e pija dhe ai murmuriti: «Qenke mirë». Në fronin, ku sapo u ngrit polici, u ul dikush tjetër. Mendova se berberi do të shkonte, ta rruante edhe atë, po ai vetëm i tha gocës, që mësonte zanat, ta sapuniste klientin. Dhe u kthye sërish tek unë. Kishte filluar të errej. Jashtë u ndezën dritat e rrugëve. Ne të dy zumë vend pranë dritareve të berberhanës.

I thashë përse kisha shkuar atje.

— Mua më arrestuan ballistët — tha ai. — Atëhere nga mali kishin kërkuar një llambë radioje. Nuk di përse u duhej. U nisa vetë për Tiranë. Në rrugë më arrestuan e më mbyllën në burgun special. Më kujtohet gruaja ime. Orë të tëra rrinte e priste përjashta në të ftohët, në shi. Priste gjersa takohej me mua. Ditë për ditë...

Sytë e berberit ishin po ata, të kaltër e të shndritshëm. Ai fliste e midis buzëve të trasha e të përthyera lart i ridhte ai zë i ulët e i mpiksur.

— Çdo ditë — thoshte — në shi, në erë... Ajo qëndronte e priste më këmbë matanë udhës së burgut me një bohçe në dorë, ku kishte mbështjellë bukën për mua. E shihja nga dritarja e s'largohesha dot prej andej. As ajo nuk largohesha, edhe kur më rrihnin, edhe kur më bënë gjyqin, unë e dija, ajo ishte atje, priste...

M'u kujtua thënja e Arkimedit: «Më jepni një pikë ku të mbështetem...». Ky njeri, që fliste para meje, e kishte gjetur atë pikë në jetë. Ajo që gruaja e tij.

— Q.D.-en e ke njohur?

— Po... E kam takuar vetëm në korridorin e burgut. Ishin kohëra të vështira. I kujtojmë e sikur s'na besohet. Kemi qenë ne? Ne kemi qenë vërtet? I kujtojmë e sikur s'na besohet. Edhe njerëzit se si ishin atëhere. Unë isha berber e më kishte caktuar të qethja të burgosurit. Kështu mund të lëvizja pak nëpër burg. Gruaja vinte ditë për ditë. Më sillte lajme nga fronti i luftës, nga malet. Unë ua thoshja pastaj ato shokëve të burgosur. U mburresha. Lajmet m'i sillte gruaja vetë. Dëgjonte gjithë natën radion, stacionet e huaja, që flisnin në gjuhën tonë, i dëgjonte e pastaj m'i thoshte mua. Dhe unë ua thoshja të tjerëve. Ata e dinin, që ato lajme i sillte aty ajo, gruaja ime...

Ku takohej dhe ku ndahej në ndërgjegjen e këtij njeriu gruaja e tij prej Q.D-es? Të dyja ato ishin gra. Njëra e burgosur, tjetra, edhe pse jashtë, në ato ditë, jetën e saj e kishte lidhur me atë të burgut. Ajo dëgjonte **natën radiot dhe u sillte të burgosurve lajmet nga frontet e luftës.** Në ç'pikë takoheshin në ndërgjegjen e këtij njeriu këto dy gra?

Ai ishte berber dhe unë e pyeta:

— A të kujtohet çfarë flokësh kishte Q.D.?

— Hëm... — murmuriti me atë zërin e tij të ulët e të mpiksuar... — Hëm... — ja bëri përsëri... Vetëm atëhere ai më vështroi në sy dhe unë e kuptova: njeriu përpiquej të kujtonte. — Hëm... gështenjë... — tha pastaj. — Njëherë më dhanë urdhër t'ua qethja flokët grave. U dëshpërova shumë. I thashë edhe sime shoqeje. Filloi të

qante. «Të gjorat gra»— më tha. S'dija si ta ngushëlloja.

— Nuk të kujtohet gjë tjetër?

— Jo.

— Asgjë?

— Asgjë.

— Nuk të kujtohet se ç'sy kishte, ç'zë?

Berberi heshti. Dhe nuk u përgjegj më. Filloi të soditte menduar përmes xhameve natën, që tashmë kishte mbuluar qytetin. E kuptova: me heshtjen e vet ai desh të më thoshte: «Si mund të kërkosh gjëra t<sup>ra</sup> tilla pas 25 vjetve»?!

U ndava prej tij. «Si mund të kërkosh gjëra të tilla pas 25 vjetësh? Kush mund të mbajë mend tani se ngjyrë të syve, se ç'flokë kishte ajo?». Po unë duhej ta rikrijoja atë njeri e të tillë, pa sy e pa zë nuk mund të kishte. Asaj dite prilli SS-ët pushkatuan edhe ngjyrën e syve të asaj gruaje, shkërmuan edhe zërin e saj. Kurse unë... Unë duhej të përkrijoja gjithshka që i përkiste Q.D-es. Sa mirë do të ishte sikur të kisha përpara dosjet e dokumentat e saj, letrat e kujtimet. Ditaret. Po ku? Dosja e vogël e muzeut të qytetit përmbantë vetëm disa shënime të përgjithshme mbi të. Ato ishin më tepër shënime të shkruara prej të tjerëve. Kurse prej vetë dorës së saj asgjë. Ndofta do të më mjaftonte një letër, një e vetme për të kthjelluar gjithshka. Po ku? Atëhere Shqipëria e varfër e gjysmanalfabete sikur jetonte edhe duke

ngrenë vetëveten, edhe duke kapërdirë bijtë e saj. Janë të shumtë ata, prej të cilëve s'ka mbetur asgjë, veç kujtimeve të përhapura nëpër njerëz, nga më të ndryshmit. Duhet që t'i kërkosh, t'i zbulosh e t'i mbledhësh, që të mund të ngjallësh tani atë grua, atë jetë që qëndron brenda atyre dy gërmave të vetme Q.D.

Xhamia e tabakëve nuk është më. Atje, ku dikur ngrihej ajo, tani hapet një shesh i shterë, i rrethuar me ndërtesa të mëdha e të bardha. Xhamia e tabakëve nuk është më. As ata dy varret e dervishëve me gurë shtufi të skalitur para saj. Të vegjël ne hipnim mbi çallmat e tyre e shikonim brenda si falej hoxha.

Ata s'janë më. Po mua edhe tani më kujtohet qyteti i fëminisë së dikurshme.

...Nëpër pullazet e shtëpive të ulëta, nëpër mëhalla të mbledhura e të ngatërruara njëra me tjetrën, nëpër udhët e ngushta bie po ajo ngjyrë gri, që vjen prej Budaku. Te këmbët e qytetit fillon hapësira e kaltër dhe e pamatur e detit. Gjithnjë gurgulluese dhe e shqetësuar. Gjithnjë kërkëruese. Po e vetme. Dhe ajo e trishtuar aty, në atë tokë të futur, ku të duket sikur njerëzit nuk mund të kalojnë dot sinoret, që i rrethojnë: as gjelbërimin e kodrave dhe as kaltërsinë e detit. Të duket, sepse jeta e lufta prej kohe i kanë përllarë ata dy sinorë të ngushtë të qytetit të vogël.

...Koha është e pasigurt. Çdo ditë vjen më e rëndë dhe më e frikshme se tjetra. Gjermanët më



të egërsuar... Dhe në krimet e tyre më të çmendur. Në rrugën kryesore të qytetit gazetashitësi, me një dorë të cunguar, mban një tufë gazeta nën sqetull e thërret «Bashkimi i Kombit». Patrulla gjermane kalon e heshtur para tij, kurse ai thërret: «Fjala e doktor Geringut. Gjermanët duhet të sakrifikojnë...»

Gazetashitësi ngadalë drejtohet për në bilardon, në qendër të qytetit. «Bashkimi i kombit». Brenda kurrkush nuk ja vë veshin. Disa janë ulur nëpër karrige, të tjerë luajnë bilardo. Ndër brezat e tyre varen goldët e valterët. Disa mbajnë në duar edhe pushkët e gjata. Janë ballistë. Të gjithë janë të armatosur. Sapo të dalin prej andej, në rrugë s'dihet se ç'mund t'u ngjasë.

«Fjala e doktor Geringut».

Me dorën e cunguar gazetashitësi nisët nga xhamia e tabakëve. Hajati i vjetër i saj është i rrethuar me mure guri e shufra hekuri. Brenda në të falen një grup mercenarësh e muhaxhirësh. Ulur në gjunjë, ata përthyhen mbi tokë dhe herë pas here ngrenë duart e kokën përtpjetë. Gazetashitësi shkon midis tyre. Besimtarët e allahut pushkët e gjata i mbajnë në tokë pranë gjurit. E murmurijnë fjalë të panjohura arabisht. Lutën. Tani vdekjen e ke kudo përpara. Në mos sot, nesër do ta takosh. Besnikët pëshpërijnë fjalë të pakuptueshme arabisht.

Në rrugë gazetashitësi thërret: «Fjala e doktor Geringut...».

Një çeshtë. Dy gra me shtëmba balte mbushin ujë. Gazetashitësi afrohet aty. Ulet mbi gurin e madh e vë gazetën në tokë. Nxjerr nga xhepi një

letër, ku ka mbështjellë një copë bukë të misërt e ca kokrra ullinj. Fillon të hajë. Gratë mbushin ujë. Ato zgjatin nën rrjedhë këmbët e zbathura me nallane dhe i fërkojnë njëra me tjetrën. Pastaj largohen prej andej pa e mbyllur çesmën. Gazeta-shitësi mbetet vetëm. Ai ha bukë me ullinj të kri-pur. Kur mbaron, hedh tej letrën dhe ngrihet. Me të vetmen dorë që ka pi ujë. Qëndron një çast në këmbë. Nga të niset? Sikur të shtrihet e të marrë një sy gjumë? Është shumë i lodhur. Shtrihet në tokë, vë kokën mbi gur dhe dëgjon rrjedhjen e çesmës. Atë e zë gjumi. Dhe nëpër gjumë pësh-përin: «Fjala e doktor Geringut. Gjermanët duhet të sakrifikojnë...»

Njeriu që qëndronte para meje ngriti gotën e birrës dhe e gëlltiti përnjëherësh. Unë e dija që ai ishte alkoolist. Porosita tjetrën.

— Të lutem — tha ngadalë. — Të lutem...

— Ti e ke njohur?

— Unë? A e kam njohur?

Njeriu filloi të qante. Lotët i rridhnin dhe ai i gëlltite. Ndërpreu bisedën. I vinte turp. Unë ngrita gotën time dhe piva gjatë. Kur u ktheva, e shikova atë në sy. Edhe ai më pa mua. Kamerieri pruri birrën tjetër dhe ai gati ja rrëmbeu nga duart. Po nuk e piu. E lëshoi mbi tavolinë para tij. Herë pas here e prekte me gishtërinj. Pastaj filloi të këndonte me vete:

«Në Vlorë u bë hataja...»

Njeriu i pirë këndonte me vete. E dëgjoja në heshtje. Dhe shikoja fytyrën e tij të trishtuar. Bu-

zët e holla, të zbeta shtriheshin lehtas, murmurinin: «Në Vlorë u bë hataja...» Isha duke e dëgjuar ashtu, kur në çast më përshkoi mendimi: Po pse «hataja»? Kujtova aq e aq këngë luftërash e dëshmorësh. Dhe çuditërisht kurrkund nuk ndeshja fjalën «hataja». Kurse tani ky njeri i dehur para meje, duke prekur e mbërthyer midis gishtërinjve të dorës gotën e birrës, murmuriste:

«Në Vlorë u bë hataja...»

— Përse «hataja»? — i thashë unë.

Ai ngriti sytë e tij të padritë mbi mua.

— Populli... — më tha ngadalë. Dhe duke më shikuar gjithnjë me ata sytë e tij të perënduar, nisi përsëri të këndonte.

— Sonte do të ketë furtunë. Duhet që t'i çojmë anijet në Jonufër. Atje i zë më pak era. Kur fryn jugu, ne atje mbrohemi, kur ka tramundanë, nisemi në të kundërtën...

Unë këto i dija dhe, ndërsa peshkatari fliste — hetoja fytyrën e tij zeshkane, me dy nofullat e mbledhura, po me një ballë të gjerë e dy sy të mëdhenj, të kaltër. Pastaj ata flokët e dendur e të paqethur. Këto kokë peshkatarësh i kam parë e i kam dashur qysh fëmijë. Qyteti ynë është bregdetar e mjeshtëria e peshkatarit e njohur për mua. Dhe romantika e detit, një romantikë tjetër. Kur lexoj diçka të ëmbël e të bukur mbi jetën e tyre, përnjëherë më kujtohen ata peshkatarët e fëminisë sime, me këmbë të zbathura e duar të çara që u pikonin gjak mbi ndonjë qefull e levrek të porsazënë. Po me ato fytyra burrërore e të fuqishme.

Atëhere unë mendoja se burri një fytyrë të tillë duhej të kishte.

— Ti për Q.D-en më thanë... — dhe peshkatarë më tërhoqi fort prej krahu.

— Po... E ke njohur?

— E kam njohur.

— Çfarë mund të më thuash për të? — e pyeta përnjëherë.

— Ohu!.. — Dhe ai qeshi. Pashë dhëmbët e tij: disa prej tyre ishin të porsavënë.

— Kaq shpejt? Kemi kohë... — tha.

Kapërcyem molin e dolëm në pjacën e skelës. Ndjeja gjithnjë krahun e atij burri, që më tërhoqte nga vetja.

— E di... — i thashë unë... — Si t'ju them? Ju thoni kemi kohë... kurse unë, që po kërkoj, shoh se nuk ka edhe shumë kohë... Më tepër se 25 vjet kanë kaluar... vjet të tërë e njerëzit janë njerëz... Koha, jeta, mosha... bëjnë të vetën... shumë gjëra harrohen.

Peshkatarë i ra lehtë më këmbë derës së kafenesë dhe më shtyri brenda. Një erë e përzier me zesh, alkooli e zëra burrash më pushtoi. Ndjeva dorën e njeriut, që çliroi krahun tim. Ai shkoi drejt e në banak. Diçka po porosiste, kur u kthye nga unë:

— Ulu tek ajo tavolina atje, se do të na e zënë.

Ashtu bëra. Pjesa më e madhe e njerëzve, që ndodheshin aty, ishin peshkatarë. Dukeshin nga ato fytyrat e tyre të rrahura prej diellit dhe erës, nga ato duar të mëdha e nervoze, që përherë duan diçka të bejnë, nga ai tingull i veçantë, i gjallë i zërit të tyre. Peshkatarë erdhi me dy gota në

duar, i lëshoi mbi tryezë dhe u kthye sërish në banak. Prej andej solli mezet.

— Qefull — tha. — Nuk kishte kocë...

— Ato i ha shumë.

— E dija... po s'kishte. Po ty të duket... — tha ai... dhe menjëherë e ndërpreu bisedën: — gëzuar — tha e më fundin e gotës së tij toku gotën time.

— Gëzuar!

Ne pimë.

— Ty të duket — tha ai — sikur njerëzit harrojnë. Po mos u tremb, nuk harrojnë, jo.

— Nuk është e vërtetë — i thashë unë.

— Koha, jeta, mosha... — tha ai kësaj radhe duke përsëritur shkoqur fjalët e mia.

Unë heshta. Shikova fytyrën e tij dhe atëhere zbulova diçka fare të papritur e të çuditshme. Peshkatari po qeshte. Po jo ashtu si qeshim zakonisht. Njeriu po shihte thellë vetes së vet. Dhe ashtu i fuqishëm e i madh, siç ishte, po i qeshte aty diçkaje të dashur e të dhembshur.

— Duket... — tha ai... — Edhe unë herë-herë bisedoj më shokët e mi... Dhe ne kështu themi: more, po e di, po i harrojmë... ja, mua nuk më kujtohet kjo... as ajo... Si, more, vërtet kështu paska ngjarë? Paskam qenë edhe unë? Ja, s'më kujtohet... Po pastaj dalë e ngadalë të gjitha kujtohen... Vetëm ato ditë që s'harrohen...

— Po...

Ai nuk më la:

— Ti atëhere ke qenë i vogël... Kurse unë... Unë tjetër... Po edhe ti, ja, pse nuk e harron dot

atë ditë prilli 1944? Ajo gazetarja, siç thua ti, ta kujtoi menjëherë.

— Po.

— E sheh?!

Ai heshti. E përsëri fytyra e tij mori kthjellim të brendshëm. E kuptova: njeriu u shkëput prej meje dhe mbeti vetëm me veten e tij.

— Jeta është jetë... të tjera përpjekje tani... po ato ditë... dhe atë luftë që kemi bërë ne... gëzuar!

Ai përsëri e goditi buzën e gotës sime me fundin e gotës së vet.

— Gëzuar... Q.D-en e ke njohur?

— Po tha ai. — Ditën që e pushkatuan unë kisha hyrë ilegal në qytet. Dhe shkova atje te xhamia. Isha i armatosur e qëndroja midis turmës. Pastaj e ndoqa pas atë karro të ngarkuar me shokët e vrarë. Ecja larg saj. Gjer në kanal, ku i varrosën... Atëhere ne duhej të dinim gjithshka.

— Vetëm atëhere e ke parë? — e pyeta unë i habitur.

— Pse, pak të duket ty? — Dhe ai qeshi e m'u afrua pranë e, duke tundur kokën, më pyeti prapë: — pak të duket?

Nuk dija ç'të bëja. Fillova të pija me rrëmbim verën. Shikoja ata flokë të përhimtë, ata sy të mëdhenj e të kaltër, atë fytyrë të rrahur nga erërat e kripura të detit.

— Ti nuk e dije, që atë ditë me shi, mbësh-tjellë në xhaketen e vjetër, me nagant në xhep, atë karro e ndiqte pas një ilegal... pak të duket ty? — tha ai tashmë fare pranë meje.

## II

Fëminia ime kishte sy të çuditshëm. Të çuditshëm? Çfarë sy të tjerë mund të kishte ajo? Tani unë shoh thellë në veten time ditët e dikurshme, që më ngjajnë me lodrat e fëminisë. Ndodh që akoma ato i ruajmë në ndonjë raft të mbyllur. Të largëta e të afërta, porsi ato. Porsi ato të pabesueshme e të çuditshme. Çfarë sy të tjerë mund të kishte fëminia ime? Si mund të shikonte ajo në ato ditë? Ja, në duart e mia njëra prej tyre. Sigurisht që ajo është dita më e hershme, që mbaj mend nga qyteti i lindjes. ...Pasdreke. Dielli i lodhur humbet nëpër tymra e ujëra të detit. Në udhën kryesore papritur duken turma qytetarësh, nxënësish, zanatçinjsh. Thërrisnin. Shanin. Dhe bashkë me thirrjet e sharjet e tyre rrokulliseshin nga komanda e kazermat e xhandarmërisë. Nëpër këmbët e tyre rend dhe unë, zbathur, me pantallona të shkurtëra e flokë të pakrehur.

— Pushkë!

— Duam pushkë!

Fytyra të deformatuara, zëra të egërsuar.

— Fashizmi po na pushton.

— Na jepni pushkë!

— Pushkë!

Kurrkush nuk del që t'i thotë qoftë edhe një fjalë turmës së egërsuar. Xhandarët me karabina ndër duar qëndrojnë të heshtur para qytetarëve, por edhe ata janë të shqetësuar e të tronditur.

Populli kërkon armë.

Unë shoh i çuditur se si, në ato fytyra të de-

formuara, xhvendosen nga njëri vend te tjetri muskujt e nofullave; se si sytë e zgurdulluar përpijnë dritën e paktë të mbrëmjes e prapë mbeten në errësi.

— Duuuuam të vdeeesiiim!

Është usta Gori që thërret ashtu. Ai banon në lagjen tonë në atë shtëpinë e vogël, njëdhomëshe, të ngritur prej tullash të kuqe. Nëna thotë që ai pështyn gjak, prandaj nuk duhet t'i afrohemi shtëpisë së tij. Usta Gori është i verdhë e i mbaruar në fytyrë dhe ka dy sy të hirtë. Në lagje unë s'e kam dëgjuar kurrë atë të thërrasë, ndërsa tani, si çirret ai kështu...

— Duuuuaam aaarmë!

Dhe sheh rreth e rrotull me ata sytë e egërsuar, të hirtë të tij. Mua më duket sikur e gjithë ajo turmë njerëzore ka atë fytyrë të verdhë e të deformuar, ata sy të çakërdisur, atë zë të çjerrë gati jonjerëzor të usta Gorit.

— Tradhëti!

Kjo është e vetmja fjalë, që rrëshqet e rrumbullakët dhe e plotë prej gojës së atyre njerëzve. Fjalët e tjera thyhen nëpër nofullat e tkurrura, copëtohen e ashtu copra-copra shkojnë e godasin njerëzit në fytyrë.

— Tradhëti!

Kjo është e vetmja fjalë, që rrëshqet e qullët dhe e butë nga gryka e mbrëmjes së egërsuar, të pafuqishme si ajo turmë njerëzore që thërret, shahet, shtyhet drejt hekurave të kazermave të xhandarmërisë e përsëri mbetet aty te udha. Nuk lëviz dot asnjë hap përpara. Armët që ata njerëz kërkojnë, i kanë në duar të tjerët.



— Duuuuaam të vdeeesiiim!

— Tradhëtarë, do ta kujtoni këtë 6 prill '93!

Fjalët e copëtuara godasin njerëzit, që zënë fytyrat me duar të mos u dhembnin.

Ç'sy të tjerë mund të kishte fëmënia ime... Dhe përse ajo duhej të shikonte ndryshe? Njerëzit janë të shumtë. Njerëzit janë të ndryshëm. Dikush nuk e ndjen veten mirë brenda emrit të vet, një tjetër nuk mund të qëndrojë dot më brenda lëkurës së tij. Unë dhe gjithë fëmënia ime paske-mi jetuar vetëm brenda dy gërmave: Q.D

Unë kërkoj ta ringjall atë grua, gjurmoj jetën e saj, po para meje del ai qyteti i vogël i fëmënisë, e ndjej se si tani, dikush më prek me dorë në sup dhe më pëshpërit në vesh:

— Në ora tetë llamba e elektrikut të Muradies, te udha e Budakut, të thyhet. Fiks më tetë. Kujdes spiunët.

Unë shkoj në shtëpi, vërtitem nëpër dhoma e, sapo shoh që në odë të zjarrit nuk ka njeri, hyj nën oxhak. Aty, në një vrimë midis tullave kam fshehur llastikat për të vrarë zogj. E zgjidh bigaçen, provoj mesinën dhe pastaj e lidh përsëri fort. E hap me gjithë krahun dhe e lëshoj. Përplasja e ajrit më gëzon veshët. Me llastikat në xhep, unë dal përjashta në udhë e nis të kërkoj zaje. Ato duhet të jenë të plota e të rrumbullakëta, që të më mbushet dora. Gërryjej tokën dhe me një hekur të hollë shkul gurët, që janë ngulur thellë e kanë zënë vend në dhë.

— Pse e prish udhën, dreq... — shan ndonjë kalimtar.

Unë mbush xhepat me gurza të zgjedhur dhe

ktthehem te gjyshja. E veshur përherë me të zeza, ajo si një hije e butë vërtitet nëpër kuzhinë duke folur me vete.

— Bobo, kur erdhi kaq shpejt dreka!

— Gjyshe, do të më bësh një top lecke!

— Ikë tani, se s'ta kam ngenë!

— Të keqen, gjyshe!

— Hiqmu nga këmbët, të thashë. Erdhi dreka e unë s'kam bërë asgjë për të ngrënë. Kurse yt atë vjen...

— T'i mbledh unë drutë.

— Të keqen...

— Ta ndez unë zjarrin...

Gjyshja shkon në odën e gjumit e përposh krevatit të madh të nënës merr shportën e mbushur me çorape. Janë lloj-lloj çorape të vjetra, të grisura, që nuk përdoren dot më, por që gjyshja i ka larë dhe i ruan për arna. Unë shkoj të mbledh dru në fushën e hapët, se e di që tani gjyshja me ato duart e saj të vogla e gjithë lëkurë, zgjedh çorapet një e nga një, të bardha, të zeza, kafe, prej burrash, të fëmijëve, prej grash, u pret me gërshërë thembrat e ngrëna, i mbledh shuk e pastaj nis t'i qepë duke e tërhequr gjithnjë xhëngun fort, fort. Vetëm gjyshja ime di të bëjë top lecke që, po ta shukësh, kërcen më lart se ai i llastikut. Gjithë fëmijët e lagjes sonë luajnë me topat që qep gjyshja ime.

Me atë top unë luaj gjithë ditën nëpër buaze e vetëm kur afrohet mbrëmja ktthehem dhe shkoj nga lagjja Muradie. Nëpër muzg, e vetmja dritë elektriku ndërën te kthesa e udhës së Budakut. Dritarja e shtëpisë pranë është e hapët. Ora e qytetit

ka rënë 7<sup>30</sup> e qytetarët kthehen shtëpiave të tyre. Kalojnë ushtarë italianë të armatosur, ndërsa unë duke luajtur i afrohem shtyllës elektrike. Llastikat e zajet i kam në xhëp. Tani ora e madhe e qytetit duhet të bjerë 8. Në dritaren e shtëpisë karshi duket një hije njerëzore. Ajo qëndron një copë herë e varur në parmak e pastaj hyn brenda. Mbi qytet përhapen këmbanat e sahatit. Fap! Dhe gjithë udha krijohet në errësirë. Në çast dy hije kalojnë me nxitim njëra pas tjetrës. Ato kthehen lart nga Budaku. Andej janë kodrat e gjelbëra e pastaj malet. Unë i ndjek me sy nëpër errësirë ato hije. Cilët janë? Nuk i dalloj dot. Njeriu në dritaren e shtëpisë karshi ka dalë i tëri jashtë dhe shan me zë të lartë. Dëgjohen këmbë të rënda që po afrohen. Unë ja kris vrapit. Ata dy ilegalët nuk i njoha dot.

Xha Zanua nuk jetonte më, as Çeço Arapi dhe as Ibrahim Belua. Më të rinjtë që pyesja, nuk dinin të më thoshin asgjë më tepër nga ato që kisha mësuar vetë mbi Q.D-en. Ajo kishte qenë prej fshati dhe ato që përpiqeshin të më tregonin qytetarët e ndryshëm ishin gjëra fare të shkëputura, të dëgjua rastësisht andej-këtej, që pothuajse ata i kishin harruar. Me bisedat e mia unë sikur i zgjoja, dhe njerëzit më kallëzonin ç'dinin, por aty për aty vetë e kuptonin se ato që thoshin ishin fare të vockëla e të parëndësishme për jetën e një njeriu. Ndërsa unë kërkoja e duke kërkuar kaloja përsëri po nëpër ato udhë të ngushta, diku të kalldrëmta, diku të zhavorrta të qytetit të feminisë. Hyja e

dilja nëpër ato ditë dhe secila syresh më fliste me gjuhën e vet. Me gjuhën e vet? Çdonjëra prej atyre ditëve kishte disa gjuhë dhe ashtu ajo fliste me mua...

...Albania avanti. Fatet e Shqipërisë janë të lidhura ngushtësisht me ato të Italisë fashiste. Përshëndetni Duçen: Me në. Duçja e mori dhe e ngriti shpatën e Islamit. Një gjuhë tjetër thoshte se Çeço Arapi e ndau mbrëmë të shoqen. Çeçua erdhi në shtëpi dhe nuk e gjeti aty gruan, që kishte shkuar te një gjitone për të kaluar kohën. Kur ajo u kthye, Çeçua i zemëruar i tha: — Qysh nesër do të jemi motër e vëlla. — Mirë, u përgjegj grua, unë këtë e kam menduar edhe vetë... Protestë energjike e Italisë qeverisë britanike, thoshte një gjuhë tjetër. Në Francë vihet tesera e bukës. 35 vajza do të dërgohen në Itali për mami. Sibella Schitz në filmin «Hotel sacher». Po një gjuhë tjetër thoshte se mbrëmë te bilardua e Fizos u vra me thikë djali i ri M.SH. Punë sportistësh, mermërinte qyteti...

Çdo ditë fliste mbi mua me gjuhë të shumta, të ndryshme, herë-herë të papritura, thua sikur çdonjëra të ishte një gjethe plepi që fëshfërinte në trungun e asaj dite.

...Gjermanët zgjerojnë pushtimin e tyre në Francë. Sulmi i aviacionit gjerman e shkatërroi përpjekjen e anglezëve për të zbarkuar në Bergen. Kënaqësi e tepruar në Tokio... Mesazh i mbretit perandor: «Këto janë fjalët që me anën timë ju drejton madhnia e tij mbreti i Italisë dhe i Shqipërisë, perandor i Etiopisë». — U bëmë vëlla me Negusin — thotë Çeço Arapi. Anglezët kanë zbar-

kuar vetëm në një pikë. Sot në mëngjez në udhën e skelës u gjet një këmishëzi i vrarë. U vodhën arkat e dyqaneve të tregëtarëve. Vjedhësit nuk dihen. . . . Italia garanci paqeje në Ballkan. Fuqitë e errëta s'mund të veprojnë me efekt kundër bashkëpunimit të singertë. Fjalim i presidentit Roosvelt në komentet turke: «Gumurjet» beson se Amerika do të hyjë në konflikt në çastin e duhur. Tre mauna me gomarë e lopë, që u nisën mbrëmë prej Vlore, arritën shëndoshë e mirë në Brindisi. Sabotazh në ndërmarrjen e ndërtimit të udhëve «Purriceli. . .» «Le petit parisien» thotë se tensioni i rëndë politik, që tregoi në fillim qeveria Reynaud, të paktën tani për tani pushoi. Ish kryeministri jugosllav Stojadinoviç internohet. Komunikatë angleze. Komunikatë frënge. Qëndrimi Italisë e mban flotën angleze në gjendje alarmi në Mesdhe. Quo Vadis Egjypt?

Nga gurmazet e hapura e të pashtershme të atyre ditëve derdhen mbi qytetin e vogël lajme, informacione, deklarata, emra të njohur e të panjohur, derdhen e fillojnë të lagin çdo udhë, çdo shtëpi, nisin të hyjnë te çdo njeri.

. . .Përpyekje e dëshpëruar e francezëve, që kërkojnë të ndalojnë falangën e çeliktë gjermane. Popullsia civile largohet prej Gjibraltari. Gabimi numër dy i Turqisë? Mbrëmë në qytet flitej se Azem G. e zuri të shoqen gafil «Do ta vras» — kishte thënë mbrëmë Azemi, po sot lexoi në gazetë: «Ç'e shtrëngoi Ciceronin të vijë në Durrës? Punëra grash kanë qenë arësytet dhe Ciceronin e mori më qafë e shoqja». Azemi e fali gruan dhe i kërkoi ndjesë për atë që kishte thënë mbrëmë. Gjersa një

grua mori më qafë Ciceronin e madh... Vija Weygand u kalua në të gjitha pikat. Shtetet e Bashkuara s'kanë të drejtë të ndërhyjnë. Tani në qytetin tonë pyesin: Ç'mendon «çibuku»? Të tjerët thonë: E di «mustaqja»...

Ç'fytyrë kishin ato ditë? Ngjyrat e tyre ndryshonin nga çasti në çast. Sa fiksoje në tru një rëndësi, ja ku vinte tjetra që me rrapëllimë e shtyn-te të parën. Dhe njeriu mendonte se ajo do të qëndronte përgjithnjë aty, kur nga kolonat e gazetave, nga gurmazet e radiove derdheshin rrëkera të tëra lajmesh që shponin dhe hynin brenda kafkave të qytetarëve.

(Q.D. paska qenë e martuar dhe atë ditë ajo qenka pushkatuar së bashku me të kunatin).

...Lufta rrokulliset nga zhvillimet e saj fatale. Italia e Gjermania përparojnë me hovin e pandalshëm të falangës. I madh ka qenë Pirrua, po kishte disa të meta: mbreti i famshëm i stërgjyshërve tanë gjen vdekjen nga një plakë e shushatur. Italia do ta çlirojë Mesdheun prej kontrollit të kuçedrës britanike. Lajmi i lëshuar prej Churchillit se Franca do t'ja dorëzonte flotën e vet Gjermanisë u shfrytëzua për spekulime të poshtra të bursës dhe shkaktoi riuljen e vleftave në Wall-Street. Mbrëmë në shtëpinë tonë erdhi Fanika e Nakos, sepse s'kishte bukë dhe fëmijët po qanin nga uria. Nëna ndau me të bukën tonë, ndërsa ne na shau: «mbylleni, se njerëzit po vdesin...» Jepni Çezarit ç'është e Çezarit. Masat e Japonit shkaktojnë dëme ekonomike për Amerikën.

Tani qyteti i vogël, i struktur midis kodrave të mbuluara me ullinj është vetë një liman erërash

fare të hapura. Çdo erë që fryn në botë, që nga stuhitë e Balltikut e gjer te musonet e Indisë hedh zërat e saj mbi të dhe qytetarët mësojnë emrat e shteteve, qyteteve, gjeneralëve, numrin e divizioneve që luftojnë, të vrrarët... Forcat gjermane përparojnë mbi Paris. Mbrëmë aeroplanë armiq kanë bombarduar Torinon, qytet i hapur, duke shkaktuar dëme e viktima në popullsinë civile. Mesdheu duhet të jetë dhe do të jetë det italian. Vetëm italian. Turqia u qëndron besnike traktateve: ajo nuk ka përse të hyjë në konflikt. Mbeturinat e ushtrisë angleze kalojnë Manshin. Pompeu me Cezarin luftuan në Shqipëri: i pari zbarkoi në Durrës, i dyti doli në Pojan. «Rreth qëndrimit tim në Shqipëri ruaj kujtimet më të mira — Çiano». Në qytet u gjend i vrrarë edhe një spiun...

— Shkruaje.

— Po kjo nuk është për Q.D-en.

— S'ka gjë, ti shkruaje — më tha mua peshkatari. — Ti po kërkon jetën e saj dhe ja ku gjete vdekjen e shokut tënd.

Ç'është e vërteta Fiqriu duhej të ishte cazë më i madh se unë. Po ne bashkë shkoni në shkollë, bashkë luanim me top leckash e bashkë futeshim e këputnim kumbullat e shën-Todrit. Fiqriu ishte djali i xha Beshirit, një muratori të lagjes sonë. Shtëpia e tyre ishte e rrethuar me mure të trasha e brenda oborrit gjithnjë dëgjoheshin thirrjet e grave dhe të qarat e kalamajve. Vetëm dhoma ku flinte Fiqriu me të vëllanë kishte një dritare të vogël, që binte nga udha. Një ditë unë

zgjata kokën dhe e pashë Fiqriun, që po vishte një palë pantallona qillotash. Sa më pa mua, ai vuri gishtin midis buzëve: «shëëët...» Unë e dija, kjo do të thoshte: matanë është nëna... I gjatë dhe i hollë, me një fytyrë të hequr, të bardhë ai u përgëzohej pantallonave-qillota. Pastaj nxori nga xhepi një revole bredë tringo të re.

— Shëët! Unë do të shkoj partizan, — tha ai.

Mua nuk më tronditën ato fjalë. E dija se shumë djem të qytetit tonë kishin shkuar në male. As revolja e tij nuk më tërhoqi shumë. Në shtëpi ne kishim «tetëshen» e babait.

Mua më kujtohej se fill pas çlirimit ne shkornim në shkollë me automatik në krah e bustinë partizane në kokë. Një ditë të tillë, më takoi xha Beshiri. Ai më vuri dorën mbi krye, më përgëzoi dhe tha ngadalë:

— Fiqriu u vra.

Unë këtë e dija. Po xha Beshiri nisi të më tregonte se i biri kishte qenë korrier i një çete partizane dhe e kishin dërguar me detyrë në shtab të zonës. Kështu i kishin thënë atij. I kishin thënë që Fiqriu kishte rënë në përpjekje me ballistët dhe i kishte kaluar ata, pastaj kishte rënë përsëri në luftë me gjermanët. Aty ishte vrarë. Varrin akoma s'ja kishin gjetur. E kërkonin...

Tani, duke pyetur për Q.D., unë kisha takuar një pedagog të ri në Fakultetin e historisë. Për habinë time më të madhe ai më tha se ajo grua paskësh qenë prej fshatit të tij. Ai vetë kishte qenë fare i vogël dhe nuk e kishte njohur, po më të moshuarit flisnin për të. Atëhere unë e pyeta atë për fshatin, për malet, për fushat, për emrat e



tyre dhe se çfarë mbante mend nga fëminia e tij.

— Një varr, — më tha ai. — Një varr të një partizani. Se cili ishte nuk e dinim. Nëna gjithnjë shkonte te ai varr, i rregullonte gurin, i hiqte gjembat dhe i pastronte barin. Ne e kishim shtëpinë në fund të katundit.

Partizani nuk e kishte njohur kurrkush. Kishte ardhur në fshat vetëm atë ditë që u vra. Atje kishte gjermanë dhe ai papritur ishte gjendur në mes tyre.

— Ishte Operacioni i madh i Dimrit dhe vija e frontit kalonte nëpër fshatin tonë. Nëna nga dritarja e shtëpisë e shikonte atë partizan pionier...

— Pionier?

— Pionier... dhe duhej të kishte qenë korrier, se diku shkonte, prandaj ra aty në zjarr të gjermanëve... Thoshin se më parë ishte rrethuar nga ballistët, po e kishte çarë rrethimin e tyre...

— Dale, — i thashë unë atij — dale... Partizani i vogël, korrier, bie në rrethim të ballistëve, pastaj gjendet mes gjermanëve...

— Nëna më thoshte se partizani kishte luftuar në këmbë. Nga dritarja e shtëpisë, ajo e kishte parë atë si hidhej nga një vend në tjetrin, nuk ulej në tokë. Nëna, me vete, i thoshte atij me zë të ulët, «ulu, ore i zi, se do të të vrasin... Ulu, mor qyqar...» Ai luftonte në këmbë...

— Po ai ishte Fiqriu — i thashë unë pedagogut të ri. — Ishte Fiqriu...

— Nëna e kishte parë kur e kishin goditur, — tha ai. — Partizani ishte luhatur disa herë, kishte pështetur automatikun në tokë, ishte përkulur mbi të dhe pastaj kishte rënë... Pas lufti-

meve, natën, nëna e kishte marrë dhe e kishte varrosur vetë... Ne shkonim përherë në varrin e tij dhe e pastronim. Unë atëhere mbaja një fustan të vogël...

Fiqriu. Përsëri u krodha në ato ditë fëminie e vetiu nisa të dëgjoja fjalët e dikurshme të tyre. ...Atdheu mbi të gjitha. Gjithshka për atdhenë. Le të këqyrim llogaritë. Turqia parashikon ta kalojë në paqe edhe vitin e pestë të luftës. (Bukur, besa...). Një gjuhë tjetër thoshte se në qytet ishin zbuluar elementë të dyshimtë. Në xhami, ndërsa ishin duke u falur, ishin vrrarë katër mercenarë.

Duke ecur nëpër udhët e qytetit të vogël unë shihja gurët e praqeve të shtëpive dhe më kujtohej se si gratë i lanin ato mëngjez për mëngjez. I pastronin, ndërsa dita sërish do të derdhte mbi njerëzit shiun e rrëmbyeshëm të ngjarjeve të botës së tërë.

..Gjermania është garancia e Evropës. Triska të reja të bukës. Uria po troket në dyert e qytetit. Proklamata e Fuhrerit: «Më shumë se katër vjet kanë kaluar, tha Fuhreri, qysh nga dita që luftëdashësit ndërkombëtarë, pasi e pregatitën prej kohësh luftën kundër Gjermanisë, më në fund mundën ta shpallnin këtë luftë. Që në këtë luftë nuk do të ketë fitues e të mundur, e kam thënë prej kohësh, tha Fuhreri». Me një gjuhë tjetër qyteti këndon: Gjeneral Guxoni i biri i putanës, me gjithë maskarenjtë na i ra Tiranës.

Me se ushqehet ky qytet i vogël? Një prej

atyre ditëve të fëminisë sime po flet me mua: punëtori shqiptar s'ka bukë të hajë, s'ka me se të mbajë veten, s'ka ç't'u japë fëmijëve. Nuk ka një palë, të paktën një palë rrobe mbi trup. Shkon udhës me opinga të dërmuara, fle dimër e verë në bodrumet e lagura, ndën urat. Rinia këndon: Bruno Musolini ishte aviator, nuk pati benzinë e pshuri mbi motor.

...Nga ballnat e ndryshme të luftës. Balli Lindjes: Kumtesë gjermane. Kumtesë sovjetike. Kumtesë finlandeze. Balli italian: Kumtesë inglize. Fronti në Lindjen e Largme. Tragjedi shpirttrash. «Po të shikohet fillimi i luftës, — thotë Goebelsi, — konstatohet me habi se problemet që ndodheshin në fillim janë lënë ç'prej kohe. Pra — pyet Goebelsi — kush mund të garantojë se një ndryshim i tillë nuk mund të shkaktohet edhe një herë deri në mbarim të luftës? Ç'mendon «çibuku»? Të keqen e «mustaqes»...

Në darkë ne hapim hartën gjeografike dhe nën dritën e paktë të llambës me vajguri kërkojmë frontet e luftës, qytetet, lumenjtë, hekurudhat, të gjithë lëvizin me shenjëzat e tyre të gjelbëra, blu, të kuqe, lëvizin e hyjnë nëpër thellësitë e shikimeve tona. Ato shenjëza e viza tani sikur shembëllejné me venat e damarët, që përçojnë gjakun nëpër fundet e syve njerëzorë. Ashtu fiksohen në thellësitë e syve të fëminisë sime ato copra të globit tokësor. Qyteti i vogël tani ushqehet me lajme nga më të ndryshmet. Qytetarët mbrëmjeve rruftin shpejt nga një tas kos me babanace e shkojnë e përgjojnë gurmazet e radiove, lexojné komunikatat e Frontit nac.çlirimtar. Koha është e tillë,

Në këtë kohë nuk jeton ai që ka barkun plot, por ai që ha më shumë lajme nga bota e tërë e nga luftërat.

M'u kujtua berberi dhe ai peshkatari. Berberi më pati thënë: «sikur s'më besohet, kemi qenë ne? Ne kemi qenë vërtet?»; ndërsa peshkatari i përkulur i tëri mbi mua më kishte pyetur: «Pak të duket ty?». . . Një detaj fare i vogël, që nuk është shënuar gjëkund dhe që, po të mos e kërkoja, ai peshkatari vetë, ndofta nuk do t'ja kishte thënë kurrkujt: një ilegal, i mbështjellë me xhaketën e vet ndjek nga larg atë karrocën, që tërheq partizanët e vrarë. . . Si kemi qenë ne atëhere, si ai ilegali, që ndiqte pas atë karrocë në atë ditë prilli '944?

Unë shkova në bibliotekë dhe hapa gazetën e asaj dite. News Chronicle: Me fjalimin e fundit Churchilli humbi prestigjin e tij, tue detyrue parlamentin gati me dajak të jepte vetëbesimin. Mos t'i hanë ushqimet tona spekulantët e huaj. Nga Ballnat e ndryshëm të luftës: Balli Lindjes. Komanda e Lartë e fuqive të armatosura gjermane komunikon se sovjetikët vazhdojnë të sulmojnë me fuqi të mëdha këmbësorie dhe karrosh të armatosura. Luftohet midis Dniesterit dhe Pruthit. Fuhreri përtëriti besimin: «Ne do të fitojmë».

Në ato ditë në qytetin tonë pushkatoheshin pesë vetë dhe emri Q.D. hynte në jetën time përgjithnjë. Në mbrëmje, sapo te ne vinte xha Zanua, shtronim hartën mbi dysHEME, afronim aty llambën me vajguri dhe të mbledhur kokë për kokë fillonim të pyesnim: **Është shumë larg Pruthi?** Kërkonim copra të botës së largët, me ato shenjë-

za e vija të holla, të kuqe, blu, disa fare të padukshme nëpër të cilat rridhte gjaku i njerëzimit, si nëpër ato fije të holla të venave nëpër fundet e syve tanë rrjedh gjaku, që ushqen të parët.

Ç'sy të tjerë mund të kishte fëminia ime?

### III

Të gjitha erërat më çonin drejt burrit të saj të dikurshëm. Veç po ato erëra më mbanin edhe larg tij. Jo vetëm sepse e dija që nuk është e këndshme ta kthesh e t'i kujtosh njeriut kohën, kur ai ka humbur njerëz të afërt e të dashur, po edhe sepse tani ai ishte i martuar e kishte krijuar familje tjetër. Tjetër grua. Fëmijë. Tjetër jetë. Po detyra e shkrimtarit ka edhe ajo ligjet e veta të «hekurta». Dhe atyre nuk u shpëtoke dot. Herë-herë ti sjell me vete shqetësime, të cilat nuk do të dëshiroje t'ua shkaktoje të tjerëve, ashtu si nuk do të dëshiroje që edhe ata të t'i shkaktonin ty. Po ç'të bësh? Të gjitha erërat mua më çonin drejt atyre njerëzve. E unë u nisa tek ata.

Derën e shtëpisë ma hapi një djalosh i ri, i shkurtër. Pastaj në korridor një grua më doli përpara.

— Urdhëroni — tha ajo... e mori të haptë dhomën e pritjes; kur djali tha: — Babai është këtej, në kuzhinë. Është pakëz pa qejf...

— Oh, po s'ka gjë — thashë unë, dhe u ktheva nga kuzhina.

Përkulur mbi tavolinë, midis fletoresh e librash përgatitte mësimet një djalë i vogël. Në një ishte ulur një burrë plak. U përshëndoshëm. Pas meje, aty brenda hynë edhe djali i madh dhe gruaja. Gjithë familja. Folëm për motin. Ishte dimër e binte shi. Bënte ftohët. Aty babai i shtëpisë ishte sëmurë, vuante nga tensioni e s'ndjehej mirë. Duke biseduar për gjëra të përgjithshme, vështroja atë burrë. Sa mund të ishte? 70-72 vjeç? Me flokë të thinjur dhe i dobësuar. Folëm për mësimet e djalit më të vogël dhe për ushtrimet e vështira, që i kishte dhënë atë mbrëmje mësuësja. Djali kishte një trup të imtë e qafë të hollë, të gjatë, shkonte mirë në shkollë dhe prindërit ishin të kënaqur. Qeshëm. E përsëri midis nesh ra heshtja. Kurse unë duhej të filloja... Njeriu që më rrinte pranë, dikur kishte qenë më i afërti i asaj gruaje që, papritur, hyri në mes të jetës sime. Ajo më ndjek pas ngado me atë vizionin e trishtuar të asaj dite prilli '944. Herë i afërt, herë i largët, ai është përherë me mua, po përsëri një vizion. Kurse njeriu që kisha pranë, dikur e kishte prekur atë grua, ashtu si unë, po të zgjatja dorën tani, prekja vetë atë.

— Ndofta — i thashë unë — ndofta ne të dy duhet të mënjanohe mi pak... Ju e dini përse kam ardhur...

— Posi... — plaku mbështeti krahët mbi një, mori të ngrihej, kur papritur gruaja tha:

— Pse? Ju mund të bisedoni edhe këtu... lirisht... Mos u shqetësoni fare...

Kjo ishte e papritur për mua. Kisha përfytyruar familjet tona patriarkale me ato marrëdhënje

bashkëshortore të ngurta. Dhe nuk dija se si do ta priste ajo grua vajtjen time atje. Më kujtohej se si gjyshja e nëna herë pas here shqiptonin me neveri dhe urrejtje fjalën «singër». Dhe këto ishin singra për njëra-tjetrën. Njëra e gjallë, tjetra e vdekur. Po përsëri singra.

— Ju mund të bisedoni lirisht. . .

Tanimë isha vetëm me burrin me kokë të thijnur e me fytyrë të zeshkët të dobësuar prej pleqërisë e sëmundjes.

— Ju keni qenë i martuar me Q.D-en — i thashë unë.

Plaku qëndroi i heshtur. I qetë. Edhe unë përpiqesha të isha gjithnjë po ai, veç e kuptoja se që të dy, me atë dukurinë tonë të heshtur e të qetë, fshihnin mendime nga më të ndryshmet. Një copë herë midis nesh ra heshtje. Shihnim njëri-tjetrin në sy e s'flisnim.

— Kur e njohët për herë të parë?

Vetëm tani plaku lëvizi. Po përsëri u tulat dhe heshti. Donte të ndillte kujtimet e largëta. Mendova se nga kujtesa e tij koha kishte shlyer shumë gjëra, kur ja ai filloi të fliste më rrjedhshëm nga sa e prisja:

— Duhet të ketë qenë viti 1913 — tha. — Atëhere unë isha në Vlorë. Mësoja në shkollë. Në shkollën Nr. 1. Na jepnin mësim Mulla Xhaferri, Mulla Jaupi. . . Një ditë më lajmëruan nga fshati se nëna më kishte fejuar. E kishte parë çupën dhe e kishte pëlqyer. Kishin dërguar edhe mblesin. Babai më kishte vdekur atëhere. Motrat ishin martuar. Në fshat kisha vetëm nënën e vëllain e vogël. Dhe nëna vetë më fejoj. Unë nuk ja prisja. . .

Njëherë moti në fshat tregonin se si njeriu mëkatar shkoi te njeriu i mirë dhe i tha:

— Unë jam mëkatar. Dhe dua të laj gjynahet që kam bërë...

Njeriu i mirë u mendua gjatë dhe më në fund u përgjegj:

— Ti do të kërkosh e do të gjesh një vend ku kalojnë udhëtarë. Aty do të hapësh një tokë të mirë e do ta mbjellësh me shalqij të ëmbël e të mëdhenj. Dhe do t'ua dhurosh udhëtarëve, kujtdo që të kalojë.

— Pa para?

— Pa para. Falas. Kushdo që të kalojë, le të provojë nga shalqijtë e tu. Dhe ke për të parë se mëkatet do të të lahen.

Ashtu bëri mëkatarin. Hapi ndanë udhës një tokë dhe e punonte dhe e mbillte me gjithfarësor shalqijsh e pjepra të ëmbël. Dhe, kujtdo që kalonte andej, i dhuronte diçka nga bostani i tij. Udhëtarët e merrnin dhe e falenderonin. Njeriu ndihej i gëzuar e i lehtësuar.

Një ditë u duk në udhë një kalorës. Kishte hedhur krahëve bërucin e ri dhe ngiste kërrin re- van. Tek po shkonte ashtu, atë e thërriti i zoti i arës dhe ju lut që të merrte një shalqi të ëmbël. Vapë ishte dhe do ta shijonte shumë. Njeriu me bëruc nuk zbriti prej kali. Ai tha vetëm:

— Shko, more... me gjithë shalqinin tënd...

Atëhere i zoti i bostanit i shkoi pranë dhe ju lut:

— Merre... nuk është kushediçfarë, po merre, se ashtu e kam hallin...

— Hiqmu... qelbash... — Njeriu me bëruc shpoi



yzengjitë dhe kërru u nis revan nëpër atë rrugë gjithë pluhur. I dëshpëruar, i zoti i shalqijve u kthye në arë. Papritur rrëmbeu dogranë dhe shënoi; pastaj pa nga larg se si kalorësi u hepua e ra prej kalit, që e tërhiqte nëpër xhadenë gjithë tym.

Shkoi atëhere njeriu mëkatar te njeriu i mirë dhe i tha:

— Më the të mbjell diçka e t'ua fal njerëzve. Dhe unë ashtu bëra. Po mëkatet nuk m'u pakësuan. Sot vrava një tjetër njeri. Ai nuk e pranoi shalqinin tim dhe unë e vrava. Mëkatet u shtuan.

— Ah, jo — tha njeriu i mirë. — Ti vrave po nuk mëkatove. Ai kalorës ishte nisur të prishte fatin e një vajze.

— Unë nuk e prisha fejesën — tha plaku.

— Atë, kur e pe për herë të parë?

— Kërkoja ta shihja... E kërkoja gjithnjë po ajo më fshihej. Dhe, saherë shkoja në fshat, nuk e shihja dot. Kurrë nuk më dilte përpara. I thashë nënës e ajo i tha vjehrrës. Po as vjehrra nuk donte. Nëna mezi e bindi. Lanë fjalë që të shiheshim te çesma e fshatit. Unë shkova së bashku me nënën për të mbushur ujë. Ajo erdhi me dy shoqe. Cila ishte e fejuara ime? Nëna më pëshpëriste: «Të keqen; kjo është nusja jote...» Po unë as që e njoha dot. Vetë ndofta kisha më turp se ajo.

Një e qeshur fëmije këputi në mes bisedën tonë.

— Baaabiiii... — thirri djaloshti ime atë qafë të hollë e të gjatë. Kishte harruar detyrat e shkollës mbi tavolinë e po na dëgjonte. — Babiiii.

— thirri ai duke qeshur. Atëhere qeshëm të gjithë. E ashtu mua m'u kujtua ajo gruaja e pushkatuar asaj dite të ftohtë e të trishtuar të prillit '944. Ajo sikur po shkonte para meje, vajzë e vogël, me gjymin në dorë për në çeshtë.

— Zbathur ishte?

Plaku uli kokën. Mendohej.

— S'më kujtohet — tha —pastaj... kaloi kaq kohë... Pleqëria...

Oh, kjo «kaloi kaq kohë...» Brenda kësaj shprehje, që e ndesh ngado, janë gërryer kujtimet e njerëzve. «Kaloi kaq kohë» — Ngadalë, pa u ndjerë e pa kuptuar, koha përllau nga kujtesa fytyra të tëra, të dhëshura e të dashura, si ai ujët që përllan tokën. Po mbresat e rinisë plakut i kujtoheshin mirë, dhe unë atje e drejtova kujtesën e tij.

— Më 1919 më vdiq nëna. Vdiq prej gripit spanjoll. Ishte grua e gjatë dhe e hedhur, si burrë. Sa ishte gjallë, shtëpinë e drejtonte vetë. Ajo vdiq. Në fshat më mbeti vetëm vëllai i vogël. Atëhere unë doja me çdo mënyrë të hapja shtëpinë. Kështu që, pas gjashtë muajsh të vdekjes së saj, u martova.

Mora një mish e rregullova në Brataj. Një çap. Dhe pesë kile raki. Erdhën xhaxhallarët dhe ata shkuan të merrnin nusen. Atë e prunë në shtëpi mbuluar me flamur të kuq, me cipullë, si i thoshin atëhere. Gratë dolën ta prisnin. Nuk këndonin. Atë kohë kishte rënë gripi spanjoll e në fshat kishin vdekur shumë njerëz. Të gjithë pothuajse ishin në zi. As me armë nuk u godit. «As me armë» — tha përsëri e i menduar me vete plaku...

Këtë fjalë ai e përsëriti dy herë. Vetëm këtë.

Dhe herën e dytë duke qenë më i trishtuar se më parë. «As me armë...»

Në fisin tonë pushka është shkrepur përherë në lindje e në dasmë, në pritë e në shesh të burrave. Kur unë isha i vogël, këndonin një këngë për fisin tonë e të brahime. Tregonin se ishte bërë gjak. Kishte krisur. Dhe për një grua kishte krisur. Tanët kishin vrrarë të parët. Pastaj duhej të vrisnin ata të brahime. Dhe ata zunë pritë. Sadedini, plaku 90-vjeçar, urdhëroi djemtë ta ngrinin kaliboç e ta çonin gjer poshtë te sheshi i xhamisë. Atje u ngrit pusia. Dhe aty krisi. Nga njëra anë luftonte Lilua, nga ana tjetër Sadedini. Dhe të tjerë andej e të tjerë këndeje.

Në luftim e sipër Lilua ngriti kryet e pa dhe desh t'i thërriste e ta qesëndiste Sadedin plakun, po ai e shënoi. E goditi vetë, mu në lule të ballit.

— Një e një.

Djemtë e morën përsëri në kurriz të gjyshin dhe e ngjiten në mal.

E këndonin këtë këngë dhe tregonin ndodhinë. Unë mendoja vetëm për Sadedinin 90-vjeçar, që mbi kurriz të të bijve zbriste në pusi, luftonte e pastaj përsëri mbi kurriz të djemve ngjitte malin, që të shpëtonte nga hakmarrja e tanëve. Gjithnjë ne e kemi shkrepur, po vetëm në atë dasmë jo...

Plaku fliste me zë të ulët. Mbante në dorë një bisht kalemi e, bënte ç'bënte, shtypte me të cepin e tavolinës. Shihja gjurmët që linte bishti i kalemit mbi mbulesë dhe dorën që dridhej tek shtrëngohej mbi të. Kurse nga jashtë ai dukej i

qetë. Djali i vogël mbaroi detyrat e shkollës dhe erdhi e qëndroi te supi i të atit. Djali i madh pranë meje rrinte i heshtur në karrigë e dëgjonte. Gruaja, pasi na solli likerën e kafenë, mori bizat të punonte.

Jashtë binte shi. Ishte një shi i rrëmbyeshëm e gurgullimë dëgjohej gjer brenda. Herë pas here shkrepnin potershëm bubullimat e qiellit të Vlorës. Dhe mes tyre në atë kuzhinë derdhej zëri i burrit që kisha pranë:

— Nusen e vunë në konakun e mbyllur. Dhe mua filluan të më tërhiqnin mënjanë burrat e të më jepnin lloj-lloj porosirash. Duhej që, kur të hyja, t'i shkelja asaj fort këmbën e djathtë. Që ta kisha përherë nën sundim. Burrin e rruanin ditën e martesës. Unë s'kisha qime në faqe, po prapë një shok më rrojti. Te dera e dhomës së nuses më qëlluan me grushte. Thërrisnin e talle-shin. Mua më rrihte zemra. Aty do ta shihja atë për herë të parë. Atëhere nusja sillte pajën e vet në një sepet. Dhe në shtëpinë e burrit, kur vinte ditën e porë, ashtu qëndronte, në këmbë te cepi i sepetit. Kurse dhomën e saj rreth e qark e ruanin gjitonë e të afërt, që të mos i bënin ndonjë magji.

Hyra në dhomë. Ajo, e mbuluar në cipullën e kuqe, qëndronte shenjt te cepi i sepetit. I shke-la fort këmbën e djathtë dhe ja hoqa flamurin e kuq nga kryet...

Një dhembje e thellë po ma shtypte kraharorin. Isha nisur në rrugë të zbulimit të një jete. Atë jetë e kishin pushkatuar SS-ët te xhamia e tabakëve asaj dite prilli '944. E kishin pushkatuar

një ditë të fëminisë sime. Ashtu, jeta e asaj gruaje vetiu ishte takuar me timen. Dhe unë isha nisur e doja ta njihja atë, po tani këto që po më tregonte ky plak ishin të trishtuara. Nëpër varfëri e trishtim kishte mbirë jeta e asaj gruaje. Dreqi e di se me çfarë ligësie ka punuar në shekuj truri i fanatikut, i injorantit dhe i shtypësit...

— I hoqa cipullën — thoshte plaku, duke shtypur nervoz me dorë të dridhur cepin e tavolinës. — Ja lashë mënjanë. — Hajt, të ulemi, -- i thashë. Dhe ne u ulëm në një shilte. Gjysma tjetër e dhomës ishte e pashtuar, prej balte. I thashë se isha djalë i vetëm dhe nënën e saj edhe unë do ta kisha nënë. Ajo s'bëzante. Rrinte kokulur dhe heshte. M'u duk shumë e vogël. Aty unë ndenja vetëm 15 minuta e dola. Shokët prisnin te dera e konakut. Ata qëllonin me grushte mbi portë. Kur dola, disa më trazonin: «Eh, more, sesi na dukesh tani... ndryshe të qesh fytyra». Për nusen s'thoshin gjë. Ishte çështje nderi.

E kuptova që ai s'donte të fliste shumë mbi nusen, prandaj e pyeta se si ishte ajo dhe si ju duk në fillim.

— E vogël — tha ai prapë. — Ne u ulëm të dy në shilte dhe ajo m'u duk shumë e vogël.

Gruaja vazhdonte të punonte bizat aty te cepi i sobës. Djali i vogël rrinte në këmbë mbështetur në supin e babait plak.

— Po si t'u duk? — i thashë unë... — a ishte e bukur?

Koka e thinjur u ngrit dhe plaku më pa në sy. Në fytyrë të tij dukej ai naivitet i fshatarëve tanë, që sikur duan të thonë «s'po të kuptoj...»

Mendova se ndofta atij nuk i kujtoheshin dot, pas 50 e ca vjetësh, ato çaste të para të jetës bashkëshortore. Po gjer atëhere ai kishte folur rrjedhshëm. Rinia pra nuk ishte shlyer krejt nga kujtesa e tij.

— Ç'të pëlqeu tek ajo më tepër?

Fytyra e mbledhur, korrozezë e njeriut pranë vazhdonte të më shikonte në sy e nuk fliste.

— A ishte e bukur?

— E pashme... — i tha këto fjalë, sikur të thoshte diçka të rëndë, të fajshme. Dhe, kur dëgjoi të qeshurën e gëzuar të djalit të madh e të së shoqes, aty për aty edhe ai e vuri buzën në gaz. Po ajo ishte një e qeshur, të cilën thua se dikush ja ngjiti mbi ato dy buzë. Dhe ashtu qëndroi ajo e ngrirë dhe e ftohtë. Me gjithë pleqërinë e jetën e tij të kaluar, ai mbetet prapë fshatar, lab. Dhe «burrë». Ato gjëra s'mund të thuheshin. Po ajo ishte jeta intime e asaj gruaje. Atë jetë e dinte vetëm ky njeri me moshë të thyer, me flokë të thinjur, që tani bisedonte me mua. Askush tjetër nuk kishte ndjerë nevojën e ngrohtësisë së trupit të saj, si ai. «Këto janë gjëra që s'thuhën». Dhe unë, i trishtuar, e kuptova se ajo anë e jetës së asaj gruaje të pushkatuar do të më mbetej e panjohur. Ajo do të mbetej për mua (dhe ndofta jo vetëm për mua) diçka e ndaluar. Mund të mësoja gjëra të tjera, se si luftoi, se si vdiq, po jo kurrë edhe se si dashuroi. Sikur gruaja, që shkante drejt vdekjes asaj dite prilli '944, nuk ishte po ajo, që me drithërimë në zemër ulej mbi nim të dhomës gjysmë të zhveshur, sepse edhe ajo për herë të parë dëgjonte zërin e atij, me të cilin do të kalonte je-

tën e vet... Desha t'i thoshja plakut: «bukuria e saj, dashuria e saj, nuk janë vetëm prona juaj. Ato na takojnë edhe neve. Të gjithëve. Dhe ju s'keni të drejtë ta mbani mbyllur në veten tuaj...» Po isha i bindur që s'do të më kuptonte.

Diçka e brendshme më thoshte se Q.D. nuk duhej të kishte pasur fytyrën e madhe e të papërcaktuar të gruas që kisha parë në fotografinë e muzeut. Ajo duhej të kish qenë tjetër. Me doemos tjetër. Po si? Ngado që ktheheshin mendimet e mia, ajo grua s'mund të më shfaqej ndryshe, veçse me atë shami të lidhur në kokën e madhe të ngritur lart, gati sa rrëzohej pas, me atë ballë të gjerë dhe ata sy të hirtë në mugëtirën e tyre. Sido që ta mendoja, ajo fytyrë ishte e vetmja që më dilte përpara e që nisi ngadalë të përpinte mendimet e mia. Vetiu fillova të përfytyroja edhe shtatin e saj të madh e të fortë, me një zë të trashë burri. Ashtu po ngrihej në imagjinatën time ajo gruaja e pushkatuar asaj dite prilli '94 atje te xhamia e tabakëve. Po që në çastin e parë, kur, i vetëm, u gjenda në sallë të muzeut përballë me të, e ndjeva se njeriu të cilin kërkoja, sikur nuk ishte ai. Nuk mund të ishte ai. Edhe përshkrimet e pakta të atyre që pyesja këtë më thoshin. Dhe prapë ato s'arrinin të davaritnin dot prej meje përfytyrimin e parë të marrë prej fotografisë.

— Nuk keni ndonjë fotografi tjetër?

— Kemi — tha përnjëherësh djali i vogël pranë meje. Po kurkush nuk luajti prej vendi. Për mua ishte pothuajse gati e pabesueshme. Pyeta si të thuash, për të pyetur, pa ndonjë shpresë të vërtetë. Plaku u ngrit ngadalë, kaloi derën

e kuzhinës e hyri tej nëpër dhoma. Ne qëndruam aty të heshtur. Herë pas here veshi im pipëz kapte ndonjë trokëllimë rafti, që vinte nga dyert e hapura. Ku po kërkonte ai tani? Dhe ç'mendonte? Me atë grua ai kishte kaluar një jetë të tërë. Ajo nuk ishte më. Kishte vdekur. Fëmijë ata s'kishin pasur. Pastaj ai ishte martuar. Dhe kishte bërë dy djem. Po atë e kishte mbajtur aty, në ndonjë raft të dhomës së tij, në ndonjë kthinë të zemrës së vet. M'u dhimbs ai njeri. I shova dritat e imagjinatës sime, sikur t'u fryja vetë qirinjve të ndezur. Në fund të fundit tashmë gjithshka kishte kaluar. Ajo s'ishte më. As vendi i saj nuk ishte më i zbrazët e bosh. Dhe kështu kudo. Edhe tek ai plak — tashmë gjithshka ka zënë vendin e vet. Dhe jeta i ka këto. Sentimentalizmat... Çfarë, edhe ato nuk janë të huaja për jetën. Asgjë njerëzore nuk është e huaj për ne. Njerëzore... po sa njerëzor mund të ishte tani ky takim atje në errësirë midis atij plaku dhe asaj gruas së pushkatuar atë ditë prilli '944.

Brenda rrëshqiti hieja e plakut. Ai erdhi drejt meje, duke mbajtur në duar një fotografi të vogël. Ma zgjati. Duart i dridheshin. Edhe fotografia para meje dridhej. E mora përnjëherë. Ajo që pashë ishte e papritur, e pashpjeguar për mua. Thujajse nuk po kuptoja gjë. Mbaja me vete vizionin e asaj gruaje, me ata sy të papërcaktuar e atë kokë të madhe. Dhe, megjithëse diçka e brendshme më thoshte se nuk duhej të ishte e tillë propë, kur plaku më shtriu përpara duart me fotografinë e vogël, përsëri prisja që ajo, vetëm ajo, të më dilte përpara; ajo, me atë mugëtirë në sy, me atë shami të zezë të lidhur mbi ballë. Kur...



nga fotografia e vogël po më shihte një grua e re, e re. Me një fytyrë të rrumbullakët, të bukur. Të bukur thashë? M'u duk një bukuri e rrallë. Dy sy të kaltër e të shndritshëm nën një ballë nga më femërorët. Ajo qeshte. Tek e shihje ashtu, thua sikur gjithë qenja e asaj gruaje qeshte. Nuk di përse diçka e papritur buroi tek unë. «Ajo është», murrurita me vete. «Ajo është»...

#### IV

— Sot — i thashë unë kamerieres, që më sollu kafënë — do të jetë një ditë e bukur. Duket edhe prej fytyrës suaj...

— Kjo duket në çdo fytyrë, — tha ajo duke qeshur.

— Oh — i thashë unë — kam menduar se nga fytyra ime mund të parashikohet vetëm mbrëmja.

— Edhe mbrëmja e kësaj dite duhet të jetë e bukur — tha ajo.

Piva kafënë e dola jashtë. Vetëm një vetull dielli sapo kishte dalë mbi kodra. Frynte një erë e ftohtë mëngjezore. Udhëtarët ishin ende të rrallë nëpër rrugët e qytetit. Unë dëgjoja hapat e mi, që trokisnin nëpër kalldrëme e asfalte. Troku i tyre përzejehet me mendimin se Q.D. nuk ishte më për mua një grua e pushkatuar, e rënë përmbys, me fytyrë të panjohur e të papërcaktuar. Ai plaku natën e kaluar sikur kishte ecur mes

për mes asaj dite me shi të prillit '944, midis SS-ve, e ngadalë e kishte kthyer atë. Tani, ngado të hidheshin mendimet e mia, më dilte përpara ajo grua e re, me atë trup mesatar e të lidhur, me atë buzëqeshje, që gati tretej në ngjyrën e bardhë të trëndafilave që mbante në duar. Duke ecur ashtu, pa kuptuar edhe vetë, unë kisha hyrë në bisedë e flisja pareshtur me të.

S'më besohet, i thoshja unë, që fëminia jote të ketë qenë kaq e ashpër dhe e hidhur. S'më besohet. Ti s'mund të kishe një fat kaq të egër në jetë. Nuk duhej. Patjetër që jeta iote duhej të kishte qenë ndryshe. Ajo më shikonte prej fotografisë dhe heshte. Vërtet aq e trishtuar ka qenë martesë jote? Një cjaq e 5 kile raki... Vetëm një cjaq e 5 kile raki? Jo, atëhere për ty diku janë kënduar këngë të bukura. S'ka si të mos këndoheshin. Në fund të fundit, si lindin këngët? Në fund të fundit, përse lindin këngët? Përse? Dhe cili do t'i meritonte ato më tepër se ti, me këtë buzëqeshje gati fëminore, që për herë më ndjell, dhe unë tani po vij pas, po të ndjek? Kush do t'i meritonte ato, në mos ti me këto sy hapësire deti? Ka këngë nga më të ndryshmet. Po vërtet, në fund të fundit, si lindin këngët? Dhe kush mund t'i përkundë ato më mirë se sa varfëria e trishtimi? E pamundur. Kushedi sa këngë janë thurur atëhere për ty. Jo? Vetëm për ty — jo? E pamundur. Besomë mua. Kushedi sa këngë me atë fytyrën tënde të vogël e të gëzueshme kanë ecur nga buza në buzë po, me sa duket, ato kanë qenë të drojtura, ashtu si vetë jeta jonë, e nuk kanë guxuar të të dalin kurrë përpara Besomë

mua. Ato këngë kanë qenë të drojtura, po ashtu si ti, atje te çesma, zbathur, me gjym në dorë, që s'guxoje të shihje në sy askënd. As të fejuarin tënd. Dhe ashtu si ti u ikje njerëzve, ashtu edhe këngët ndofta u iknin atyre. E njerëzit s'i kanë dëgjuar. Njerëzit nuk i njohin. As ti. Po ato diku ekzistojnë. Diku i këndojnë nëpër këngë të tjera. Dhe për bukuri të tjera. Unë kam dëgjuar plot prej tyre. Do të t'i them? Do?

*Nënë, që të rriti ty,  
ku e le të mjerënë?  
Babait, që të rriti ty,  
kush do t'ja hapë derënë?»*

Këtë këngë unë e kam dëgjuar në një dasmë tonën. Këndonin njerëzit. Në dasmën tënde nuk kënduan fare? E pamundur. Po si mundet të mos kenë kënduar? Ç'zemra burrash kanë qenë ato? Heshtën... Si mundet? U hutuan para bukurisë sate? Dhe u tultitën... Apo mbetën po ato që ishin. Edhe pasi të panë ty, ato mbetën po ato? Ç'trishitim... Unë nuk mund të jem i njëjti në çdo ditë. As mund të jem i njëjti para çdo bukurie. Ajo është për mua si rrezja e diellit për gjethet e trëndafilin të bardhë, që ti mban në duar. Diçka marr prej saj. E diçka i jap asaj. E në çdo çast nuk jam ai që kam qenë. Jam dikush tjetër. Tjetër jam edhe sot, pasi të njoha ty.

Hyja nëpër MAPO, mes turmës së njerëzve, qëndroja para shtëpive të gurta, të bardha... Q.D. ishte po ajo. Ngado nëpër ajër më dilte përpara me ato sytë e saj të kaltër. E më ndillte në atë bisedë të pambaruar. — Oh — i thoshja unë —

në dasmën tënde nuk kënduan, kurse unë di kaq  
e kaq këngë...

*«Maxhare, leshëra tëndë,  
gërshetat shtatë pëllëmbë...  
Dhe kur shkon i shkel me këmbë.»*

Ti qesh? E ke dëgjuar këtë këngë? Pa dyshim  
që e ke dëgjuar. E këndonin pleqtë edhe në ko-  
hën tënde. Ah pleqtë! Ah pleqtë! Për të thurur vetë  
këngë të bukura duan... Dhe duan t'i dëgjojmë  
ne. Të dëgjojmë se ç'këngë këndojnë ata. Dhe të  
kuptojmë ne, më të rinjtë, që mendojmë se vetëm  
ne jemi, se vetëm ne kemi për të qenë gjithmonë,  
të kuptojmë se dikur si ne kanë qenë edhe ata...  
Dhe si kanë qenë se...

*«U ngre e zonja në këmbë,  
gushënë me vergje zënë...  
Edhe pakëz që kish lënë,  
shkëlqen si bora në hënë...»*

Pleqtë edhe këtë këngë e këndonin me pote-  
re. Duke gjurmuar jetën tënde, unë zbulova kaq  
këngë të tyre. S'i kanë thurur keq, qerratucët.  
Aspak.

*«Hanko, mos shkel nëpër varre,  
se të vdekurit i ngjalle,  
Hanko, mos shkel nëpër gurë,  
ngjallen turq, ngjallen kaurrë...»*

Të gjithë. Para bukurisë ngjallen të gjithë.  
Edhe vdekja. Qoftë ajo «turke», qoftë «kaurrë».

Ngjallet e rend pas bukurisë. Ajo, vdekja është vetëm një, ashtu si është një edhe bukuria. Vdekja vetë nuk do të jetë e ndryshme, aty «turke», këtu «kaurre», kur vetë bukuria është një. «Hanko, mos shkel nëpër varre...?» Dhe shko pastaj e ha-hu me pleqtë. Me pleqtë. Me kohërat e thinjura, thujaj... që e kanë shtuar këngën e tyre pikë-pikë, si ujin shiu. Dhe ai është mbledhur. Është formuar ai rezervuar gjigant, ku tani ti këndon: «Hanko, mos shkel nëpër gurë...». Dhe kaq breza njëherësh të përgjigjen: «zgjohen turq, zgjohen kaurrë...» Vetëm për ty kurrkush s'këndoi. Për ty...

Jeta jote nuk duhej të ishte aq e ashpër. Më kujtohet se si të hiqnin osh prej këmbëve lidhur pas karros. Dhe tek të shoh tani, sikur s'më besohet. Si mund të silleshin ashtu me ty? Gjatë gjithë jetës së tyre SS-ët shtypën e vranë bukurinë. E vranë me një tërbim të atillë sa, megjithëse s'kanë kaluar vecse 25 vjet, njerëzit sikur fillojnë të mos besojnë. U duket si ëndërr. Dhe ata do të dëshironin që të ishte ëndërr. Do të dëshironin të mos ishte i vërtetë ai tërbim me të cilin SS-ët e vranë jetën në ato ditë. Po ti... po ajo karrua... që edhe tani ecën nëpër mendimet e mia e ngarkuar me partizanët e vranë... dhe unë ndjej rrotat e hekurta të saj, barrën e saj, që shkel mbi ato ditë. Do të dëshironin... Po unë e dëgjoj edhe tani atë karru tek shkon e ngarkuar me barrën e saj... Q.D. qeshte e s'të thoshte asgjë. Dhe atëhere unë e kuptova që ajo s'mund të fliste. Unë e njoha atë si të thuash fizikisht. E dija se kush ishte. Po për të folur ajo nuk fliste dot.

Shkoja midis qytetarëve. Futesha nëpër mëha-

llë të vjetra e rrugë të dikurshme, dilja trotuareve të reja. Jeta, i thoshja unë asaj, është sjellë shumë ashpër me ty. Kurse ti me vetë bukurinë tënde e ke dashur dhe e ke respektuar atë. Q.D. vetëm qeshte dhe heshtte. Dhe atëhere unë ndjeva se si midis kësaj gruaje të re, me zambakë Parisi të bardhë në duar, dhe asaj gruas me sytë e hirtë e të mjegulluar, që pashë në muze, kishte një gjë të përbashkët: heshtja.

Këmbët vetë më kishin çuar atje, te ish-sheshi i gjerë, ku dikur ngrihej xhamia e tabakëve. Tani aty ngriheshin një grumbull ndërtesash të reja dhe në murin e njerës prej tyre zbardhte pllaka përkujtimore: «Këtu më 4 prill 1944 u pushkatua dëshmorja Q.D.» Ajo ditë lufte e gjaku, sakrifice dhe heroizmi kishte hyrë brenda asaj pllake të thjeshtë përkujtimore. Dhe qëndronte aty. Qysh në kohërat e lashta kështu ka qenë; qysh atëhere njerëzit kanë ndjerë nevojën që ditët e spërkatura me gjakun e lirisë t'i mbajnë pranë përherë.

## V

Njëri gjurmim më çonte te tjetri, njëra pyetje te tjetra. Ku nuk shkoja? Në njerëz fare të ndryshëm. Më thoshin se «ai e njihte shumë mirë...», më thoshin se «ata bashkë kishin qenë shokë në Paris...», «Oh — më tha dikush — në luftë ata të dy kanë qenë shokë të ngushtë...» E unë shkoja atje. Pyesja. Mbas takimeve, shihja se

ato që mund të mësoja mbi Q.D-en ishin grimcëza-grimcëza... «Duhet të ketë qenë... Atje ishte edhe Halim Xhelua... Veç, të them të drejtën, s'më kujtohet përse u bisedua...». «Q.D.? Unë e kam takuar vetëm në restorantin ku punonte, vetëm atëhere...» «Nuk më kujtohet mirë... po akëcili duhet ta dijë në ishte apo jo në varrimin e Ali Kelmendit...» Unë endesha nga njëri te tjetri. Mendoja se ku ishin takuar jetët e atyre njerëzve dhe ku ishin ndarë. Më shpesh shihja se në të vërtetë ato as ishin takuar e as ishin ndarë gjëkund. Vetëm sa ishin parë kalimthi nëpër rrugë të jetës... Kalimthi. Dhe kaq. Kurse njerëzit flisnin. Nisnin me Q.D-en e mbaronin me veten. S'kishin ç'të thoshin më për të. Ajo që mund të tregonin ishte vetëm jeta personale e tyre. Po kjo gjë gjithnjë ishte interesante për mua.

— Oh, — më tha mësuesi trupvogël e thaim në kafe Tirana — ajo ka qenë një revolucionare e madhe... po ç'e do... — Ai zgjati dorën e mori prej tavolinës gotën e sifonit.

— Si ç'e do?

Ai vazhdoi të pinte.

— Di dhe unë — tha pastaj duke lëvizur në ajër pëllëmbën e tij të vogël... — Di dhe unë, se si vdiq ashtu...

— Si vdiq?

Mësuesi nuk e zgjati më. E hodhi fjalën gjetiu dhe unë e kuptova që ai s'donte ta ngiste atë bisedë. Apo s'dinte ç'të thoshte, më tej? Tha ato pesë fjalë që kishte dëgjuar — e kaq? Po kjo:

«se si vdiq...»! Si vdiq? Si? Dreqi e di se ç'le-  
gjenda fillojnë e thuren tani. Natyrisht zbrazësi-  
ra do të mbushet me diçka. Në fakt zbrazësira  
vetë është diçka. Ku mungojnë kujtimet e freskë-  
ta, ajo do të mbushet me trill. Po kjo «se si vdiq  
...». Unë e di vetë se si vdiq ajo. Atë ditë të pri-  
llit '944 s'do ta harroj kurrë. Asnjëherë. Ajo është  
nga ato ditë që, edhe sikur të duash, nuk e ha-  
rro dot. Unë e di se si vdiq ajo. Asaj dite, në  
atë qytet të vogël, tërë urrejtja e SS-ve ishte  
përqëndruar aty, tek ajo grua rënë përmbys mbi  
pellg të shiut e të gjakut të vet. Atëhere këtë e  
ndjente kushdo. Tërë urrejtja e asaj dite të ftohtë  
ishte përqëndruar aty. Dhe unë doja të dija tani  
ku ishin rrënjët e asaj urrejtje, ku përhapeshin  
pejzat e jetës së asaj gruaje.

Më në fund, thashë me vete: «Ja, ai që më  
duhej». Pensionisti trupmadh, babaxhan fliste pa-  
pushuar para meje. Qysh në bisedën e parë e kup-  
tova që ai ishte nga ata njerëz, që veten e gjejnë  
te të tjerët. Ata nuk mund të përcaktojnë dot se  
ku mbaron vetja e tyre e ku fillon ajo e të tjerë-  
ve. Unë doja të dija gjithshka mbi Q.D-en, ndër-  
sa ai kishte nevojë të tregonte për të. Vetëm, për  
të. Ato që dinte. Më në fund, thashë unë me vete:  
«Ja ai që më duhej...»

Kur treni i mesnatës kaloi kufirin franko-ita-  
lian, gruaja e re pa karshi një fytyrë të panjohur.  
Ajo i nguli sytë burrit të porsaardhur. Ai kishte



një kokë të rrumbullakët, flokë të rënë sipër mbi ballin e gjerë dhe sy indiferentë e gati të përgjumur. Duke parë ata dy sy, gruas ju duk sikur udhëtari karshi po flinte. Ai njeri nuk ishte parë gjatë gjithë udhëtimit, e Q.D. nuk po kuptonte se në cilin stacion kishte hipur. Ajo po shikonte udhëtarin, kur pa që edhe sytë e tij po e vërenin atë me kureshtje. Disa kohë ata ashtu e panë njëri-tjetrin. «A thua?» — murmuriti gruaja e re me vete. «A thua?» — e vazhdoi të shihte udhëtarin kundrejt. Shikimi i tij ishte po ai: indiferent e gati i përgjumur. Dhe i ftohtë. Q.D. ktheu sytë nga dritarja e trenit. Jashtë nuk dukej asgjë veç shtresës së trashë të natës. Në sfond të saj gruaja pa fytyrën e vet. «A thua?» — mendoi përsëri. Afroi shikimin te xhamat dhe ndjeu figurën e stërzmadhuar nga jashtë të afrohej pranë saj. Atëhere gruaja hodhi dorën e vogël mbi supet e xhaketës. I shtypi me maja të gishtërinjve. Gjithshka në rregull. Në vend të pambukut e të sargjive, ato supe ishin mbushur me dokumenta e gazeta prej letre të hollë, që silleshin prej France në Shqipëri. Për një kohë të gjatë ajo mbajti dorën mbi supet e saj. Njeriu karshi vazhdonte ta shikonte me ata sytë e tij indiferentë e gati të përgjumur. Udhëtarët e tjerë thujse i kishte kotur gjumi i atij udhëtimit të gjatë. Q.D. mendoi për një çast ta ndërronte kabinën. Dhe të hetonte pastaj se si do të vepronte i panjohuri. Po ndërroi mendim. «Jo — tha — më mirë këtu». Nxori prej çante një gazetë e nisi të lexonte.

«Mësojmë nga «Dielli» i Amerikës që rroga e princërve arnautë u caktua nga 100.000 fr. ar, dome-

thënë 400 e ca napolona për muaj, domethënë afro 14 napolona për ditë. Nga sa dimë arnautllëku ka pesë princesha, të motrat e sulltanit, një princ plak, të vëllanë e Sulltanit, tre princër të rinj, të nipërit e Sulltanit dhe një valide-sulltane, gjithsejt 10 vetë, nga 100.000 një milion fr. ar në mot, dhe gjysmë milion, që merr sulltani vetë na bëjnë një milion e gjysmë fr. ar në mot rrogë vetëm për oxhakun e bejlerëve të Matit. Në këto duhen shtuar edhe rrogat e larove rreth konakut, që i çmuan, me vogëlsirat e tjera, në një numër afro 3 milion fr. ar. Kjo shumë përfaqëson të paktën një të gjashtëtën e të ardhurave të Shqipërisë. Po a ka gjëkund në botë një sulltan, turk a kaurr, që prish për oxhakun e tij një të gjashtëtën e të ardhurave të devletit? Dhe këto janë ato, që merr zyrtarisht. Milionat, që vjedh nën rrogoz nuk i vumë në hesap. . . »

Q.D. ngriti kryet nga gazeta. Sytë gjysmë të hapët të njeriut karshi binin mbi të. Gruaja prapë e vështroi atë gjatë.

Tani vetëm ajo grua mund të hynte në Shqipëri. Në atë terror që kishte vendosur qeveria e Zogut, vetëm ajo grua mund të vendoste lidhjen midis organizatës së çlirimit kombëtar e njerëzve të ndryshëm antizogistë brenda vendit. Dhe të hetonte gjendjen e popullit. Në Paris, njerëzit e organizatës duhej të dinin gjithshka. Q.D. shikonte të panjohurin e përpiquej të përcaktonte moshën e tij. S'mund të kishte më tepër se 37 vjeç. Me një hundë të rrumbullakët në fytyrën e freskët e të qëruar. Gruaja po e vërente ashtu, kur i panjohuri pyeti:

— Ju për në Romë?

Ai pyeti frëngjisht. Dhe ajo ju përgjegj:

— Po, për Romë.

— Atëhere ne do të udhëtojmë bashkë — tha ai dhe, duke vënë buzën në gaz, lëvizi pak në vendin e vet.

Q.D. nuk u përgjegj. Aksenti francez i të njohurit ishte i pastër. Po a ishte me të vërtetë francez? Gjatë udhëtimit ajo kishte vënë re se udhëtari ishte i heshtur. Duke e parë ashtu, kishte menduar se aq i heshtur dhe i përmbajtur, në shoqëri me një grua, vetëm një shqiptar mund të ishte. Q.D. nisi përsëri të lëçitte.

«Lordët e Londrës tani për tani s'duan që çamarroku këmishëzi i Romës t'u shpifë ndonjë sherr të ri në mes të ballkanasve. Duan qetësi e stabilitet për të pregatitur dasmën e madhe. Këtë duan lordët e Londrës sot. Dhe atë që duan lordët e do edhe Sulltani ynë, me hir e me pahir.

Dhëlpëra e Matit ka marrë erë se ç'duan xhentëlmënët e Downingstreet-it dhe nisi të lozë bish-tin. Nesër po të japë urdhër Sefiri ingliz, dhëlpëra i ngul «duçes» dhëmbët në dorë e lëshohet për një aventurë të re.

Mbi kurrizin e kërrusur të popullit shqiptar Esad Pasha II rend pas aventurave. Popullit çdo aventurë e Sulltanit i kushton gjak. Po Sulltani është kaluar...».

«Kush e ka tani shtetin në dorë? — Zogu — thonë disa. — Jo Zogu, po klasa e bejlerëve, themi në. Zogu është vetëm qehajai fuqiptotë i klasës së tij për të qeverisur çiflikun e madh të bejlerëve, Shqipërinë. Është monarku absolut dhe i

papërgjegjshëm, Sulltani çapaçul i Turqisë së vogël, që u ngjall mbi gërmadhat e baba dovletit».

I panjohuri qëndronte krejt indiferent ndaj asaj gazete. Ai s'e dinte Shqipërinë? Q.D. përsëri e la gazetën po, sapo ajo ngriti kryet, burri karshi e pyeti:

— Do të rrini shumë në Romë?

Gruaja u shtir sikur s'e dëgjoi fare atë pyetje. As i panjohuri s'e përsëriti më. Ai qëndroi përsëri indiferent e gati i përgjumur. Treni fluturonte nëpër hapësirë të tokës italiane. Trokashka e tij kalamëndte udhëtarët, lodhjen e mendimet e tyre. Q.D. u ngrit e shkoi në platformë. Ndofta i panjohuri do ta ndiqte pas. U afrua te xhami i dritares. Treni fluturonte si një klithmë e hekurt, e përbindshme. Gruaja kujtoi përsëri të panjohurin. Kur kishte hipur ai në tren? Dhe si, papritur ishte gjendur pastaj në kabinën e saj? Në Paris i kishin thënë: «Kujdes, langonjtë e Zogut mund të të ndjekin kudo. Ata, i kishin thënë, gjurmojnë çdo hap tonin... Dhe informojnë...» Ju bë sikur dikush po i avitej pranë. Q.D. u kthye andej. Kurrkush. Ajo ishte e vetme në atë platformë të gjerë. U largua. Duke ecur ngadalë midis udhëtarëve, ajo shkoi në vendin e vet. I panjohuri ishte aty. Ai s'foli asgjë, kur gruaja u kthye dhe mori sërish gazetën në dorë. Duke u shtirur sikur lexonte, ajo tha shqip:

— Ju shqiptar jeni?

Asnjë përgjegje.

Çfarë njeriu qenka ky, pensionisti me trup të madh, me faqe të fryra e buzë të trasha. Edhe

zëri i tij ashtu tingëlloka i trashë e i rrjedhshëm. Çfarë njeriu qenka ky! E shoh, e dëgjoj dhe më kujtohet se si njëherë më patën thënë: «Për Q.D-en? Mbi jetën e saj do të dish? Pyet X-Y-in Ai e ka pasur shoqe». Një mbrëmje ngrita recepto- rin e telefonit e sajova numrin. Prej andej arriti gjer tek unë një zë burri:

— Urdhëroni — tha.

— Ju jeni?

— Po — u përgjegj shkurt.

— Do të dëshiroja t'ju takoja pak — i thashë unë. — Do t'ju shqetësoja. Më kanë thënë se ju e keni njohur Q.D-en. Do t'ju lutesha të më ndihmonit... — Unë vazhdoja të flisja, kurse ai tjetri andej heshti. Dhe vetëm më në fund u dëgjua të thoshte:

— Po... unë... unë e kam njohur... as që më kujtohet... Ah, vetëm një herë — tha pastaj — vetëm një herë e kam takuar...

— S'ka gjë — i thashë unë. — Do t'ju lutesha shumë. Po nga ajo ftohje e menjëhershme e zërit të tij, nga ajo shkëputje zvarritëse e fjalëve që thoshte e kuptova: ai nuk donte të fliste për të... Kurse ky pensionisti... çfarë njeriu i çuditshëm qenkësh. Flet e flet. Dhe vetëm për të. Kujtimet e tij sikur janë shkrepëtima dritash, që përplasen e zbërthejnë njëra-tjetrën.

«Posi — më thotë ai — ne bënim jetën e cëlulës së Partisë Komuniste franceze... Oh, më kujtohet... edhe ajo... Q.D... edhe ajo ishte atje...» — Dhe njeriu me trup të madh qesh. Duke qeshur ashtu, fytyra e tij ngrohet, si një top brumi i rrahur mirë. Dhe pas një çike ai fillon prapë: «Ato

ishin vite të tëra... po, më kujtohen... si s'më kujtohen? Kush i harron dot demonstratat kundër gjyqit të Dimitrovit?... gjëmonte Parisi... Ne, megjithëse ishim emigrantë e mund të na nxirrnin jashtë Francës... me punëtorët francezë, me emigrantët revolucionarë të vendeve të ndryshme, ne shpërthenim... Oh, po ku përmbahesha dot... Ajo... Të ishte ajo...» — Ai fliste e qeshte.

Si janë njerëzit. Sa të ndryshëm! Dhe sa të ndërlikuar herë-herë! Unë shkova dhe e takova atë burrin me zë të ftohtë, nëpër të cilin të shkëputura e zvaritëse mezi arrinin gjer tek unë, fjalët e tij. Sa më pa, ai pëshpëriti: «Po unë s'e kam njo-hur mirë... Kot ju kanë drejtuar tek unë...» — Ai s'donte të fliste. Ndërsa pensionisti para meje, shih si i puliti sytë e mëdhenj e s'pushonte së foluri. Mua më kujtohet ai tjetri. Dhe s'di përse të dy më shembëlajnë me ditën. Për këtë Q.D.-ja është si ai dielli midis shtresave të reve. Dielli ngroh, e tisi i tyre davaritet ngadalë. Gjithshka kthjellohet. Dhe fytyra e tij qesh. Ndërsa për atë tjetrin ai diell është i largët dhe i ftohtë. Çfarë gllomçke e ndërlikuar që janë njerëzit! Pse, xhanëm, ai të ishte aq i ftohtë ndaj kujtimit të saj, ndërsa pensionisti, duke folur me mua, unë e kuptoj, e ndjej, ky e sheh Q.D. të gjallë. Sigurisht që në kujtesën e tij ajo ngrihet, ashtu siç ka qenë dikur. Kujtimi i tij baret nga njëri vend në tjetrin. Shpeshherë tregimet e tij s'lidhen, herë të tjera përsëriten, por ai nuk kujtohet. Nuk kujtohet që po atë ndodhi ma ka treguar edhe një herë tjetër. Të njëjtën gjë. E tani e përsërit. «Ne ishim të dy në Ndërmarrjen Renault... bëhej grevë. Punëtorët nuk

lejonin që të hapej ndërmarrja. Kishin zënë derën dhe s'leviznin. Disa ditë me radhë. Shokët francezë më thirrën e më dhanë një letër... — Çoje — më thanë. — Tek ti nuk dyshojnë... — Po policët më zunë. Kur më liruan, u takova përsëri me Q.D.-en...».

Si e sheh ai tani atë grua? Si ngrihet ajo midis kujtesës së tij? Unë s'mund ta përngjall ndryshe, veçse me atë fytyrë të rrumbullakët, me ata sy të shndritëshëm, si në fotografi. Po ky? si e sheh ky?

— Në këtë çast si e sheh atë? — pyes unë.

Sytë e mëdhenj gjysmë të pulitur hapen e bien mbi mua.

— Cfarë? Nuk ju kuptoj — thotë ai i habitur. Për herë të parë supet e tij ngrihen ngadalë përpjetë. Me të vërtetë ai nuk më kupton... Gjatë gjithë bisedës sonë, ndofta kjo pyetje ishte më abstrakte për të.

Sapo ngjiti shkallët e vaborit, Q.D. e ndjeu përnjëherësh se andej fillonte Shqipëria. Vaporit ishte italian, por Shqipëria fillonte aty. Dhe ftohësia e terrorit të Zogut sikur e përshkoi dhe u përhap nëpër trupin e saj. Ajo kaloi midis një grumbulli udhëtarësh dhe shkoi e mori çelësin e kabinës së vet. Njeriu i panjohur, që e kishte shoqëruar gjatë gjithë udhëtimit në tren, nuk dukej gjëkund. Me valixhen e vogël në dorë Q.D. përshkoi korridoret, zbriti shkallët e hyri në kabinë. Mbylli derën përbrenda. La valixhen mbi tavolinë dhe, ashtu siç ishte, u lëshua mbi shtrat. Më në fund ajo ishte e vetme. Fare e vetme. Kishin mbe-

tur pas kaq ditë udhëtimi, Franca, Parisi. As burri i panjohur nuk dukej më. Tani ajo ishte vetëm. Me atë ndjenjën e ftohtë, që e pushtoi përnjëherësh. Andej fillonte Shqipëria. Preku me gishtërinj letrën e hollë të gazetave ilegale. Vapor i lëkund. Gruaja u ngrit e shkoi te dritarja e kabines. Shikimin e saj e mbushën varkat e maunet. Ato heporeshin mbi valët e lehta të detit. Dielli po perëndonte. Mbi hapësirën e kaltër binin rrezet e fundit të tij. Q.D. qëndroi aty e heshtur dhe e menduar, gjersa këmbët filluan t'i mpiheshin. U kthye e ra sërish mbi shtrat. Për një hop e mori gjumi

U zgjua nga një gumëzhimë e rëndë motorësh. Tavani e dyshemeja lëkundeshin. Brenda në kabinë asaj po i merreshin mendtë. U ngrit. U la, u kreh e doli prej kabine. Kishte rënë nata. Q.D. ngjiti shkallët dhe hipi në kuvertë. Hapësira e detit shtrihej aty para saj. E vetme, gruaja e re u mbështet te parvazi. Diçka e thërriste. Diçka e ndillte. Ishte edhe ai deti i atdheut. Ujërat e tij lagnin edhe brigjet e tokës në të cilën kishte lindur e ishte rritur ajo. Kishin kaluar kaq vjet. Të tjera vende. Të tjerë qytete. Dhe njerëz të tjerë. — Vapor i nis. Mbështetur në parvaz gruaja shihte ujërat fosforeshentë, që ndizeshin dhe, duke u përhapur anësh, zhdukeshin tutje. Kaq vjet që ishte larguar nga vendlindja. Në vise të tjera edhe ajo sikur kishte lëshuar rrënjët e jetës së saj. Dhe përsëri ndjeu në trup atë ftohtësi, që e përshkoi sapo kishte hipur në vapor. Sikur shtresa ngrice po i shtrihejshin në mish. Kishte të ftohët. Filloi të dridhej. Drejt saj frynte era e Shqipërisë.



Dikush e preku në trup.

— Zonjë, mos u kacavirni ashtu, është e rrezikshme.

Marinari italian qëndronte para saj.

— Ju shqiptare jeni?

— Po.

— Dhe vetëm? — tha italiani duke qeshur.

— Vetëm.

— Prej Rome vini?

— Jo, prej Parisi.

— Uuh! — italiani lëshoi një fishkëllimë habie. — Më falni — tha dhe u largua.

Ishte në të gdhirë, kur vapori po hynte midis grykës së Sazanit e të Karaburunit. Q.D. kishte fjetur ato orë të natës. Tani po ngjitej prapë mbi kuvertë. Një grup udhëtarësh kishin dalë atje që më parë. Të tjerë vazhdonin të vinin. E fundit firmë e natës po shkrihej nëpër kaltërsinë mjegullore të maleve shkëmbore. Vapori gjithnjë e më tepër u afrohej atyre. Udhëtarët bisedonin me zë, kur mbi maja midis mjegullash agoi dielli. Pastaj një horizont i thellë u shfaq para syve. Udhëtarët filluan të flisnin me zë të lartë. I prisnin fjalën njëri-tjetrit. Q.D. qëndronte e vetme. Dhe dëgjonte. Ajo pamje kishte një bardhësi magjepse, po të ftohtë. Ishin malet, ku ajo kishte lindur dhe ishte rritur. «Foleza» e saj, si i thonë. Udhëtarët, shumica tregëtarë, flisnin me zë të lartë. «Ç'male të bukura... dhe të heshtura... dhe krenare...!» Entuziazmi ishte i potershëm. I përgjithshëm. Q.D. nuk fliste. Dëgjonte. Dhe heshte. Ja malet e saj. Si dukeshin ato në një agim të tillë. Nga larg...

ajo ishte rritur midis tyre e megjithatë ajo bardhësi krenare e majave të mbushura edhe tani me dëborë, ai entuziazëm shpërthyes i udhëtarëve, ishte i largët e i ftohtë për të.

Ajo nxori prej çante gazetën e nisi të lexonte. «Paskan ndodhë një ditë në parlament një grup i deputetëve të Elbasanit, tue bisedue me Z.M.K. Në bisedim e sipër dikush, tue ja ndie zemra se nuk kishte me qenë ma në listën e qeverisë, thotë: «të shohim se cili nga neve nuk ka me u ulë ma mbi këto karrige». Z.M.K. menjëherë i thotë: «mos t'ju zajë halli fare, sepse po neve do të jemi që do t'i gëzojmë këto karrige, mbasi qeveria nuk ka ku gjen vagabonda ma të mbarue se na». Fjalëve të Z.M.K. nuk pat guxim t'u kundërshton-te asnjëri prej deputetëve...»

Q.D. qeshi. Ajo pa valët e detit që çaheshin prej anijes, u përkul mbi parvaz dhe lëshoi poshtë gazetën. Anija po i afrohej bregut shqiptar. Gruaja shikonte se si ajo gazetë e vogël, duke plluskuar mbi ujëra, largohej gjithnjë e më shumë prej saj dhe me të gjithshka mbetej pas.

Në port filloi kontrolli i udhëtarëve. Ata hynin në godinat e doganës, ku një nëpunës dhe një rreshter kontrollonin gjithshka. Gratë personalisht i kontrollonte një grua e trashë me leshra e fytyrë të zezë.

— Eja pas meje — i tha ajo Q.D.

Ato u futën në një dhomë të vogël.

Nëpunësja e doganës filloi ta kontrollonte.

— Pse? — e pyeti Q.D.

— Rregulli.

— I bukur rregull.

— Nga vjen? — i tha gruaja e trashë.

— Nga Franca.

— Mirë paske jetuar andej...

Dhe ajo vazhdoi ta kontrollonte në gji, në bark, kudo.

— Qenke grua e bukur — i tha më në fund.

Q.D. s'u përgjegj. Ato dolën prej andej.

— S'ka asgjë — i tha nëpunësja e doganës reshterit, që po kontrollonte valixhen. Ky i hodhi Q.D-es një shikim që nga koka e gjer te këmbët. Pastaj vazhdoi të kontrollonte valixhen.

— E doni ju mbretin? — pyeti duke ngatërruar duart e veta nëpër të linjtat e gruas.

Kjo s'u përgjegj.

— Me politikë... merreni me politikë?

— Unë jam grua — tha ajo.

Një mendim kapriçioz më erdhi në kokë: vallë ku të ishte tani ai rreshteri, që me gishtërinjtë e tij prekte e zhubraviste këmishëzën e hollë të trupit të asaj gruaje të re, që me atë tufë trëndafilash të bardhë ndër duar, me ata sy të gëzuar, më shihte nga fotografia e vogël? Ku të ishte tani ai? M'u kujtuan fjalët e burrit të saj të mëparshëm: «Ti kërko e pyet... se ne jemi si ajo dhia, që fsheh qumështin e vet...». Në fillim ato fjalë i shënova thujse pa dëshirë në fletoren time. S'më bënë ndonjë përshtypje të veçantë. Por me kalimin e kohës, e kuptova: në ato fjalë ai njeri kishte futur vetëveten. Ai e fshihte qumështin, sapo të tjerët çiknin në kujtimin e asaj gruaje. Kurse rreshteri...

— S'ke ç'i bën, jeta i ka këto... — tha para meje pensionisti trupmadh me atë qëndrimin e vet prej babaxhani...

— Ama ç'filozofi! Jeta i ka këto... — murrurita unë...

Pensionisti nisi përsëri të fliste për Q.D-en. Ajo tani ishte e vdekur. Nuk ekzistonte më. Edhe njeriu që fliste para meje e dinte këtë. Ajo nuk ishte më. Por ai s'ishte ndarë prej saj. Ai s'donte të ndahej prej saj. M'u kujtua një grusht dhé, që hedhim mbi të vdekurin kur e varrosim. Të gjithë ne e bëjmë. Vetëm një grusht dhé. Një gjest i vogël. Po pikërisht atëhere, sikur gjithshka mbyllet. Mbaron. Ndahemi e çlodhemi. Kurse ky jo. Ky nuk e ka hedhur atë grusht dhé mbi varrin e saj. As mbi kujtimin e saj. Dhe, me sa duket, nuk do ta hedhë kurrë.

## VI

Ajo ishte një hije e shkurtër, e cunguar, hije e një njeriu gungaç me një palë këmbë të holla, pak të gjata për atë trup të gjysmuar të tij. Këtë hije unë e takoja kudo. Herë-herë ngatërroja gjurmët e tij me gjurmët e Q.D-es. Gjë e pabesueshme: sapo njerëzit nisnin të tregonin për atë, qeshnin. Edhe tani, kur ai kishte vdekur e nuk ishte më. Kujtimi i tij nuk i trishtonte. Tek bisedonin ashtu, përnjëherësh e kuptoje se ata ishin të gëzuar, që dikur ai kishte jetuar midis tyre. Me

atë fytyrën e tij të shëmtuar, me ato këmbë të hoilla e të lëvizshme, ai kalonte gjithnjë pranë asaj gruaje. Dhe s'i ndahej. Nuk i ishte ndarë as në vdekje. Ishin pushkatuar së bashku në atë ditë prilli 1944.

Ata kishin qenë kunetër.

Kaloja nëpër udhën e ngushtë të fshatit. Kjo ishte toka e saj. Malore. E ashpër. Binte shi e, duke zbritur qafën e malit, mjegulla arrinte gjer mbi strehë të shtëpive të vogla. Bota është e madhe, pa kufi e madhe. Po në fund të fundit, çdo njeri gjallon e vërtitet brenda një pëllëmbë toke; ka, në fund të fundit, një ngastër dheu, ku mbi-llemi, rritemi e pastaj tretemi. Shiu nuk kishte ndër mend të pushonte. Fshatarët që, si zakonisht, kishin dalë herët nëpër ara, po linin punën e me kazma e lopata në krahë ktheheshin shtëpive. «Në mëngjez ishte ndryshe» — tha njëri, që u afrua tek unë. «Mendua se do të mbante...». Unë isha nisur të vizitoja shtëpinë e tyre. Shikoja malet e ashpra e megjithatë ndjeja diçka të ngrohtë e të butë në veten time.

— Po këtu — i thashë unë fshatarit. — nuk qenka edhe aq ftohët.

— Jooo... — fytyra e tij u përthye e tëra, tek më shikoi me habi. Ishte burrë i gjatë, me një fytyrë korozezë gjithë rrudha në ballin e ngushtë e të mbledhur. Mbante akoma në kokë qylahun e labit. Tek më shihte ashtu, ajo fytyrë sikur donte të më thoshte: Ç' thua kështu, tokën nuk e kemi të keqe... Po ai tha: «Tek ne rriten edhe fiqtë...»

— Fiqtë? — pyeta unë i habitur. Kërkova të shihja malet përçark, po mjegulla s'më linte.

— Po... kjo është luginë e ngrohtë... Hajde me mua... — Ai u kthye më të djathtë e zbriti poshtë udhës. E ndoqa pas. Me çapet e tij të gjata, me shatin në krahë, fshatari kaloi hendekun e nisi të fliste duke shikuar gjithnjë përpara.

— Tokën nuk e kemi të keqe... dhe njerëzit tanë punojnë...

— Tani — i thashë unë duke qeshur. — Tani... më parë ju lebërit s'para e keni pasur qejf bishtin e shatit.

— Jo, a derëzi! — Fshatari u kthye nga unë. Dhe përsëri fytyra e tij mori atë pamje habie. — Jo, a derëzi... — tha. — Po ku na linin? Kishim vetëm dy bisht cangadhe... me to gjithë jetën... asgjë tjetër s'kishim...

Duke zbritur ashtu, u gjendëm në mes të një bregoreje. Nën këmbët tona gjelbëronte gruri. Fshatari qëndroi aty e priti sa t'i afrohesha pranë. Uli shatin në tokë dhe u mbështet mbi të.

— Ja, atje — tha — kemi një bahçe të tërë me fiq...

— Këtu qenka ngrohtë — thashë unë i habitur.

— Posi...

Gëzohej apo krenohej ai njeri para meje? E dija që nuk më çoi atje për t'u mburrur. Jo, po ashtu siç e kanë zakon fshatarët tanë, donte të më tregonte katundin e vet. Dhe u habit, kur mësoi që unë nuk e dija se atje, në luginë, klima ishte e butë.

— E sheh atë faqe mali atje?

— Po.

— Do ta mbjellim të gjithë me bajame.

— E bën?

— E bën që ç'ke me të...

U kthyem nga kishim ardhur. Hipëm në udhë e nisëm përsëri të shkonim drejt shtëpisë së dikurshme të Q.D-es. Dhe të atij gungaçi. Mendime nga më të ndryshmet më plekseshin në kokë. Dhe nëpër to rrëshqiste hija e atij njeriu të gjymtuar. Për të më flisnin më shumë. Bisedat dhe tregimet e tyre nuk mund t'i shkrije dot në një të tërë. Ato mbeteshin prapë të shkëputura. Ai ishte nga ata njerëz, jetën e të cilëve mund ta rindërtosh e ta ngrehësh vetëm nëpërmjet copëzave. Të pabarabarta. Jo harmonike. Jeta e tij shembëllente me vetë trupin e tij. Çdo gjymtyrë mund të qëndronte më vete, e shkëputur. Dhe prapa mund të bashkohej me pjesët e tjera e të formonin atë njeri, të cunguar. Po ai, vetëm ai, nëpërmjet copëzave...

...Një herë ishin mbledhur pleqtë e fshatit në lëmë. Pinin duhan e molloiseshin për politikën e madhe të qeverisë. Kur ka halle i madhi, ato i heq edhe i vogli. Edhe në qoftë se s'do, hija e të madhit bie vetiu edhe mbi të voglin. Fshatarët mendonin për fatet e qeverisë. Do të zgjidheshin deputetë në parlament. Po ç'të ishin vallë ata? Më plaku ju drejtua kurrizos:

— Ti je i bredhur — i tha — ç'janë ata, deputetët?

— Deputetët?

— Po.

— Për këtë po lodhi kaq?

— Po, bir.

Kurrizoja u mendua një copë herë.

— Me bythët, xha, — tha pastaj.

— Ëh... me bythët qenkan?

— Po — tha kurrizoja. — S'mund të jenë të tjerë.

— Po senatorët?

— Senatorët? — Kurrizoja nuk dinte si quheshin ata turqisht. Si t'ja shpjegonte?

— Po ja... — i tha ai plakut... — Si të thuash, senatorët janë dy gisht mbi mebythët.

Plaku mbeti i kënaqur.

...E thirrën gungon krushk në dasmë. Së bashku me dasmorë të tjerë i hipi edhe ai mushkës e shkoi në fshatin e vajzës. Të zotët e shtëpisë i pritën miqtë e me fjalë të ëmbla i vunë, sipas sërës, në krye të vendit. Gungon e harruan. Mbeti në fund të dhomës. Eh, po një shëmtirë e parëndësishme në atë dasmë. Nisi festa. Nisën dollitë e shëndetet. Për këtë e në trashëgim. Për atë e ua paçim hua. Dhe këngë. Këngë të vjetra e të reja. Gungua rrinte atje te fundi i dhomës. Mendohej. Kurrkush s'po e përfillte. Atëhere ai ja mori këngës. «Dhe kishte një zë bilbili» — thoshnin fshatarët e qeshnin. «Zëri i bilbilit, me një trup e fytyrë të tillë!» — mendoja unë. Krisi kënga e gungos.

*«Këta miq që janë sot,  
Qoftë haram dhe miqësia,  
Po ç'të bëjmë, i madhi zot,  
Pa ta s'shkon poshtë as rakia».*

Të zotët e shtëpisë u hodhën përpjetë.

— Bah, si e paskeni lënë kështu... Ky qenka për kryekrushk e kryevend.



*«Selanik e Manastirë,  
O Bezhan përmbi Janinë...»*

Kënga burrishte, e shtruar, mbushte dhomën. Unë isha mik. Dhe miku duhet gëzuar. Miku në shtëpi vetë është një gëzim. «Miku? — më pyeti mua kryetari i kooperativës, duke më lëshuar përpara në pjatë bishtin e qengjit, — miku është shoku i derrit».

— Oh — thirri i zoti i shtëpisë, që qëndronte në këmbë dhe u shërbente të ftuarve. — Dale pak...

— Ashtu është — tha kryetari i kooperativës. — Miku hyn në shtëpitë tona e bën si do vetë...

— Le të bëjë — tha i zoti i shtëpisë duke qeshur.

*«O Bezhan përmbi Janinë,  
treqind topa një të shtirë...»*

Te dera u duk fshatari trupgjatë, me atë fytyrën e tij të mbledhur korozezë, që mbante në kokë gylahun e bardhë të labit.

— Unë e takova këtë shokun në udhë — tha ai. — Prandaj dhe erdha i paftuar sonte.

— Mirë se të vish!

Unë u ngrita nga vendi.

— Urdhëroni...

— Të lutem — tha fshatari.

— Jo — i thashë unë — ti duhet të ulesh aty.

— Në asnjë mënyrë... ti je miku...

— Ulu aty — i tha atij kryetari i kooperativës, me një ton ngacmues.

*«Treqind topa një të shtirë,  
vijne gjylet me zinçhirë...»*

Atë këngë unë e kisha dëgjuar për herë të parë kur isha fare fëmijë. Në një lagje të qytetit tonë dikush martohej. Atëhere dasmat zgjatnin një javë të tërë. Gjatë gjithë javës në shtëpitë e dasmorëve ziente kënga e vallja dhe fjala përhapej në gjithë qytetin. Mbrëmje për mbrëmje ne shkonim tek ajo shtëpi. Hipnim mbi mure e shihnim brenda në oborr. Të largët, të largët, mua më kujtohen edhe tani ata burra të zënë dorë për dore, që goditnin tokën me këmbë e këndonin:

*«Treqind topa një të shtirë,  
vijne gjylet me zinçhirë...»*

Tani po atë këngë këta fshatarë e këndojnë të ulur e të qetë. Dhe vetë melodia e saj më e plotë dhe më e mbushur kumbon në dhomë.

— Ne i pamë brezaret e grurit — i thashë unë kryetarit të kooperativës.

— Ah! — ai më shikoi në sy i habitur.

— I pamë — tha fshatari i qetë, pa shikuar nga kryetari.

— Ti më paske zëvendësuar mua? — Kryetari fliste serioz, po zëri i tij qe ngacmues.

Unë qesha.

— Pse... Ti qysh mendon, që je i pazëvendësueshëm? — Fshatari u zgjat, mori nga pjata një thelë e filloi ta hante. Vetëm atë çast me ata sytë e zez, që nënqeshnin, ai shikoi nga kryetari.

— Jo — tha kryetari — unë s'jam i pazëvendësueshëm, po nuk dua që ti të më zëvendësosh në mishin tim... — Dhe me pirua në dorë ai tregoi thelën... — Eja të më zëvendësosh nesër — tha kryetari — se ti e di që do të përleshem...

— Me kë, me Alinë?

— Po.

— Jo... — tha fshatari duke e shikuar kryetarin gjithnjë me ata sytë e tij të zez. — Jo... — tha ai. — Atë ta kam lënë ty...

— Të falem nderit... Po eja ti dhe mbushja mendjen se duhet t'i çojmë edhe Asllanit dritën elektrike.

— T'ja çojmë... pse të mos ja çojmë? Unë nuk di pse nuk ja kemi çuar...

— As unë s'e di... — dhe kryetari i kooperativës mblodhi supet. — Eja ti t'ja mbushësh mendjen brigadierit...

— Atij? Jooo... — tha fshatari prapë. — Ta kam lënë ty...

*«Treqind topa një të shtirë,  
Vijnë gjylet me zinçhirë...»*

I zoti i shtëpisë ishte i shqetësuar. Ulej midis miqve, këndonte dhe në mes të këngës ngrihej prapë. Diçka porositte. Diçka kërkonte. Mendova t'i thosha: «s'qe e nevojshme e gjithë kjo», po e dija që ai s'do të më kuptonte. Ai nuk do të dëshironte të më kuptonte. Gjersa miku hyn në shtëpitë tonë...

— Do t'i mbillni bajamet? — pyeta unë nergut fshatarin.

— Ky e di... — dhe ai tregoi me kokë kryetarin e kooperativës.

— Bajamet? .. E pe atë rrafsh mali? Do ta mbjellin të gjithë...

— Ne duhej të kishim filluar — tha serioz kë-saj radhe fshatari pranë meje.

— Do të mbjellim edhe arra e gështenja... Do t'i pyllëzojmë këto male që kemi mbi fshat...

— Aty na ke — tha fshatari...

Gjithshka kishte mbaruar: edhe shqetësimet tona pa fund, kur të vjen miku, edhe qengji i therur e i pjekur aty për aty, edhe bisedat e gjata të pasdarakës. I vetëm unë rashë të flija në dhomën e heshtur.

Ja shtëpia e saj. Asgjë e jashtëzakonshme. Si çdo shtëpi tjetër e këtij fshati. E gurtë, njëkatëshe, e rrethuar me mure jashtë. Asgjë e jashtëzakonshme. Dhe as ndonjë ndjenjë e veçantë tek unë. Në fund të fundit, ç'gjë të jashtëzakonshme na paskësh se dikur këtu paskësh jetuar një njeri? Qoftë edhe ajo vetë. Njerëzit do të jetojnë diku. Ajo jetoj këtu. Buzëqesha me vete, duke menduar se dikush do të kishte kërkuar të gjente tani në errësirën e natës hijen e pranisë së saj, ndofta tani do t'i dëgjonte vetë zërin, apo hapat e lehtë. Dikur ata hapa kanë fëshfëritur këtu... Tani jo. Tani dhoma, mbasi ikën të zotët e tanishëm të shtëpisë, është e heshtur. Asgjë e jashtëzakonshme. Pas darrakës njerëzit e shtëpisë biseduan gjerë e gjatë. Po, në ato që ata thanë nuk kishte asgjë të re e të

panjohur për mua. Vetëm një grua me dy sy të zez, të përrulur, tha:

— Kur ajo u martua, ishte e vogël dhe me të kunatin luante cingla, këtu, pas oborrit... Ata ishin të dy si vëlla e motër.

Prapë hija e atyre të dyve. Ajo grua më kish-te dhënë ashtu zanafillën e atyre dy jetëve, të atyre dy hijeve; 13 vjeç ata luanin njëri me tjetrin dhe ashtu pastaj kaluan nëpër gjithë jetën e tyre, gjer në vdekje. Unë e kam keq — nuk pi cigare. Ndërsa në qetësinë e thellë të asaj nate, në atë dhomë një cigare do të ishte shoqëruesja më e mirë për mua. Kushedi ku mund ta degdiste mendimin tim të lodhur, një cigare. Ç'metamorfoza! Q.D. e pushkatuar në atë ditë prilli 1944, pastaj me atë tufë trëndafilash të bardhë në duar; pastaj nuse e vogël duke luajtur cingla pas murit të oborrit. Kur u nisa në kërkim të saj, as që mund t'i kisha shpresuar këto. Një cigare. Përse kujtimi i tyre në buzët e asaj nate më dukej i domosdoshëm, çlodhës, si një cigare pas një lodhjeje kapitëse? Kurse dhoma ishte po ajo. Po ato mure guri të bardha, po ajo derë, po ai tavan dhe po ajo dritare e ulët, ku herë pas here ishte mbështetur Q.D. Pastaj? Asgjë. Asgjë? Në atë dhomë nuk kishte banuar kushdo, ata gurë kishin dëgjuar vetëm zërin e asaj, — më kupton? vetëm të asaj. Jo çdo tjetër zë... po vetëm atë... Unë e pyeta berberin. Ai s'mu përgjeggj fare. Më shikoi i habitur me atë shikimin e tij të butë. «Si mund të kërkosh gjëra të tilla tani? Ç'zë kish-te! Kush mund ta mbajë mend? Edhe ai plaku nuk e kujtonte dot. Ja, kështu si ky gur, si këto mure.

Edhe njerëzit shembëllejnë me ta. As ata s'mbajnë dot mend. Njerëzit. Gurët. Po, këtu ka qenë ajo. Ka shkelur mbi këto dërrasa dysHEMEJE, ka pirë ujë tek ajo çesma, që rrjedh aty përjashta në oborr. Njerëzit — gurët. Po njerëzit janë të ndryshëm. Ka të tillë, fytyra e të cilëve të rri përherë përpara. E njëjta. E pandryshuar. Ti e sheh dhe s'kupton asgjë. Mendon: «si është bërë kjo fytyrë e tillë indiferente e pakuptim. Dhe këtë unë duhet ta shoh çdo ditë, çdo orë, çdo çast të jetës sime; këtë fytyrë pa jetë... (shih jeta ç'fytyrë pa jetë na paska?!); ka të tjerë, që kacaviren nëpër trupin tënd si ata kërmijtë dhe aty nëpër gjethe të ndërgjegjes sate lënë jargët e tyre; ka edhe nga ata, që ti ndofta nuk i ke parë asnjëherë, s'ke biseduar kurrë, se ndofta ata kanë rënë përmbys atje te xhamia e tabakëve, kanë rënë vite të shkuara, po ti e sheh, e ndjen edhe tani, që ata janë përmbysur duke lënë një boshllëk të madh te ti, kanë hapur një zbrazë-sirë, që edhe tani të prek me gishtërinjtë e gjatë e të ftohtë të kujtimit të vet. Dhe ti je i gëzuar, je i lumtur, që dikur ata kanë jetuar. Ka njerëz që heshtin, si gurët. Po ka edhe gurë që flasin, si njerëzit. Dhe këta gurë duhet të flasin. Askush nuk mund të më tregojë mua tani se ç'kanë biseduar midis tyre ata natën e parë, kur ajo u kthye nga Parisi. Vetëm këta gurë. Dhe ata duhet të flasin. Ata po flasin. Zëri i tyre vjen i turbullt, i pakuptueshëm, murmuritës, po gurët po flasin.

— Ç'bëjnë ata andej? — pyeti burri.

— Ç'të bëjnë? Përpiqen — tha gruaja.

— Përpiqen... — ai zgjati duart e tij të mëdha dhe theu me ato bukën e misrit, që kishte për-

para. — Maskarenj janë... të gjithë... — tha ai duke i përtypur fjalët e tij së bashku me kafshatat e misërta.

Gruaja nuk u përgjegj. Nën dritën e bishtut, që digjej mbi oxhak, ajo shihte se si, matanë qoshes së vatrës, binte hija e të kunatit. Q.D-es ju duk se s'ishte hije, po një lëmsh i zi, i ftohtë, i atij trupi të deformuar, që shkonte e binte aty mbi dysheme.

— Maskarenj janë... — tha përsëri burri. — Vajtën në Frëncë... dhe...

— Si? Si the? Frëncë?

— Frëncë... — tha burri duke e shikuar në sy. Shikimi i tij ishte i hidhur e i ftohtë.

Q.D. qeshi.

— Oj — i tha ajo — ti ke qenë vetë në Francë...

— Unë... unë jam tjetër... — tha ai me zërin e tij të akullt. — Ata na harruan...

— Jo — tha gruaja përnjëherësh. Drita e bishtukut nuk ngopte dot shikimin e saj. Në konak pothuajse ishte errët. Ajo shihte se si hija e atij burri përpëlitej saherë që shkrepnte kandili mbi oxhak.

— Jo... se mos ne këtu presim që ju të na thoni «po»...

— Ti paske ndryshuar fare — tha Q.D.

— Jo — u përgjegj ai — s'kam ndryshuar.

— Ke ndryshuar.

— Jo... ai që kam qenë jam...

— Ti s'ke qenë kurrë kështu... Unë të njoh ty, më mirë se veten time.

— Kështu kam qenë — tha burri dhe zgjati duart e mori nga vatra tasin me dhallë. E ngriti e filloi ta pinte.

— Nuk ke qenë kështu...

— Kështu kam qenë — tha ai e përsëri e shikoi gruan në sy, me atë shikimin e tij të hidhur e të ftohtë. — Po ti ke ndryshuar... ju keni ndryshuar... edhe im vëlla... edhe ti... edhe të tjerët... ju... Ne... ç'të ndryshojmë ne?! Frënca...

— Ç'ju qepe Francës — tha gruaja.

— Ëh, bulevarde... parqe... ballo.

— Uh! — Q.D. përplasi duart para fytyrës së saj të vogël. Midis buzëve i shkëlqeu i bardhë vërshëllimi i dhëmbëve. — Uh! — tha ajo dhe po qeshte. Shikonte të kunatin që me tasin me dhallë në dorë rrinte i heshtur. Hija e tij pa jetë binte e deformuar në dysHEME.

— Uh — thoshte ajo... — Franca... Ballo... Parqe... Bulevarde... Ti vetë më përcolle gjer në Paris... — Zëri i saj përnjëherësh u ftoh... — Unë jam një bufetjere e thjeshtë. Atje ku më le, punoj edhe tani... Midis punëtorëve, midis punëtoreve... Ti e di, ka Francë e Francë...

— E di... — Zëri i tij qe i ngadalshëm, i shtypur.

Gruaja u drodh. Kurrë s'e kishte dëgjuar atë zë. Ju duk sikur ai rridhte e bluhej midis mokrave të rënda të dëshpërimit të atij njeriu. Atë kunat ajo e kishte vëlla dhe e dinte që në atë trup të deformuar qëndronte një shpirt i bardhë. Ndërsa tani ai shpirt ishte zymtuar fare. Drita e bishtukut ishte shumë e paktë. Në fshat ajo përnjëherësh u mësua me gjithshka. Veshi çitjanet, si gratë e tjera, shkoi në arë, në mulli, shkoi për dru, po me atë dritë nuk u mësua e nuk u mësua dot. Q.D. u ngrit, mori bishtukun në duar e me karficën e flokëve nisi të ngrinte fitilin.

— E di... — thoshte burri aty nën të... —



Ç'faj kanë bulevardet e parqet e Francës... Po neve na e kanë vënë lakun keq. Njerëzit, ngaqë s'kanë ç'të hanë — hanë vetëm kallëza, si bagëtia. Punë s'ka. Bukë s'ka. Ka vetëm xhandarë. Dhe agallarë, sa të duash, agallarë...

— E pashë. Në këmbë, siç ishte, duke ngritur bishtukun, Q.D. pa hijen e të kunatit. Tani ajo ishte e vogël, e vogël.

— Zogu na e vuri lakun keq...

— Unë duhet të takoj Xh. S. — tha gruaja. — Kam disa letra për të.

— E takoj vetë — tha burri. Tani zëri i tij qe ai i zakonshmi, metalik e i prerë. Gruaja e re u ul para tij. Ajo e kuptoi: atij i kishte ikur inati.

— Duhet ta takoj vetë — tha ajo. — Kështu më kanë thënë...

— Ti nuk beson tek unë?

— Ai do të besojë më shumë, kur të më shohë vetë, e kupton?

— Mirë atëhere, të çoj unë. Nesër mbrëma natën, të hypi në mushkë e të çoj vetë. Do të udhëtojmë nja dy orë të mira...

Në qetësinë e natës, kur në dhomë nuk dëgjohej veçse currili i çesmës jashtë në oborr, mes atyre mendimeve, vetiu m'u kujtua një këngë: «Është kënga e kurrizos», më kishin thënë. E kishte thurur vetë ai. Dhe e këndonte. Një këngë. Jo këngë poeti. Kënga e një njeriu si ai.

Vetiu fillova të murmurisja nën buzë: «Që kur kalova Mursinë»... Kur e dëgjova për herë të parë këtë varg, unë mbeta fare indiferent. Natyrisht çdo njeri mund të zbriste e të kalonte Mursinë dhe, po të donte, të kthehej prapë në fshatin e vet, le

të ishte ky edhe një fshat si Smokthina. S'do mend që, për të shkuar në Mursi, udhëtari do të lodhej ca, po mund të lodhej pak, në qoftë se i hipte mushkës e udhëtonte në fresk të mëngjezit, në një nga këto ditët argëtuese të shekullit tonë.

«Çupat e Frëncës s'm'u shqinë»... — Ç'hyn këtu Franca? Ku Mursia e ku Franca! Përnjëherësh unë qesha. Qesha rrëmbyeshëm, pa u përmbajtur dot. Shih gungua... shih, po... «Që kur kalova Mursinë». Dhe kujt do t'i shkonte në mendje se ajo na qenkësh Marseja vetë. Sikur ai të ishte i gjallë tani. Në këtë dhomë të vetme, të heshtur unë dhe ai. Do ta kisha pyetur: «Vërtet, si t'u duk Marseja? Nuk u trembe pak nga bardhësia e saj, nga gumëzhitja e dritat e saj? Nuk u përmbyste në tokë nga marrëmendja para një hutimi të tillë? I mjeri ti! Fatkeq! Po si t'u duk Marseja, si? «Hiçgjë... ornok Mursia... «Ç'më thua kështu! Eja në vete... Hiçgjë? Mursia në vend... Vetëm që çupat nuk t'u shqinë. Lanet qofshin! Ranë si grerëzat në mjaltë në një bukuri si ajo jotja». I vetëm po qeshja në dhomë. Kisha hyrë në bisedë me të. Ai këndonte. Kishte lënë pas këngën. Dhe unë dashur padashur këndoja nëpër buzë:

*«Çupat e Frëncës s'm'u shqinë.  
Ta marr unë a e merr tinë...»*

Ja ai, njeriu i vogël, i gjymtuar, ironik e tallës. Hokatar. Para botës së madhe e para vetes. Fatkeq për bukurinë e tij. Tragjik në jetën e vdekjen e vet. Dhe në këngën e tij aq fatkeq, sa prej syve i dalin lot. Shembëllen me njeriun, dhembja e të cilit ka-

lon çdo kufi dhe ai, në vend që të qajë, qesh prej asaj dhembjeje. Njerëzit e shikojnë, shikojnë lotët në sytë e tij dhe u duket sikur ai po qesh. Prandaj s'e harrojnë dot. Dhe ashtu e kujtojnë atë të qeshur edhe pas vdekjes.

*«Po unë erdha në Smokthinë  
Me qyllah të fshij mullinë...»*

U ngrita përnjëherësh nga shtrati. S'mund të rrija më. Vija rrotull nëpër dhomën e heshtur. Ftohtë. Jashtë po agonte. Prej kanateve të dritareve sapo zbardhte një pipëtimë drite. Endesha nëpër dhomë. Cili ishte ky mulli, ku kishte punuar kurrizua? Përrroi ishte atje poshtë. I katërti, më fatën thënë. Atje bluante ai. Po ishte akoma herët e ftohët. Veç dhoma tani ishte e zbrazët për mua...

Hija e gruas dhe e atij gungaçit kishin ikur prej aty dhe kishin shkuar tej në mullirin e tyre. Atje duhej t'i ndiqja. Ishte edhe ajo copëz e jetës së tyre. Dola jashtë. Shiu kishte pushuar. Gjithshka kullonte, edhe toka, edhe pemët, edhe mjegulla. Unë ecja e mbaja vesh ata zëra, kur para meje u shfaq vijëza e parë e jazit e pastaj hija e një ndërtese të vogël. Ja, një mulli. Ai ishte i prishur e ujët kishte plasur përreth. Qëndrova një copë herë para tij. Mulliri ishte i vogël, me mure të gurta, të rëna. Tek qëndroja në këmbë para tij, sikur shikoja vetë braktisjen. Gjithshka aty ishte e vjetër dhe e braktisur. U nisa dhe eca më poshtë. Ngadalë po zbardhonte. Drita po hynte nëpër atë luginë të ngushtë dhe gjithnjë e më shumë shkëlqente bardhësia e stërklave të ujit të përroit, që treteshin nëpër mjegull. Ja dhe mulliri i dytë. Ai

ishte i mbajtur mirë. Brenda tij dëgjoheshin zëra. Fshatarët po bluanin drithin. Unë shkova më tej. I katërti, më kishin thënë. I katërti ishte mulliri i kurrizos. Kur arrita atje, dita kishte rënë ngado. Lugina midis maleve nisi të zbardhte e tëra. Nëpër të notonte mjegulla e bardhë. Dhe e mbulonte me atë murmurimën e saj të përhershme. Ashtu mbulonte ajo edhe atë mulli të vjetër, të braktisur. Jazi ishte i shkatërruar. Muret të rëna. Dera e ulët gati sa s'ishte kthyer në një pirq gurësh. Duke ecur nëpër ujë, hyra brenda. Errësirë. Vetëm errësirë. I gjithë mulliri kishte qenë një dhomë e gjerë, e ulët e ftohtë. Gurët e mëdhenj të mokrave, të braktisur, dergjeshin aty akoma.

*«Po unë erdha në Smokthinë  
Me qylah të fshij mullirë.»*

Këtu, mes kësaj gumëzhitjeje të përhershme të ujit, nën këtë avullim të mjegullës malore, kurrizua mullixhi këndonte këngën e vet. Dhe ashtu si çdo këngë te ne, ai e kërcente. Dhe e kërcenin gjithë fshatarët. Burra e gra. Qeshnin e përplasnin duart.

*«Çupat e Frëncës s'm'u shqinë,  
Ta marr unë, a e marr tinë...»*

Ata kërcenin, si ca qenje të çuditshme, të dala prej injegullës dhe vërtitëshin përcëri brenda asaj mjegulle. Sa të bluhej misri, kishte kohë. Uji rridhte e mokrat punonin. Ata mund të këndonin e të kërcenin. Të gjithë. Të gjithë. Formonin rrethin e madh, zënë dorë për dorë.

*«Po unë erdha në Smokthinë  
Me qylah të fshij mullinë.»*

Ai me ato këmbët e tij të gjata e të holla qëllonte tokën. Të tjerët këndonin. Midis tyre ishte edhe Q.D. Edhe ajo këndonte e qeshte e përplaste duart para fytyrës së saj të vogël.

Në barrën e druve mbi kurriz, Q.D. zbriste nga mali. Pas vinte një grua tjetër. Ecnin të kërrusura e të djersitura. Gjithë ditën ato kishin bërë dru në pyll. Tani po ktheheshin. Udha kalonte nëpër një rrëpirë, e gratë shkelnin me kujdes mbi tokë. Llastikat kërkonin e gjenin gurët e sheshtë ku të mbështeteshin.

— U lodha — tha Q.D.

— Qëndro diku... — tha tjetra.

— Ja edhe pak. Duhej të ishim kthyer më parë. Tani u bë vonë.

Nëpër errësirë u dëgjua kënga e bufit: huuu...

— Qafsh kokën tënde — tha gruaja që vinte nga pas.

Q.D. s'u përgjegj. E tatëpjeta vazhdonte dhe ajo ndjente se si edhe vetë po kridhej në errësirën e ftohtë të malit. Tej, dritat e vogla të fshatit ngjanin me ca kandile të zbeta të varfëra. Njerëzit ishin shumë të egërsuar. Sa dilte shkurti e hynte marsi, pjesa më e madhe e fshatarëve s'kishin bukë. Ata shkonin të merrnin hua nëpër agallarë, që t'ua kthenin pastaj në qershor apo në korrik. T'ua kthenin me këst. Kurse xhandarët e Zogut harboheshin.

Ndanë udhës ngrihej një shkëmb i vogël. Q.D. u kthye me shpinë dhe lëshoi mbi të vandakun e druve.

— Të çlodhemi, se na u mor fryma — i tha gruas pas.

Tjetra ofshau dhe erdhi edhe ajo t'i vinte shpatullat shkëmbit.

— Jetë... — tha pastaj nëpër dhëmbë.

— Kjo s'është jetë... — tha Q.D.

— Andej si jetohet? — tha gruaja duke çliruar litarët prej kurrizi.

— Jetohet...

— Andej njerëzit kanë gjithshka.

...Q.D. desh të thoshte diçka, por heshti. Huuu: u dëgjua kënga e bufit mbi to. Zëri i shpendit përhapej nëpër atë qetësi të malit, të pyllit e të natës. Ajo këngë po e nervozonte gruan. Atë mbrëmje gjatë gjithë udhës po i ndiqte pas. Në fillim e kishte dëgjuar si shumë e shumë herë të tjera, kurse tani s'po e duronte dot më.

— Kudo që të jetosh, duhet të punosh — i tha shoqes përbri.

— Si këtu?

— Si këtu... Kudo duhet të shesësh lëkurën tënde...

— Po kështu si te ne... Këtu është fundi i botës — tha shoqja. Q.D. lidhi prapë litarin e supit. Ato u nisën.

— Ne jemi fundi i botës sepse durojmë shumë — tha ajo ngadalë duke u kërrusur gati një me tokën nën barrën e druve. — Durojmë... Edhe mbretin edhe beun edhe aganë... Durojmë.

— Durojmë... — tha gruaja pas.

«Fundi i botës...», tha Q.D. me vete duke ecur ashtu e kërrusur mbi tokën malore, që zbriste e

zbriste përposh. — Megjithëse kushedi se ku gjendet vërtet «fundi i botës»...

— Te ne — tha gruaja. Asaj i merrej fryma. Drutë mbi të ishin shumë të rënda. — S'ka ku të jetë tjetër. Këtu, te ne.

Huuu... u dëgjua kësaj radhe si më e largët kënga e bufit.

— Do të vijë dita...

— Oh, ditë zeza — tha gruaja pas.

...Bufi këndonte nëpër natë. Gratë ecën një copë herë të heshtura. Sa mund të shpejtonin, ato shpejtonin. Ishin nisur vonë nga mali e nata i kish-te zënë në mes të rrugës. Po ishin dy. Dhe e dinin që ishin pranë njëra-tjetrës. Si dy hije ato ecnin nëpër tragën e ngushtë të pyllit. Fshati po afrohej. Një qen lehu diku. E një zë hakërronjës bariu u dëgjua. Pastaj përsëri ra heshtja. E thellë. E gjith-anshme. Ajo heshtje sikur përpinte gjithshka.

— Do të vijë... do të vijë dita — tha Q.D.

— Uh, ditë zeza!... — tha përsëri gruaja pas.

Kjo e zëmëroi Q.D-en. Frymëmarrja e saj u dendësua. Ajo rënkoi nën barrën e druve. Njerëzit ishin të shtypur. Shumë të shtypur.

— Ty do të të futin në burg — tha gruaja që vinte pas. — Ti flet shumë kundër mbretit e agallarëve. Edhe teatrot me djemtë e shkollës e me mësuesin ti i bën. Ty do të të burgosin. Ata i dinë të gjitha...

Q.D. s'tha asgjë. Ajo ishte lodhur, e këputur. Lagjja e tyre ishte akoma poshtë. Huuu... u dëgjua kënga e bufit. Trishtimi i asaj kënge i pushtoi të dyja gratë nën barrë të druve. Atë mbrëma, nën atë barrë e në atë natë të dyja ato donin të dëgjo-

nin një këngë tjetër. Diçka tjetër. Të ndryshme. Kurse i ndiqte ngado ajo këngë bufi e trishtuar dhe e frikshme.

— Ty do të të futin në burg — tha gruaja pas. — Ti i bën të gjitha këto. Dhe ata e dinë. Kur s'ishe ti, nuk kishte asgjë. Ruaju, motër!

— Këtu vetë jeta është burg...

Ato hynë në udhën e fshatit. Era e rëndë e baj-gave të bagëtive dhe e tymit të prallit të njomë i goditi në hundë. Gratë ecnin e rënkonin nën barrë. Të kërrusura, si ca qenje të vockla, gati rrëshqisnin mbi tokë.

— Kurva! — Na i tërboi gratë... — foli një zë i trashë burri nga hajati i një shtëpie.

— E dëgjove? — tha gruaja, që vinte pas.

— E dëgjova...

Huu... u dëgjua bufi mbi fshat.

Kur unë mora të përpjetën e ngjita grykën e përroit, dita kishte zbardhur ngado. Në udhën e fshatit fëmijët turma-turma shkonin në shkollë. Fshatarët prej kohe kishin dalë nëpër ara. Pranë meje kaluan tri mushka të ngarkuara me mataratë e qumështit. Duket se vinin prej malit. Koha ishte prapë e vrejtur, po copa-copa qielli kaltërohej. Edhe megjulla ngadalë po shkrinte e po ngjitej gjithnjë e më lart, duke shpalosur para meje pamjen e gjerë të maleve përreth. Grumbuj shtëpish zbardhnin gati në çdo kodër.

Në zyrat e kooperativës hynin e dilnin njerëz. Dikush bisedonte në telefon, ndonjë tjetër diçka porositte. Kryetari i kooperativës i jepte urdhëra një brigadier. Në një tavolinë në dhomën e tij,



ishite ulur një gazetar, që sapo kishte ardhur prej qyteti.

— Kjo kooperativë qenka interesante — më tha ai sapo më ndjeu pranë. — Për kushtet malore të saj, kjo kooperativë...

— Unë u gëzuash shumë, që njerëzit këtu kanë filluar të merren konkretisht me probleme ekonomike... të një ekonomie të madhe, dua të them — i thashë unë. — Dikujt kjo mund t'i duket e parëndësishme por, po të mendosh, ata fshatarët tanë të djeshëm, të varfër e të prapambetur...

— Do të shkruaj një shkrim — tha gazetari. Dhe mua përsëri m'u kujtua ajo redaktorja... Asaj dite, kur rastësisht shkova në redaksi, as ajo e as unë nuk mund të parashikonim dot se ku do të më çonte ai shkrim për Q.D-en.

— Me leje?

Unë u ktheva pas. Një djalë shpatullgjerë, me një kokë të madhe me kasketë qëndronte para meje.

— Unë jam mësuesi i shkollës — tha ai.

— Gëzohem.

— Erdha t'ju takoj për diçka... Në qoftë se mund të na ndihmoni...

— Unë? — pyeta i habitur.

— Matanë lumit ndodhet një kodër, që ne këtu e quajmë «qytezë». — Mësuesi fliste ngadalë e shkoqur. — Atje traktori ka nxjerrë një bust.

— Bust?

— Një bust të madh, të bardhë...

— I mermertë?

— I gurtë... po të donit të na ndihmonit... Ka mundësi ta shihni vetë?

— Tani?

— Mirë do të qe... — tha mësuesi me atë tonin e ngadaltë e të shkoqur të tij.

Isha nisur për në fshatin e dikurshëm të Q.D.-es. Për në shtëpinë e saj të dikurshme. Dhe ja tani prej nëntoke traktori këtu nxirrte buste të bardha. Plugu i thellë i tij zbulonte një jetë të tërë antike, mbi të cilën, pa e ditur, nëpër shekuj janë endur këta fshatarë. Mbi atë botë antike ishte rritur edhe ajo, Q.D-ja. Ku mund ta parashikonim atëhere unë e redaktorja këtë?!

## VII

Disa prej tyre ajo i kishte njohur edhe më parë, të tjerët i shihte vetëm tani. Pyeste ndonjë, që kishte pranë dhe mësonte emrat e atyre, që flisnin. Krerët e emigracionit shqiptar ishin mbledhur në atë sallë, për të diskutuar mbi luftën kundër mbretit e rreth bashkimit të tyre. Ata emra të dëgjuar gjithnjë i «kishin folur kombit»; ata emra edhe tani vazhdonin të rridhnin e të gërry-heshin nëpër faqet e kolonat e gazetave të ndryshme. E vetmja grua midis tyre qëndronte e heshtur në karrigen e saj. Kishte të drejtën e dy votave: të kolonisë shqiptare të Kanadasë dhe të asaj të Kubës.

— Ne ishim në fuqi dhe Zogu na e mori nga duart vendin. Edhe në qoftë se do t'ja marrim pushtetin, me se do ta mbajmë?

Njeriu që fliste kishte një trup mesatar, fytyrë të gjerë e bark të lëshuar poshtë. Fliste ngadalë dhe duke gjetur me lehtësi fjalët, hidhte shikimin e vet mbi krye të të pranishmëve.

— Ne e kishim pushtetin — thoshte ai — Pastaj? Zogu na e rrëmbeu. Këtë nuk duhet ta harrojmë kurrë. Shumë janë shkruar e janë folur. Edhe na kanë lavdëruar, edhe na kanë sharë. Dhe ndofta për një kohë të gjatë do të vazhdojnë të na gjojnë.

— Patjetër — thirri dikush. — Do t'ju gjojnë...

Oratori nuk e ndërpreu bisedën e vet.

— E rëndësishme është që ne vetë ta kuptojmë përse humbëm. Dhe përse ai — kësaj radhe oratori nuk donte ta përmendte emrin e mbretit — fitoi.

Q.D. dëgjonte e heshtur. Këtë njeri ajo e njih-te personalisht. Disa herë vetë kishte biseduar me të.

— Ku do të mbështetemi? — thoshte oratori duke hedhur shikimin e tij mbi kryet e të pranishmëve. Vetëm atëhere Q.D. u kujtua se njeriu që fliste i paskësh vërtet këmbët të shkurtëra e të përthyera. — Ku do të mbështetemi? — Pyeste ai. — Zogu është dinak. Gjithnjë është mbështetur diku. Tërë politika e tij është të mbështetet në një fuqi të jashtme. Dhe jo vetëm në një. Ne nuk ishim më pak të zot ta qeverisnim vendin. Jo. Ne nuk arritëm dot të krijonim lidhje, kurse ai, pa ardhur në fuqi, u mbështet diku...

Oratori i mëshonte çdo tingulli të fjalëve që thoshte, Q.D. e kishte vështirë të kapte gjithë fja-

limin e tij. Ajo e kishte dëgjuar atë edhe herë të tjera. Sapo që kthyer prej Shqipërie, ai e kishte thirrur në apartamentin e vet, i kishte shtruar drekë dhe i kishte folur asaj gjerë e gjatë mbi luftën që duhej bërë kundër mbretit.

— Nuk ka rrugë tjetër — thoshte oratori...

— Zogu qëndron në pushtet, sepse mbështetet jashtë. Ne duhet të vijmë në pushtet duke u mbështetur nga jashtë. Shqipëria vetë nuk ka forca...

— «Lakra» «Lakra», murmuriti me vete grua-ja. — «Lakra»... Ajo qëndronte e heshtur në karrigen e saj. Shikonte njerëzit, që lëviznin nëpër sallë, dëgjonte zërat e tyre, që përziheshin me atë të oratorit dhe, pa lëvizur, heshte në vendin e vet. Ashtu mes zhurmës së sallës prapë ajo përpiquej të kapte çdo fjalë të njeriut që fliste.

— Po nuk kuptuam pse humbëm — thoshte oratori — s'kemi për të fituar kurrë. Dhe ndofta atë fat meritojmë...

Dikush u afrua pranë Q.D-es.

— E dëgjon?

— Ëhë...

— Këto të gjitha ne i dimë. I dimë dhe se ç'do të na thotë ai më tej.

— Të dielën eja për drekë nga ne — i tha ajo. — Do të të thër një pulë.

— Pulë? Po pse të dielën? Sot...

— Jo sot. Të dielën.

— Oh, gjer të dielën. Ja, do të dalim prej këndeje dhe unë, duke shkuar udhës, do të dëgjoj kakarisjen e pulës sate: ka-ka-ka-ka... Do hutohem... Hop mbi mua një maqinë... ka-ka-ka-ka-ka-ka-ka

do të dëgjoj të kakariset pula jote edhe në çastet e fundit të jetës sime.

— Mos — i tha gruaja. — Nuk dua të të dëgjoj ashtu. . .

— Kur të vdesësh ti, unë do të mbaj fjalim... shoqja Q.D. e vetmja shoqe jona. . . Revolucionarja e patrembur. . .

— Mos — tha gruaja përsëri.

Në atë kohë po fliste një orator tjetër. Ata të dy heshtën.

— A.K. — tha burri pranë.

Atë emër Q.D. e kishte dëgjuar, po vetë njeriun nuk e njihte. Tani po e shihte për herë të parë. Gruas i vajtën menjëherë sytë te xhepet e tij të mbushura me lloj-lloj gazetash të Parisit. Kish-te një trup mesatar e një fytyrë të hequr, të gjatë. Në atë kohë oratori hodhi një shikim të heshtur mbi qetësinë e sallës e tha:

— Vetëm Musolini mund të na shpëtojë.

Heshtje.

— S'ka tjetër — vazhdoi oratori. — Historisë së sotme i duhej një burrë i ndritur. Ajo e krijoi atë. Musolini. . . tek ai po hedhin sytë popujt e Evropës. Bota. Tek ai duhet të shikojmë edhe ne.

Q.D. dëgjonte e vërente burrin që fliste. Emri i tij sa e sa herë merrej nëpër gojë të emigrantëve e përmendej nëpër kolonat e gazetave. Gruas ju kujtua ajo mbrëmje në fshatin e vet, kur me barrën e druve mbi shpinë kthehej prej mali. Pas e ndiqte shoqja e saj. Ç'do të thoshte tani ajo fshatare, po ta dëgjonte këtë orator? Ç'do të thoshte i kunati me atë trup të deformuar, me ato duar të mëdha, me të cilat thyente gjithë inat bukën e mi-

sërt, po të dëgjonte se çlirimin atij duhej t'ja jepte një farë Musolini? Q.D. pa xhepet plot gazeta të oratorit. Dhe murmuriti me vete: «Ja ç'na qenka... Vërtet, këta oratorë i prisja, në emër të kujt flasin këtu?» Ajo e njihte shumë mirë atë gungaçin, atë kurrizon e shëmtuar të Boderrit. Dhe e dinte se ç'do t'i thoshte ai këtij oratori, po ta dëgjonte tani. Gruas ju kujtuan fjalët e asaj hijes së gjymtuar, atje rreth errësirës së vatrës.

— Na keni harruar ju...

— Jo — i tha ajo.

— Na keni harruar... edhe ti... edhe im vëlla... edhe të tjerët... Maskarenj janë... maskarenj janë të gjithë...

Oratori vazhdonte të fliste.

— Historia — thoshte ai — e krijoi udhëheqësin e vet. Dhe ne duhet t'i jemi mirënjohës fatit, që atë e kemi pranë, fare pranë. Vetëm Musolini mund të na shpëtojë...

Njeriu me xhepet mbushur me gazeta të huaja s'pushonte së foluri. Ai fliste rrëmbyeshëm, gjithë pasion. Po midis Q.D-es dhe atij që fliste shkonte ajo gruaja e ngarkuar me barrën e druve. Ajo ecte e kërrusur gjer në tokë.

«— Na jemi fundi i botës — thoshte ajo.

— Do të vijë dita.

— Uh, ditë zeza! — thoshte gruaja.»

Midis Q.D-es dhe atij që fliste rrëshqiste hija e kurrizos.

«— Këtu njerëzit, si kafshët, hanë vetëm dy herë në ditë... lakra hanë... Bukë s'ka. Punë s'ka. Ka vetëm xhandarë. Dhe agallarë. Agallarë sa të duash...»

— Zogu mbështetet në gjithë qeveritë. Ne duhet të mbështetemi te një, vetëm te një: te Duçja...

— Ti, mos ke ardhur këtu si përfaqësues i Musolinit?

— Po ti, mos je këtu përfaqësues i rreckamanëve?

Oratori ju drejtua atij, që e ndërpreu.

— Po, i atyre jam. Dhe Shqipëria e tyre është.

— Sepse yt atë është vrarë për një dhi.

— Këtu bie era bej...

Në mesin e sallës u ngrit një burrë. Me trupin e tij mesatar e të shkathët, me lëvizjet e duarve të papërmbajtura, ai fliste e rrotullohej sa andej-këtej.

— Domethënë të luftojmë Zogun për të rënë nën zgjedhën e Musolinit... Të kërkojmë çlirim tonë nga satrapi i vetë popullit italian. Pse? Sepse Shqipëria nuk jetoka dot e vetme, sepse as ti e as ai tjetri nuk jetokeni dot pa një Benito mbi krye.

— Halimi, murmuriti Q.D. me vete.

— Po kur më në fund, kur do të jetojmë edhe ne pa një mbret, pa një hije të madhe, pa një Musolin? Kur do të jetojmë edhe ne pa një perëndi të tillë mbi kokë? S'jetokemi dot... burri nga mesi i sallës heshti. Ai shikoi rreth e rrotull e pastaj me zërin e egërsuar ju drejtua oratorit... — Po kush, nuk më thoni, kush nuk jeton dot pa Musolinin? Ne, apo ju?

— Ti...

— Më duket se ju. — Ju nuk jetoni dot pa një perëndi tuajën. Përherë doni ta kenë një të tillë, që të jeni të sigurt. Dhe këtë mendim na e

futni në kokë edhe neve... Zogu di, mbështetet diku, prandaj sundon, prandaj dhe shtyp popullin. Edhe ne duhet të mbështetemi diku, në qoftë se duam që edhe ne ta shtypim atë popull.

— Nuk është e vërtetë — klithi oratori.

— Ti ke një orë këtu që po e thua këtë.

— Nuk është e vërtetë.

— Këtë po thua ti: të mbështetemi diku, në qoftë se duam të sundojmë... — Burrit, tek fliste nga mesi i sallës, i merrej fryma nga të folurit. — të mbështetemi diku e, po, me të vërtetë ne duhet të mbështetemi diku... Ne duhet të mbështetemi në popullin tonë... në ata punëtorë të shtypur gjer në palcë, në ata fshatarë të uritur... që të gjithë hungurojnë e kërcasin dhëmbët për Zogun.

— Vetëm?

— Jo vetëm — tha ai. — Ka dhe një proletariat botëror, ka dhe një internacionale komuniste... Ja ku do të mbështetemi ne për çlirimin tonë.

Dikush ju afrua pranë.

— Dëgjo — i tha. — Ne jemi shokë të një ideali.

Halimi i hodhi atij një shikim të heshtur, që nga koka e gjer te këmbët. Pastaj tha:

— Unë e ti?

— Po...

— Për, çdo gjë tjetër, po. Veç shokë të një ideali, kurrë. Sepse unë jam pa brekë, kurse ti i ke të mëndafshita.

Mbledhja u prish.

— Nuk ka qenë kështu! — Njeriu që qëndronte para meje i ra me bastun këmbës së vet e tha prapë: — Unë kam qenë vetë atje, nuk ka qenë kështu.



Kishte një zë metalik e nervoz e, kur fliste, buzët e tij tkurrëshin e donin të puqëshin, por s'arrinin dot.

— Si ka qenë? — e pyeta unë.

— Halimi ishte në presidium e jo nëpër sallë, si të tjerët. Ai ishte një nga inisiatorët e mbledhjes.

— Ashtu?

— Kështu — tha burri me zërin e tij metalik.

— Mirë... ja po e vë atë në presidium... pastaj?

— Pastaj... — Ai i ra përsëri me bastun këmbës së vet.

— Pastaj — i thashë unë — çdo gjë tjetër a ka ndodhur ashtu si e përshkruaj? Si ma kanë tre-guar?

— Si të të them... ma jep ta lexoj vetë... — dhe zgjati dorën e mori shkrimin. Lexonte dhe herë pas here tundte kokën e vet.

— Si të të them... — tha më në fund... — pak a shumë kështu...

— Pse pak a shumë?

— E po ti mendon ta ngjallësh të tërë atë mbledhje, ashtu si ka qenë? — Zëri i tij ishte po ai metalik e nervoz, po në të vërtetë tani nëpër atë zë kalonin rryma të ngrohta, që unë i ndjeja vetiu.

— Pse jo? — i thashë unë. — Ta ngjallim... ashtu siç ka ndodhur... Q.D. ishte atje?

— Ishte.

— Ashtu si e përshkruaj unë?

— Pak a shumë... po mirë... Edhe kështu mirë... — Edhe këto fjalë ai i tha po me atë zërin e hakërruar të tij.

«Cilin kërkoni, ju lutem?»

Unë shkova sërish në atë shtëpinë e verdhë, dykatëshe, në atë shtëpinë burg të dikurshëm, ku atëhere një grua me fustan të gjelbër me pulla të bardha më pyeti: «Cilin kërkoni, ju lutem?» Unë s'dija si t'i përgjigjesha. Ajo ishte një ndërtesë e zakonshme banimi. Dhe jeta aty rridhte si kudo gjetkë. Ndofta njerëzit atje nuk e dinin fare se dikur në atë vend SS-ët kishin ngritur një burg të egër. Ata njerëz më shëmbëllenin me udhëtarin, të cilin e ka zënë nata jashtë dhe ai pa e ditur shtron pallton përposhtë dhe fle mbi tokën, ku është varrosur një njeri.

«Cilin kërkoni, ju lutem?» Unë u ktheva aty që ta takoja sërish atë grua. Dëshiroja t'i thosha se cilën kërkoi, dëshiroja t'i thosha se në atë dhomë, ku ajo tani banonte, dikur kishin burgosur njerëz, që nuk ekzistojnë më.

Në sallonin e gjerë nuk kishte njeri. As fëmijët nuk luanin nëpër dyshemetë me dërrasa. Vetëm një vajzë e re e hapi derën e dhomës së vet e doli prej andej. Më pa, më përshëndeti dhe m'u drejtua: «Cilin kërkoni, ju lutem?» Po ajo pyetje. Vajza kishte një fytyrë të rrumbullakët, e flokët gështenjë i kishte kapur pas me një karficë. M'u afrua pranë. Nuk ishte e bukur, po vetëm ishte tepër e re dhe e freskët.

— Këtu... — thashë unë — kjo ndërtesë dikur ka pasë qenë burg.

— Po — tha ajo.

— Ju e dini këtë?

— Posi — tha vajza pakëz e habitur. — Si nuk e dimë?

Qëndroja i heshtur para asaj vajze të re. Shi-

kimi im binte mbi të, po mendimet davariteshin diku e s'po mundja t'i kapja.

— Një ditë — tha vajza — këtu erdhi një burrë plak. Kishte qenë vetë i burgosur dhe kishte ardhur ta shihte këtë vend.

— Si e quanin?

— S'më kujtohet. Prej këndej atë e kishin internuar në Dahau. Pas mbarimit të luftës ishte kthyer... Po, do të më falni — tha vajza — unë kam orën e punës.

Dola përsëri jashtë. «Cilin kërkoni, ju lutem?» Ata njerëz nuk e dinin se cilën kërkoi unë. Dhe s'kishin si ta dinin. Po edhe ajo gruaja me fustanin e gjelbër me pulla të bardha e paskësh ditur se aty, dikur, kishte qenë burg. Këtë e paskëshin ditur të gjithë. Edhe fëmijët ndofta. Jeta s'kishte lënë asnjë shenjë të burgut të dikurshëm. Ata njerëz banonin aty, ashtu si do të banonin edhe kudo gjetkë. Toka kudo është tokë. Dhe jeta jetë. Vdekja është aq e zakonshme në jetë, sa ç'është fare e zakonshme të biesh në darkë e të flesh mbi tokë. Dhe të ngrihesh në mëngjez pastaj shëndoshë e mirë. «Cilin kërkoni, ju lutem?» Ata të gjithë e paskëshin ditur që atje dikur kishte qenë burgu. Vetëm se nuk e dinin dhe, s'kishin se si ta dinin, se cilin njeri kërkoi unë. Cilën jetë. Ku mund ta dinin ata, se mua, ai burri i shkurtër, me zërin e tij metalik e nervoz, që herë pas here i binte këmbës së vet me bastun, sapo më kishte treguar për të. Unë e pyeta për jetën e tyre në emigracion, po ai nisi të më thoshte, se njëherë vetë Q.D. i kishte treguar se si një mbrëmje, e vetme po shëtiste në trotuar. Nën gështenjat e egra kalonte midis udhëtarëve

dhe soditte mbrëmjen e ngrohtë e me shi të atij qyteti të huaj e të madh. Nën atë shi të imtë tetori ndritnin llambat shumëngjyrëshe. Në fillim ato drita e kishin trembur gran. I merreshin mendtë sa herë që ajo kridhej në to. Në fshatin e saj malor kishte fare pak dritë. As sa mund të lëshonte një bishtuk i varur mbi vatër. Kurse qyteti i huaj digjej si një bubulak i madh, i pafund zjarri. Dhe ajo në fillim u largohej atyre dritave. Po ngadalë u mësua. Tani një nga çastet më të gëzueshme të saj ishte ai, kur në qytet ngado fillonin të ndizeshin dritat. Mbrëmja binte, dhe ato digjeshin me tërë butësinë e tyre. Gruaja e re ecte e vetme në atë butësi e ngrohtësi të asaj mbrëmje tetori. Shiu binte i imtë. Frynte një erë e lehtë. Dhe gjithshka po i kujtonte Q.D-ës atë muzg tetori të vitit të kaluar, kur, e veshur me çitjane, me shaminë e zezë në kokë, në majë të mushkës ajo kthehej në Vlorë. Prej andej do të nisej sërish për në Paris. Më në fund qeveria e Zogut i kishte dhënë lejën.

Kjo mbrëmje tetori me shi e qytetit të madh e të huaj, i kujtoi asaj atë mbrëmje të vendit të vet. Edhe ajo ishte e ngrohtë si kjo. Po vetëm më e errët. Kjo ishte gjithë drita e zhurmë njerëzore, kurse ajo e vetmuar dhe e trishtuar në errësirën e saj. Dhe ashtu ajo mbrëmje, bashkë me mushkën e urtë e të bindur shkonte pas kapistallit të atij kunati të gjymtuar. Shiu filloi të binte më i dendur... Q.D. u fut nën një gështenjë të egër. Ajo ishte lagur e filloi të fshinte flokët, fytyrën. Kujtimi i të kunatit e kishte trishtuar, po edhe ai trishtim ishte tjetër, nuk ishte tamam ai i asaj mbrëmjeje, kur ajo kthehej e hipur në mushkë. Ky ishte trishtimi i kësaj mbrëmjeje të qy-

тетит të huaj, të madh, të mbuluar me ato drita. Dy të rinj erdhën e u futën nën gështenjë. Pikat e shiut tani binin të mëdha mbi gjethet e pemës. Herë pas here ato lagnin edhe Q.D.-en. Djali e kishte zënë vajzën prej dore dhe e tërhiqte pranë vetes. Ashtu ata shkuan e u mbështetën te trangu i pemës. E filluan të pushtoheshin e të putheshin. Djali hodhi duart në qafë të vajzës e diçka i pëshpëriti. Q.D. mendoi të largohej prej andej, por shiu binte i dendur. Ajo qëndroi aty. Djali e vajza ishin fare të rinj. Në dritat e mbrëmjes gruaja shihte fytyrat e tyre. Ata diçka i pëshpëritnin njëri-tjetrit, por gjer te gruaja arrinte vetëm «Sans autre». Shiu binte e të rinjtë putheshin e pushtoheshin. Dhe herë pas here pëshpëritnin «sans autre». Q.D. dëgjonte murmurimën e shiut nëpër gjethet e gështenjës së egër, që vinte tek ajo e përzjerë me pëshpërimën e dy të rinjve. Se ç'ishte ajo «sans autre», përse e pëshpëritnin ata aq shpesh, gruaja nuk po e kuptonte. Po sa fjalë pa kuptim flasin dashnorët. Dhe ashtu merrren vesh midis tyre! «Sans autre» arriti gjer te gruaja kësaj radhe zëri i vajzës. Ai ishte një zë i hollë; i dridhshëm. Q.D. shikoi andej. Vajza kishte veshur një fustan blu dhe me gjithë trupin e saj të imtë humbiste në krahët e djalit. Q.D. u largua nga gështenja. Shiu binte, po mbrëmja ishte e ngrohtë. Gruaja ecte ngadalë nëpër trotuar. Trishtimi kësaj radhe ishte tjetër. Nuk ishte ai i asaj mbrëmje, kur ajo, e hipur në mushkë, kthehej për në Paris. Ky ishte një trishtim, që tani përzihej me atë pëshpëritjen «sans autre» të atyre dy të rinjve. Mjafton kjo pëshpëritje, që të kuptonje se ka disa gaca të lëmshut të dheut, ku toka sikur është më e lehtë. Kurse

atje midis maleve, nën terrorin e Zogut e të agallarëve, toka ishte e rëndë, e rëndë. Dhe pastaj ndodhte ashtu që peshën e saj e mbante përsipër ndonjë gungaç e kurrizo i gjymtuar fare. Shiu binte mbi dritat e qytetit. Gruaja shkelte mbi to duke menduar se trishtimi i asaj mbrëmje ishte i butë e i lehtë. Dhe çuditej fort me veten e saj: përse u ishte trembur ajo në fillim atyre dritave.

«Cilin kërkonte, ju lutem?»

Ata njerëz nuk e dinin se cilën kërkoja unë. Ata dinin vetëm se dikur atje kishte qenë burg. Vetëm aq. Jeta ka një fytyrë të përgjithshme: jeta. Ashtu si edhe vdekja ka një fytyrë të përgjithshme: vdekja. Po si jeta, si vdekja kanë edhe nga një fytyrë të veçantë. Dhe, në qoftë se kjo është fytyra e asaj gruaje, drejt së cilës ti tani po shkon, si drejt një malli e dhimbje të thellë, atëhere s'ka se si të mos ndjesh në kraharor zemrën, që të shtrëngohet fort, fort..., sa të të merret fryma; s'ka se si të mos hysh në një bisedë të gjatë me të, nuk ka se si, në qoftë se je njeri. Po njeri, drejt ta hajë, duhet të jesh.

Unë lexoja e kërkoja nëpër kujtimet që kishin mbledhur arkivat e ndryshme. Më duhej të krijoja kushtet dhe ambientin e emigrantëve shqiptarë, që kishin jetuar atëhere jashtë shtetit dhe që kishin luftuar kundra mbretit Zog. Si kishin jetuar ata njerëz dhe cila kishte qenë jeta e tyre? Q.D. kishte qenë e tillë dhe mua më duhej ta vendosja

patjetër në atë botë të dikurshme ku kishte jetuar e punuar. Në fund të fundit, mendoja unë, do të më mjaftonin edhe kujtimet e cilitdo punëtori të thjeshtë emigrant sepse, sado e çuditshme që mund të jetë kjo, prapë herë-herë jetët e njerëzve u ngjajnë kostumeve të gatshme që shkojmë e blejmë nëpër magazina. Njëri kostum mund të rrijë ty aq mirë, sa mund të më shkojë edhe mua. Dhe unë mund ta blej dhe të jem i kënaqur me të. Do të më mjaftonte jeta e një punëtori të thjeshtë në emigracion dhe unë, pa shumë brejtje ndërgjegje, mund të futja brenda asaj jete njeriun që e quanin Q.D.

Po në të shumtat e rasteve ato kujtime që më binin në duar ishin shkruar prej «krerëve» të emigracionit. I lexoja dhe shikoja se si për ata njerëz gjithshka ishte kredhur vetëm brenda emrit të tyre. Koha, që kishte kaluar me revolucione e kundrarevolucione, me komplete e atentate pas shpine e pas koke, me shtypjet e tragjeditë e një populli të tërë, me skenat argëtuese të parlamenteve dhe grindjet e tyre për karrige, me varret e patriotëve, — të gjitha hynin brenda emrave të tyre dhe mund të jetonin vetëm aty. Unë lexoja ato kujtime e mendoja se si emri i ndonjë «kreu» të emigracionit tonë atëhere, në të vërtetë i ngjante asaj shtëmbës me dy vështa nën rrjedhën e çesmës së kohës. Koha kishte derdhur mbi të ujët e vet e shtëmba përnjëherësh ishte mbushur. Nga vetë ato kujtime lexuesi e kuptonte se rrjedha e kohës vazhdonte të sillte ujët, që tani derdhej jashtë shtëmbës së vogël prej balte. Ajo nuk nxinte dot më. Ndërsa jeta vazhdonte të krijonte qëllimet e reja, mjetet dhe format e tjera të luftës, njerëzit e thjeshtë e luftëtarët e panjohur,

që hynin në luftë për çlirimin e popullit. Po «kre-  
rët» ëndërronin se vetëm nga lartësitë e emrave të  
tyre, mund të mateshin shkëlqimet e ndershmë-  
risë së kohës.

Nga ato kujtime unë mësoja mbi subvensionet  
dhe qeveritë e ndryshme që u jepnin atyre të ha-  
nin, mbi mbledhjet e pashtershme, për fraksionet  
që ata vetë krijonin. Jeta e tyre ishte një jetë tje-  
tër. Dhe atë nuk mund t'ja vishja dot, ajo nuk i  
shkonte si kostum, punëtorit të thjeshtë emigrant.  
Mua më duhej jeta e asaj gruaje, që e kisha parë të  
rënë përmbys mes gjakut të vet, asaj dite prilli 1944.

U takova me tre ish-punëtorë emigrantë dhe u  
thashë:

— Mua më duhet të di mbi jetën tuaj atje.

— Po ç'kërkon të dish?

— Si punonit, si jetonit — u thashë unë.

— Emigranti kudo bën jetën e qenit — më tha  
mua ai më plaku, që mbante një palë syza të bardha  
në sy.

Dy prej tyre kishin qenë minatorë në minierat  
e Loirit, tjetri kishte hapur një barrakë atje dhe  
shiste pije. Në atë barrakë mblidheshin herë pas  
here punëtorët shqiptarë. Dikush edhe flinte aty.

— Një herë — tha plaku me syza të bardha, er-  
dhën prej Parisi dy shokë dhe kërkonin që ne, të  
porsaardhurit nga Shqipëria të bëheshim anëtarë të  
sindikatave. Po ne nuk bëheshim.

— Pse? — e pyeta unë.

— Pse... gjer atëhere ne ishim thjesht fshatarë.  
Kishim shkuar atje që të fitonim ndonjë lek dhe t'ua  
dërgonim fëmijëve në shtëpi, kurse ata na thoshnin  
që të bëheshim anëtarë të sindikatave. Ne duhej të



paguanim kuotat, po na vinte keq për ato dy të holla...

— Nuk ishim mësuar — tha njëri.

— Ku e njihnim ne atë botë.

— Ç'hoqën ata shokët e Parisit gjersa na bindën.

— Na bindën? — Njeriu pranë meje qeshi. — Na detyruan, thuaj... Në fillim ne më shumë prej turpfit shkruheshim në sindikata.

— Vetëm pastaj e kuptonim se ç'ishin ato për punëtorët. Kur shikonim se, për të mbrojtur të drejtat e shokëve, ngriheshin në këmbë gjithë punëtorët grekë e algjerianë, spanjollë e italianë... Vetëm atëhere e kuptonim se nuk ishim më vetëm.

— Oh, tani po më kujtohet diçka... për të qeshur — tha plaku me syza, do të më falësh. Kur ndonjëri kthehej në shtëpi, e përcillnin gjithë shokët dhe i dhuronin gjithsecili ç'të kishte. Le t'u çonte edhe ai fëmijëve diçka. Kishte lënë kockat kaq vjet në dhe të huaj, njeriu. Njëherë do të nisej për në Shqipëri një fshatar nga Vlora... nga Smokthina...

— Nga Smokthina?

Plaku heshti. Ai më vështroi një çast në sy e pastaj tha:

— E di? Ti ke të drejtë... Tani po më kujtohet. Atëhere kishte ardhur aty edhe vetë ajo, grua... Kishte ardhur të përcillte atë bashkëfshatarin e saj. Më kujtohet si tani. Gjatë natës që ne bisedonim e qeshnim, ajo heshte. Nuk thoshte asnjë fjalë. Fshatari që kishte punuar atje në miniera shtatë vjet, ishte bërë tuberkuloz dhe do të kthehej në shtëpi. Ne të gjithë e ndihmuam dhe ai mbledhi ca plaçka për t'i çuar në fshat. Më darkë, kur u mblo-

dhëm ta përcillnim, ai u bë pikë e vrer dhe, i sëmurë siç ishte, gati duke qarë na tha: — Po si do t'i çoj unë gjithë këto plaçka në shtëpi?

— Me tren, me vaporë. . . — u përgjegj dikush.

— Gjer nga Loiri në Vlorë unë i çoj — tha ai — po nga Vlora në Smokthinë si do t'i çoj? — Dhe ai u pikëllua. Të gjithë u pikëlluam. Si do t'i çonte ai plaçkat prej Vlore në Smokthinë?

Kjo kishte qenë jeta e atyre punëtorëve të thjeshtë, pa subvensione, pa hotele dhe apartamente, jeta e njerëzve, që kishin shkuar atje për të fituar bukën e gojës me djersën e ballit të vet. Kjo kishte qenë edhe jeta e asaj gruaje, që si një hije e ftohtë kishte heshtur gjatë gjithë asaj nate duke parë e pikëlluar atë bashkëfshatarin e vet tuberkuloz, që vlerosej se mushka nuk i çonte dot ato plaçka nga Vlora në Smokthinë. Natyrisht jeta e atyre njerëzve derdhej jashtë kujtimeve, që më binin mua ndër duar.

Per la chaise.

Emigrantë të vendëve të ndryshme kanë ardhur aty të përkuqtojnë komunarët legjendarë. Ka shqiptarë, gjermanë, bullgarë, italianë. . . Policët dikë kërkojnë. Ata lëvrijnë nëpër shesh, hyjnë nëpër dyqane e kafene, u afrohen njerëzve i kontrollojnë. Në rrugë janë ndalur maqinat e zarzavateve, të qumështit. Ato janë të policisë. Kur arrestojnë ndonjë, e hipin aty dhe e nisin pastaj. Policët dikë po kërkojnë. Duke ecur nëpër grumbullin e emigrantëve, një njeri afrohet pranë Q.D-es.

— Më falni — thotë ai me një buzëqeshje të lehtë — a mund të martohemi bashkë?

Gjithshka ishte e kuptueshme. Shokët vunë shpejt e shpejt në duar të gruas së re një tufë lule të freskëta. I panjohuri e mori atë prej krahu dhe ajo, e qeshur dhe e gëzuar, e shoqëruar prej emigrantëve të tjerë, u nis.

Po mendoja për dasmën e saj. Jo për atë në fshatin e vogël e të varfër malor. Jo. Për këtë në Per la chaise. Pranë varrit të komunarëve. Një dasmë e papritur dhe e pashpresuar ndonjëherë. Jo e zakonitë. Fati i njeriut është i çuditshëm. Metamorfozat e jetës së tij herë-herë nga më të gëzueshmet. Q.D. mban tani për krahu një njeri tjetër të panjohur fare. Kush është ai? Kush e di. Përse e kërkojnë? Prapë, kush e di? Një gjë dinë të gjithë: ai ka ardhur aty, në Per la chaise, dhe atë e kërkojnë. Në dasmën e saj të parë, burri sapo hyri në dhomën e vogël e të zhveshur, i shkeli gruas fort këmbën e djathtë. Ajo do të ishte përgjithnjë nën pushtet të tij. Këtu duhet të zgjatet dora e vogël e saj, që ky luftëtar i panjohur i çështjes së proletariatit botëror, të mund të dalë tani shëndoshë e mirë prej kordonëve të policisë. Kjo është një dasmë tjetër. Pa ato pesë kile raki të blera diku, pa atë cjap të marrë hua në Brataj. Një dasmë e papritur, të cilën nuk e kanë fat ta kenë të gjitha gratë. Ajo mban tufën e luleve në dorë dhe qesh tek u afrohet policëve. Me atë të panjohurin prej krahu. Ky është trupmadh, ka veshur një kostum të zi dhe, duke u përkulur pak mbi të, i thotë:

— Keni frikë?

Ajo e sheh në sy. Frëngjishtja e tij është e belbët.

— Mos keni frikë — përpiqet të thotë prapë ai buzëgaz.

Dora e tij kërkon të jetë e lehtë mbi dorën e saj. Njeriu nuk do të rëndojë mbi gruan. Kush të jetë vallë ai? Dhe pse e kërkojnë? Ajo ngre sytë dhe sheh kokën e tij mbi atë shtat të lartë. Policët po afrohen. Kush të jetë vallë ky njeri? Kjo është dasma e saj. Jo ajo e heshtura, pa krisma e pa pushkë. Një dasmë tjetër. Dora e burrit djersitet mbi krahun e saj. Ai përulet mbi të dhe ajo ngre kryet. E shikon në sy.

— Si qenkeni ju... — burri u përkul fare mbi të.

— Dashnorët janë gjithnjë fëmijë — tha polici pranë duke qeshur. Po i panjohuri vazhdon të pëshpërisë.

— Si qenkeni ju...

## VIII

«A të kujtohet? Ishte kështu si sot: vetëm shirë edhe erë... A të kujtohet? Në dy kasolle çobenjsh u fut gjithë batalioni partizan... Shtatë ditë e shtatë net në borë e ngricë... A të kujtohet kur ndamë fasulet? Vetëm dy kokrra për njeri... Dy kokrra... Oh, ajo ulërimë e ulkonjës! Ajo ulërimë... Kur e kujtoj, më duket sikur edhe tani e dëgjoj dhe më ngjethet mishtë...».

Ata ishin njerëz të thjeshtë. Bisedonin, pyesnin njëri-tjetrin dhe ashtu kujtonin dhe kujtoheshin vetë. Kujtonin ato, që kishin jetuar. Copëza të vo-

gla, fare të padukshme të jetës së tyre, që shpeshherë as ata vetë nuk mundnin t'i lidhnin e t'i bashkonin në një të tërë. Ndofta ata as që ndjenin nevojën ta bënin atë. Ata ishin fshatarë e fshatare, malësorë e malësore të thjeshta dhe u dukej sikur ato thërrime jete kishin qenë gjithshka, sikur ato thërrime kishin qenë vetë jeta. Dhe vetëm për ato flisnin

«I mora në duar ato dy kokrra fasule... Nuk i kishin lënë të zjenin mirë... I vura në pëllëmbë dhe po i shikoja... ishin fryrë, po cipëza nuk u kishte plasur akoma... — Pse s'i latë të zjenin të paktën pyeta... — Kështu mund t'i numrojmë, kur i ndajmë — më tha skuadërkomandanti».

Unë i menduar i dëgjoja ata kur bisedonin. Pyetje pas pyetjesh ecja edhe vetë nëpër atë luftë dhe me fjalët, mendimet, ndjenjat e tyre i ndërtoja ato ditë pak a shumë kështu:

Në zhurin e lumit të mbuluar me rrepa të moçëm, ishte mbledhur tërë katundi. Gratë mënjanë, burrat në tjetrën anë. Shumica e popullit kishte zënë vend e ishte ulur shesh në tokë. Fëmijët bridhnin përçark, luanin dhe u afroheshin dy partizanëve dhe një partizanes së armatosur, që mbanin pushkët e gjata në duar. Ata më të guximshmit u afrohestun pranë dhe i preknin me dorë ato pushkë.

S. Agai, vetë, e hapi mbledhjen. «Ju më njihni mua, — u tha ai fshatarëve. — Dhe unë ju njoh mirë juve. Unë nuk them dot që jam më shqiptar se ju sepse, kur ka ardhur puna, ju e keni shkrepur për vatanin. Po as ju nuk mund të thoni dot që jeni më shqiptarë se unë sepse, kur është dashur, as unë nuk kam qëndruar d'uar kryq. Me aq sa kam

mundur, e kam bërë timen. Ju këtë e dini mirë; gjithnjë me mua keni qenë. Bashkë kemi qenë...» «Ashtu është» — tha një plak, që ishte ulur në tokë, në rreshtat e parë, mu atje te këmbët e agait që po fliste. Fshatari kishte një trup të vogël, këmbë të shkurtëra e në kohën që fliste S. agai ai tërhiqte me flegra të zgjeruara llullën e duhanit; «Ashtu është» — tha prapë fshatari. — Dhe unë prandaj erdha sot këtu — tha agai. — T'ju them që të jemi bashkë. T'ju lutem që të jemi bashkë. Kohërat janë të liga. Bota e tërë kullon gjak nga lufta. Armiku nuk ka shkelur e ne jemi një popull i vogël...» «Ashtu është...» — fshatari plak tundi kokën, hoqi qylahun e zhubrosur e filloi të kruante tuçin me gishtërinjtë e trashë e të shkurtër. «Jemi një popull fare i vogël — tha agai. — Kurse armiku është i madh. Ç'mund të bëjmë ne?» «Të rrimë, duarkryq» — i thirri atij një partizan. S. agai nuk e prishi gjakun. «Jo — tha ai — ne nuk do të rrimë duarkryq. Se edhe ne jemi bijtë e atyre, që luftuan e u vranë për këtë copë vend, për këto male, për këtë lumë, për ato ara. Do të luftojmë, po lufta duhet bërë me mend në kokë, se mund të humbasësh edhe vendin edhe kokën...». «Ashtu është» — tha prapë plaku, që ishte ulur përpara. «Luftën mund ta fillosh, si fëmija lodrën e vet — tha agai — po pastaj shpejt do ta kuptosh se s'është lodër. Se ajo të djeg. Të vret. Të gjithë jemi shqiptarë. Dhe ne do ta luftojmë armikun, që na erdhi në shtëpi pa ftuar; po me mend në kokë, jo si fëmijë. Jemi të vegjël. Duhet të presim ca, të shohim...» «Populli po lufton!» — partizani, që mbante në dorë pushkën e gjatë, u ngrit prej vendi, kapërceu disa burra e doli para po-

pullit. «Shqipëria po lufton. — tha ai. — S. agai nuk e di këtë? Në Vlorë, në Tiranë, në Korçë, po vriten e po vriten bijtë e popullit...» «Ashtu është» — tha përsëri ai plaku i vogël atje në rreshtat e parë. Ai fliste me zë të lartë e tundte kokën e mbuluar me qylah. Fshatarët, që dëgjonin oratorët, dëgjonin edhe atë. Disa filluan t'i thërrisnin: «Na lërë rehat, o xha Braho!» Të tjerët po qeshnin. Plaku nisi të mbushte llullën me duhan dhe tha prapë: «ashtu është». «S. agai e di që Shqipëria po lufton, po digjet e po piqet nga fashizmi, megjithatë, ai po thotë: «Ne do ta bëjmë luftën». Ajo, lufta jonë, nuk qenka luftë për të?! Agai «Populli quan vetëm atë, që shkon pas tij. Të tjerët jo. Po duhet ta dijë: veç tij jemi edhe ne, populli...». «Ashtu është. Jemi, si s'jemi». «Edhe ti ke të drejtë, o djalë, edhe S. agai ka të drejtë» — tha xha Brahua.

Partizani me atë pushkë të gjatë në dorë u kthye nga vetë S. agai: «Tani, o aga, thuaja troç popullit: do ta luftosh ti fashizmin, apo jo? Do ta luftosh? — Atëhere merr pushkën dhe eja me ne... Në mos, thuaje këtu se ti je me të». — kësaj radhe kurrkush s'u dëgjua të fliste. As xha Brahua, atje në rreshtat e parë të burrave. Qetësia mbuloi zhurën e lumit asaj pasdite të nxehtë. «Shqipëria po lufton. Ti ç'do të bësh? — thirri partizani dhe u kthye rrëmbimthi nga fshatarët: — po ju, ç'do të bëni? Do të prisni aganë, që edhe tani, ju rrëmben atë kafshatë buke nga goja? Dhe prisni që ky të luftojë fashizmin?» «Ti nuk më njeh mua: këta më njohin». — Agai tregoi me duar fshatarët. «As unë nuk të njoh ty se cili je. Këta e dinë që në konakët e mi ditën e natën, dimër e verë, fukarai e ka gje-

tur derën të hapët...» «Oh, mëshirë e madhe e agallarëve dhe e bejlerëve! Nuk di se si e ndjejnë veten këta, kur vijnë e i ndërën dorën zotërisë sate, që t'u japësh një karroqe misër, të cilën do ta kthejnë pastaj ashtu si e do ti... Këta vetë e dinë. Ne jo. Ne, partizanët, do ta shembim atë mëshirë të bejlerëve. Ne do ta çlirojmë popullin...»

E morën fjalën edhe fshatarët vetë. Populli i dëgjonte, po tani edhe ai gumëzhinte e fliste. Burra, gra. Herë thërrisnin, herë bisedonin midis tyre me zë të ulët. Zhurma e njerëzve i mbulonte tanimë edhe fjalët e oratorëve.

Rreth Q.D-es ishin mbledhur një tufë gra. E dëgjonin. «Erdhi dita jonë — u thoshte ajo. — Luftë fashizmit! Bejlerëve dhe agallarëve populli ua ka shqepur pusullën me vakt...» Papritur u ngrit në këmbë ai plaku, veshur me ata shajakët e tij kafe, futi llullën në xhep, rregulloi qylahun në kokë. «Të dëgjojmë ç'na thotë xha Brahua» — thirri dikush. Plaku, kur i pa duart e tij të lira, s'dinte ç'të bënte me to e filloi të kryqëzonte gishtërinjtë para vetes dhe thirri, që ta dëgjonte populli: «O S. aga, të dëgjova ty dhe thashë: ka të drejtë agai. Dëgjova atë djalin dhe prapë thashë: ashtu është, edhe ai ka të drejtë...» «Po atëhere?! — thirri dikush. Xha Brahua një copë herë kryqëzoi gishtërinjtë e duarve para vetes. «Tani unë them kështu, o aga — tha plaku. — Gjithë jetën time të kam ardhur pas. Edhe më 1912, dhe më 1920, edhe më 1924... Gjithë jetën... E ç'fitova? Ja, siç më sheh edhe zotrote, jam po ai që më la babai ndjesë pas-



të. Po ai. Më sheh vetë zotrote. Tani dëgjova atë djalin këtu. Dhe po ta them, o aga: tafti-bafti, xha Brahua do të shkojë pas atyre çunave...»

Mbledhja gjëmoi. Ndonjë e shante, shumica e lavdëronte plakun. I vogël, i vogël, ai prapë u ul aty mbi tokë, në rreshtat e parë.

Kur e kishte parë në fillim të tundte atë kokë të vogël me tuçin pa qime e të thoshte: «ashtu është vërtet, aga,» Q.D. mendoi të thërriste një herë: pusho ti, plak, aty... S'je vetëm ti këtu... Dhe plakut i kishin thirrur burra e gra të tjera. Po ai në të tijën. Dëgjonte edhe partizanin, tundte kokën e thoshte: «edhe ti ke të drejtë, ashtu është».

Q.D. e kuptoi se plaku nuk kishte ndonjë mençuri të madhe. Shihte duart e kryqëzuara para vetes e gishtërinjtë i dukeshin si udhët e jetës, që i ngatërroheshin njëra me tjetrën. Nën ato rrugë të kryqëzuara duhej të ecte tani xha Brahua. Nga do t'ja mbante? Ato nuk shkonin gjëkund. Plaku sikur e ndjente atë, prandaj edhe ai qëndronte më këmbë para popullit. Heshtte e kryqëzonte duart e plakura...

Edhe tani, pas kaq e kaq kohe, Q.D. nuk e harronte dot atë plak. Në mbledhje në fshehta me popullin, me gratë, ajo u tregonte për xha Brahon. Ai nuk ishte kushedi ndonjë mendalok i madh. Jo, fshatar i thjeshtë. Duke dëgjuar aganë, ai i besonte atij e thoshte: «ashtu është...». Dhe duke dëgjuar partizanin, ai përsëri thoshte: «edhe kështu është...» Nga do t'ja mbante xha Brahua

me atë llullë të djegur shqope nër gishtërinjtë e vegjël e të trashë? Kur fliste S. agai, Q.D-es ju kujtuan ata oratorët, «udhëheqësit e kombit» në atë mbledhjen e sallës së Parisit. Ata atje u flisnin emigrantëve. Këtu S. agai i fliste vetë xha Brahos. Ç'do t'i përgjigjej ky? Plaku tha vetëm: «Gjithë jetën time, aga, pas teje kam shkuar. Ç'kam fituar? Asgjë. Ai që kam qenë, ai jam. Tani tafti-bafti... po shkoj pas çunave...». Gjithë ata që e dëgjuan e kuptuan se me gojën e atij plaku fliste vetë kjo tokë. Fjalët e tij ishin të thjeshta. Edhe logjika fare e thjeshtë. Veç, sa kohë, sa dhembje e gjak i ishte dashur vetë tokës që të arrinte aty: «...kësaj radhe me çunat».

Nisa të shfletoja libra kujtimesh mbi luftën tonë. Në to përshkruheshin kryesisht beteja. Për njerëzit flitej pak. Fare pak. Edhe në qoftë se diçka kujtohej, — përmendej vetëm sa për të ardhur e për t'u shkrirë pastaj në betejë, në përlëshjen «trup më trup».

Ndërsa mua më duheshin njerëzit, më duhej Q. D., dëshiroja ta ngjallja atë ashtu siç kishte qenë në ato ditë. Përlëshjet... betejat... ato janë të rëndësishme e të domosdoshme. . . po ato i kryejmë ti e unë, ai dhe ai tjetri. . . I kryejmë si një shpërthim të vetëvetes. Po cila ishte ajo «vetëvete» njerëzore? Cilët ishin ata njerëz, që i kishin zhvilluar ato beteja? Njëherë diku kisha lexuar «Ne mbetëm tre vetë. Njëri u vra. Pas betejës morëm copën e bukës që kishim dhe e ndamë më katërsh. Pjesën e shokut të vranë e lamë

mënjane... Po nuk na hahej. Shihnim atë kafshatë buke mbi borë dhe na dukej sikur edhe shoku i vrarë kishte uri. Atëherë njëri u ngrit, gërmoi pak në tokë dhe e mbuloi atje bukën e shokut të vrarë...» Ja njerëzit... — Ata që shkojnë nga një betejë në tjetrën.

Midis tyre unë kërkoja Q.D-en.

Drejtorit të shkollë 8-vjeçare diçka i dhimbte. Ai fliste e buzëqeshte, po cilido në vendin tim do të ndjente se edhe sot e kësaj dite atij njeriu diçka i dhimbte.

— As unë e as im vëlla nuk e kuptuam, përse ajo e bëri atë... Duke shëtitur nëpër bulevardin e «Portokalleve», unë mendoja që më pëlqente ai njeri me shtatin mesatar, me fytyrën e rrumbullakët e të mbushur, me ata dy sy të kthjellët e të pafajshëm, të pafuqishëm që të fshihnin atë që ai ndjente përbrenda. Isha i bindur se ato, që drejtori po m'i tregonte mua tani, ja kishte kallëzuar edhe të tjerëve. Dhe pastaj pendohej...

— Na la qengjin e pjekur në mes të sofrës dhe u ngrit e iku.

— Q.D.?

— Ajo. Vëllait të madh i mbeti luga në dorë, unë s'dija se ç'të bëja:

— Si ishte veshur ajo?

— Si ishte veshur... — drejtori buzëqeshi pa shikuar nga unë me ata dy sytë e tij të pafajshëm.

— Si gjithë gratë tona, një polkë, çitjane e shami të zezë në kokë.

Ashtu ishte veshur ajo edhe atë ditë, kur unë

e pashë të vrarë atje te xhamia. Po atje ajo ishte e vdekur, kurse ky e kishte parë të gjallë.

— Kishte armë?

— Jo. Vetëm një kobure të vogël në brez. Ata kishin ardhur një grup partizanësh. Do të ngrinin këshillin e frontit, thoshnin. Vëllai im më i madhi shkoi te dyqani, ku ishte mbledhur gjithë populli i fshatit. Atje e takoi edhe atë.

— Ata njiheshin?

— Vëllai më tha pastaj se ishin njohur jash-të shtetit. Mendo, sa u gëzua, kur e takoi. E ftoi për drekë. — Do të vish — i tha — patjetër do të vish tek unë. — Mirë — tha ajo. — Do të vij. — Unë vetë kërceva në shtëpi, i hoqa kokën qengjit dhe u thirra grave. Partizanja e parë do të vinte në shtëpinë tonë. Pastaj, se ç'ndodhi, dreqi e mori vesh. . .

Më pëlqente ai njeri. Nga gjithë ata, që unë i kisha pyetur, vetëm ai më fliste lirshëm për atë grua, më fliste si për një njeri të zakonshëm me të cilin edhe tani ai kishte disa llogari të pashlyera. Ajo i kishte hua diçka? Apo ky asaj? Drejtori më fliste për Q.D-en pa atë cipën e ftohtë, që vetë mendimi se bisedohet për një «të vdekur» e krijon midis nesh.

— Ajo erdhi, u përshëndosh me gjithë të shtëpisë. Me vëllain e madh u përqaftua. Unë fluturova nga gëzimi. Nuk kisha vëlla tjetër, vetëm atë kisha dhe dëshiroja që ai të ishte i gëzuar. Kishte bredhur, kishte parë botë. Dhe e shihja që në fshat me ne mërzitej shumë. Kur takoi atë grua, sa s'fluturoi prej gëzimit. Në shtëpi u shtrua mezeja dhe rakia. Nisën bisedat. Do të ngrihej kë-

shilli i fshatit dhe ajo e pyeste për çdo gjë. Fëmijët e kishin rrethuar partizanen, që luante e përkëdhelej me ta. Dhe përsëri pyeste vëllain për njerëzit e ndryshëm. Gratë shtruan drekën. I shtruan të gjitha ç'kishin gatuar njëherësh. Ne pandehëm se do ta kënaqim, kur ajo papritur u prish në fytyrë...

— Q.D.?

— Po.

— Ajo ishte e bukur?

— Ëh... — tha ai duke më parë me ata sytë e tij... — Grua — tha pastaj... — Grua, si grua...

Shihja lulet e portokalleve mbi mua, frymëmerrja aromën e tyre e mendoja se në kokën time përherë ishte ngritur ajo gruaja e re, me ata trëndafila të bardhë në dorë. E re, .. dhe nuk kisha menduar fare, që nga ajo ditë kur Q.D. kishte dalë në fotografi e gjersa unë e kisha parë të vrarë, — kishte rrjedhur kaq kohë.

— Ëh... grua, — tha drejtori i shkollës.

Mua m'u duk sikur ajo e rënë atje te xhamia e tabakëve, midis shiut dhe gjakut, u kthye sërish përmbys dhe unë nuk mundja ta shihja dot më. Ajo fytyrë e vogël pranë tufave të bardha të trëndafilave u tret, e vendin e saj e zuri një fytyrë tjetër, që nuk e përfytyroja dot.

— Ëh... grua...

— Ç'mund të fusja unë në ato dy fjalë? Në ato dy fjalë mund të qëndronte cilado grua me fytyrën e vet të zakonit. Ndofta dhe ajo ishte e tillë? Ndofta rastësisht në përfytyrimin tim ishte ngritur ai vizion i ëmbël e i ri femëror për të? Dhe pse duhej ajo të ishte e bukur? Ja ky njeri e kishte parë të gja-

llë dhe bukuria e saj nuk i kishte bërë asnjë përshlyetje.

— Ajo u prish në fytyrë, — tha drejtori — dhe si nëpër dhëmbë i tha tim vëllai: «Ç'është kjo drekë plutokrati?»

— Si? — pyeta unë përnjëherësh.

— Ashtu i tha. Vetë s'e kuptoja atë fjalë, po më vonë ma shpjegoi vëllai. Drekë plutokrati... Atë fjalë për herë të parë e dëgjova atje.

— Pastaj?

— Çfarë pastaj? Ajo u ngrit e iku. «Duhet me doemos të takoj një shok», — tha dhe iku. Ne ju lutëm të rrinte. S'ishte punë që bëhej. Sofra mbeti në shesh. E pyeta vëllain: pse e bëri ajo atë? As ai nuk e kuptonte dhe më pyeste mua: «Ëh, pse e bëri?»

— Drekë plutokrati... — mërmërita unë.

— Plutokrati — tha drejtori i shkollës.

— Nuk pranoj asnjë ilegal në shtëpinë time, tha i zoti i shtëpisë që brenda derës.

— Po ti hape njëherë!

— S'kam pse ta hap.

Ne mbetëm të heshtur në errësirën e natës. Gjithshka ishte mbuluar me borë dhe nëpër oboorin e shtëpisë shiheshin drurët e pemëve.

— Ne jemi ilegalë, — tha Q.D.

— Unë nuk pranoj njeri natën në shtëpinë time — tha i zoti i shtëpisë dhe e mbylli fare derën.

Nata ishte e errët, sa ne s'mund të shihnim dot njëri-tjetrin në sy.

— Ç'do të bëjmë? — pyeta unë.

— Unë e ngatërrova këtë punë — tha shoqëruesi. — Ngatërrova shtëpinë ku duhej të shkonim sonte. Po ju mos u shqetësoni, shokë, unë do t'ju çoj në një vend tjetër.

— Jo — tha Q.D. — Ne erdhëm këtu e këtu do të hyjmë.

Duke u kollur, ajo shkoi nën verandën e shtëpisë, pastroi një copë vend dhe u ul. Oborri ishte i gjerë, i mbushur me pemë të ndryshme që na fshihnin prej rrugës.

— Bëni, si të bëni... — na tha Q.D.

— Shoqe... — shoqëruesi ju drejtua asaj...

— Unë mund t'ju çoj në një bazë tjetër.

— Kjo shtëpi do të bëhet baza jonë — tha ajo.

— Ai është një maskara i tërë — i thashë unë për të zotin e shtëpisë. — Nuk e sheh? Nuk guxon të hapë as derën e tij... Frikacak.

— Ç'të bësh...

Në dritaren e shtëpisë u shua edhe drita e zbehtë e llambës së vajgurit. Sigurisht që ata brenda ranë të flinin. Ne ishim të lodhur e të këputur. Q.D. ishte e sëmurë. Gjithë ditën vetëm kishim udhëtuar, e s'kishim vënë asgjë në gojë. Kishim shpresuar se në darkë të paktën do të çlodheshim, kur jo...

— Unë e kam fajin — tha përsëri shoqëruesi.

— Ai ishte një djalë i ri dhe qëndronte përherë në këmbë, larg nesh, në mes të borës.

— Gjithshka mund të ndodhë. Hyrë këtu nën strehë!

— Borë nuk bie më.

— Nuk bie, po erë fryn.

Q.D. filloi të kollej dhe unë nëpër errësirë po dëgjoja kollën e rëndë të saj.

— Nuk ka kuptim të qëndrojmë këtu — i thashë.

— Ne nuk mund të kthehemi pas, ai duhet ta dijë.

— Ai është frikacak.

— Ai duhet ta dijë se ne, ku trokasim, atje hyjmë.

Shoqëruesi u mbështet te muri dhe unë shihja nëpër errësirë hijen e tij. Flisnim me zë fare të ulët, që të mos na dëgjonin në udhë. Po Q.D. ishte sëmurë dhe unë i thashë:

— Ti je e sëmurë. Këtu ne mund të vijmë edhe një herë tjetër.

Ajo nuk u përgjegj. Ndofta atë kohë po dremmitte. Edhe vetë mblodha kruspull gjunjët, mora kokën midis krahëve dhe u kota. Kur u zgjova, pashë prapë se te muri mbështetur nxinte hija e shoqëruesit. Sapo më ndjeu që lëvizta, ai më tha:

— Shokë, po unë ju çoj në një vend shumë të sigurt.

— Jooo... — u përgjegj Q.D. — Ne do të hyjmë këtu...

Atëherë e kuptova që ajo nuk po flinte. U xhindosa. Si na e mbylli derën në turinj, ai qelbash?

— Dëgjo, — i thashë asaj ngadalë — unë tani e shqyej atë derë...

— Marrëzira! Flini! Dhe ajo prapë u mbështoll në veten e vet.

— Nuk do ta harroj kurrë këtë — tha shoqëruesi. Tani ai erdhi dhe u ul me ne te shkallët e verandës.

— Flini — tha ajo duke u kollur.

Dremitëm. Kur u zgjova, unë e pashë atë që lëvizte lart e poshtë nëpër oborr. Për një çast nuk



e kuptova se ç'po bënte, por pastaj u përmbloodha. Ajo ecte nëpër oborr që të ngrohej. Moti ishte kthjelluar dhe në qiell dukeshin yjet. Dita e nesërme do të gdhinte e bukur dhe me diell. Shoqëruesin pranë meje e kishte zënë gjumi.

— Si je?

— U zgjove?

— Pse, fjeta shumë?

— Cazë.

— Ke akoma ethe?

— Kam — tha ajo. Dhe nisi përsëri të kollej duke lëvizur sa andej — këtej. Shkova tek ajo dhe fillova edhe unë të ecja nëpër borë.

— Sikur s'mjaftoi udhëtimi gjithë ditën.

— Ç't'i bësh...

— Ëh...

— Po ti thuaj diçka për të kaluar kohën — më tha ajo.

— Ç'të them?

— Diçka.

— Asgjë s'më thuhet tani — i thashë unë prerë.

— Ke të drejtë. Po ne s'mund të kthehemi prapa. Mendo sa ilegalë trokasin tani para dyerve të mbyllura. Si mund të kthehen ata pas?

U zgjua edhe shoqëruesi. Edhe ai u afrua te ne e filloi të lëvizte për t'u ngrohur.

— Shokë, — tha pastaj — po agon... ç'do të bëjmë?

Atëhere ne u kujtuam se me të vërtetë nga lindja agimi po zbardhte majat e maleve.

— Ç'do bëjmë? — i thashë unë atëhere Q.D-es.

Ajo vazhdonte të lëvizte lart e poshtë dhe shihte ditën që po agonte. Atë çast dera e shtëpisë u hap.

— Juuu?! — i zoti i shtëpisë mbeti i shtangur te praku. — Juuu... gjithë natën këtu?

— Ne s'kthehemi pas, — tha Q.D. — Atje ku trokasim, atje hyjmë. Ne nuk jemi hajdutë, po luftëtarë lirie...

Njeriu, brenda derës së vet, na shikonte i shastisur.

— Gjithë natën këtu? — tha përsëri, sikur s'u besonte syve të tij.

Ne s'u përgjegjëm. As i zoti i shtëpisë nuk foli më. Qëndroi edhe ca kohë duke na parë në heshtje dhe u fut brenda. Derën pas e la të hapët. Njëri pas tjetrit ne hymë në shtëpi.

*«Ju, që me bukë e pa bukë, mbathur e zbatthur, trimërisht keni qëndruar para çdo vështirësie; ju, që me vendosmërinë tuaj i keni ngjallur besimin popullit, i keni dhënë fjalën se do të derdhni gjakun për të — mbajeni këtë fjalë, vdisni dhe jepni popullit lirinë...»*

— Kujdes!

Q.D. zgjati trupin e saj përpara e nga gryka e ngushtë e shpellës nisi të tërhiqte lart nusen shtatzanë. Duke rënkuar, e sëmura u kacavir midis shkëmbenjve e këmbadoras rrëshqiti nëpër hyrjen e ngushtë të shpellës. Një çast të dyja gratë qëndruan aty të palëvizura. Në thellësi shtrihej errësira e lagët dhe e ftohtë, kurse aty te gryka mezi hynte firoma e dobët e mbrëmjes.

— Këtu-tha Q.D. — s'kemi ku shkojmë më.

Tjetra nuk u përgjegj fare. Ajo eci disa hapa

dhe, duke u përkulur e tëra, u mbështet te një damar shkëmbor, që i doli përpara. Aty shtatzëna u lëshua pa fuqi në tokë.

— Nënë... — rënkoj ajo.

Brenda në shpellë gjëmimi i artilerisë gjermane vinte më i largët e më i mbytur. Q.D. filloi të zinte grykën e shpellës me gurë. Disa herë ajo doli jashtë për të kërkuar e për të mbledhur shkëmbenjtë, që do ta bënin të padukshme atë vrimëz mali. Pastaj filloi ta mbyllte me kujdes. E sëmura ishte mbështetur te damari shkëmbor, që shkonte tutje nëpër sheshin e shpellës.

— Nënë... ku më gjeti tani...

Q.D. u kthye tek ajo. Fshiu e pastroi tokën nga gurët dhe e ngriti nusen ngadalë, e tërhoqi poshtë dhe e vendosi lirshëm në vendin e pastruar. Vetë ajo qëndroi në këmbë mbi të. Nga gryka e shpellës nuk hynte asnjë dritë. Muri i trashë me gurë mali e kishte zënë krejt. Sytë filluan disi t'u mësoheshin në errësirë. Dukej që përbrenda ajo ishte një shpellë e thellë. Gruaja e kuptoi këtë edhe nga ajri i ftohtë që ju ngjiti menjëherë në fytyrë. Një e dridhur i kaloi nëpër trup. Mendimi i thellësisë së panjohur të asaj shpelle, në të cilën papritur ishin futur, e frikësoi. Q.D. po rrinte ashtu, kur ndjeu te këmbët e veta shtatzënë, që rrotullohej sa andej-këtej. Frymëmarrja e saj ishte bërë më e rëndë.

— Duro...

Ato ishin takuar rastësisht në udhë. Q.D. ishte nisur për në shpellën e madhe të Boderrit, ku tani ishte fshehur një pjesë e popullit të fshatit. Në mes të pyllit takoi atë nuse, që ishte shtrirë në tokë e

nuk ecte dot. E kishin zënë të prerat. Q.D. nuk mund ta linte atë vetëm në mes të pyllit dhe të natës. që po binte në mes të armiqve. E tërhoqi si munda, gjersa gjeti atë shpellë.

— Duro... jemi bashkë... — i tha ajo nuses, që përpëlitej e rënkonte.

Vetë Q.D. nuk lindte. Në fillim ishte trishtuar shumë. Kishte qenë vajzë e vetme e s'kishte njeri të afërt. Një djalë... një çupë... Po tani ai trishtim ishte fashitur. Ç't'i bësh? Nuk lind, nuk lind. Ky mendim me kohë u shkri në të e zuri vend në ndërgjegjen e saj. Dhe asaj as që i shkonte ndër mend se ndonjëherë do të lindte fëmijë. Po ja, tani, aty nën të, mbi tokën e ftohtë, një tjetër përpëlitej. Nga dhembjet e lindjes mendoj Q.D. Gratë thoshin se ato dhembje ishin të egra, të tmerrshme. E përsëri ato, gratë, vetë pillnin. Q.D. nuk i kishite provuar kurrë ato dhembje. Ajo nuk dinte si lindej. Kurse tani duhej të ndihmonte atë tjetrën.

— Duro, ti më ke mua...

Gruaja e ndjeu se nuk ishin tamam ato fjalët, që duhej t'i thoshte tani shtatzanës. Po ajo ashtu i tha:

— Nuk je vetëm... jemi bashkë...

Vetë nuk i kishte ndjerë kurrë dhembjet e nënës. As gëzimet e nënës. Kurse ajo tjetra...

«Komanda gjermane vuri në gatishmëri regjimentin 92 të granatierëve, batalionin 48 special të këmbësisë, disa nënreparte të artilerisë tokësore e speciale të përqëndruara në Vlorë, në Kaninë, Pen-

kovë, Mavrovë, dhe në Dukat; reparte të divizionit 100 malor në Fier dhe një divizion këmbësorie të përqëndruar në rajonin e Janinës. Veç këtyre, gjatë ofensivës, morën pjesë regjimentet 522, 523, 524, të inkuadruara në divizionin 587 të këmbësorisë. Bashkë me këto forca morën pjesë edhe forca të tjera të korpusit 22, që kishin vepruar në Shqipërinë e Mesme dhe të Veriut, si dhe tradhëtarë e ballistë të vendit. . . »

Q.D. u afrua pranë së sëmures.

— Çfarë e do, djalë apo çupë? — i pëshpëriti asaj ledhatonjëse në vesh. Tjetra rënkoi e tha vetëm:

— Ah, nënë. . . ku më gjeti në këtë kohë!..

— Duro. . . mos gërthit. . . është natë e ngado ka gjermanë. . .

Jashtë kishte rënë nata. Pranë nuses, që rënkonte, Q.D. dëgjonte uturimën e largët të artilerisë armike. Herë — herë ajo ndërpritej, po pastaj përsëri fillonte më e dendur dhe më e afërt. Gruaja e kuptonte se nazistët e rrihnin me gjyle gjithë masivin e malit mbi të. U kujtua se në shpellë ishte ftohtë. Sigurisht që më ftohtë duhej të kishte ajo tjetra. Shtrirë e tëra në tokë. . . Q.D. provoi me dorë dheun përposh. Ai ishte i thatë. Mbjati vesh e nuk dëgjoi të pikonte gjëkund. «Shyqyr», murmuriti me vete, «shpella qenka e thatë».

— S'kemi me se të ndezim zjarr — tha ajo.

Shtatzëna s'u përgjegj. Vetëm rënkonte e pëshpëriste nëpër buzë: «O tokë! sa më shpejt. . . sa më shpejt. . . »

«Sa më shpejt», murmuriti me vete edhe Q.D. Po ajo ndjeu se kishte frikë nga ai çast fare i panjohur për të. Dhe prapë ajo pëshpëriti: «sa më shpejt»...

— Uuuu...

Ai ishte një vajtim i egër e i dhimbshëm shtaze, një ulërimë ngjethëse, e neveritshme, e frikshme. Dhe vinte aq pranë. Grave ju pre firoma. Heshtnia e s'flisnin dot. Ajo thirrje e neveritshme sikur doli papritur nga dheu.

— Uuuuu... . .

U dëgjua përsëri ulërima nëpër natë.

— Ulkonja...

— Ç'farë? — Q.D. u përkul mbi shtatzënë që foli.

— Ulkonja — tha përsëri ajo me një fije zëri.

Q.D-es ju duk se ashtu foli një i vdekur. Zëri i nuses ishte i akullt e i këputur, pa jetë. Ç'ishte ajo ulkonjë dhe ku ulurinte ashtu? Pse qante ajo nëpër atë natë?! Artileria naziste s'pushonte së rrahuri malin ngado. Po tani gjëmimi i topave, herë pas herë vinte aty i përzier me atë ulërimë ngjethëse, lëngonjëse, që herë ikte e largohej, herë vinte e qante pranë grykës së shpellës. Dhe përsëri largohej e humbiste tutje nëpër natë. Q.D. u ngrit. Duke shkelur, si nëpër ëndërr, shkoi te gryka e shpellës. Mbajti vesh. Ju duk sikur jashtë dëgjoi edhe të ecurën e bishës. Zemra i gufoi në kraharor. Filloi të kërkonte gurë andej e këtej. Gryka e shpellës ishte e zënë, po ajo përsëri hidhte gurë. Dhe mbante vesh. Asgjë. Përjashta askush s'dëgjohej. Gruaja hodhi gurë të tjerë, kur përnjëherësh u dëgjua po ajo ulërimë e egër...

Kësaj radhe bisha qante aty te gryka e shpellës së tyre. Gjëmimi i artilerisë vinte më i mbytur. Q.D. u kthye te shtatzëna.

— Do të ikë... — i tha.

Të dyja gratë e kuptuan që kishin rënë në një strofull ujqish.

«Duke krijuar një epërsi të madhe si në numër, ashtu edhe në teknikë luftarake, forcat gjermane pas përpjekjesh të vazhdueshme ditë e natë, të tëra, me humbje të rënda, mundën të përparonin gjatë luginës së Shushicës për në Kuç, si dhe nga drejtimi i Borshit për në Kuç. Në këtë situatë të vështirë forcat partizane e shkëputën kontaktin me armikun...»

Uhuhuu... Uhuhuu... Uhuhuu...

Qetësia e natës e përhapte atë ulërimë ngado. Dhe nazistët mund të vinin çdo çast në përgjim të ulkonjës. Gruaja zgjati dorën, e, nëpër errësi, preku ballin e nuses, që ishte platitur e tëra. Edhe ajo parandjente rrezikun e madh. Në ato çaste vetiu nëpër mend të Q.D-es po kalonin gjithshka kishte parë e pësuar gjatë atij operacioni të egër nazist.

...Mitrალიeri partizan pranë saj qëllonte e shante nëpër dhëmbë. Gruaja i hodhi atij një shikim. Ai kishte veshur një bluzë të leshtë të bar-

dhë, me grykëse në qafë. Ishte gjithë rripa ngjeshur në trup. Fjalët e tij gruaja s'i kuptonte dot. Gjëmonte ngado. Ajrin e prisnin fishkëllima therëse plumbash. Lufta vazhdonte me furi nga të dyja anët, kur Q.D-en e thirrën dhe e urdhëruan të nisej sa më shpejt në spitalin partizan. Operacioni i madh nazist kishte filluar.

Uhuuu... uhuuu... ulërinte ulkonja jashtë.

«...Digjet» — kishte thënë partizani me kokën mbuluar gjithë fasha të gjakosura. Ai kishte qëndruar një çast më këmbë atje në qafë të malit dhe, si i kishte hedhur një shikim tejendane luginës, kishte thënë: «Digjet...». Spitali partizan po tërhiqej në mal. Të plagosur etë sëmurë, duke u mbajtur te njëri-tjetri, duke u mbështetur mbi pushkët e gjata apo mbi hunj e stape, ngadalë i ngjiteshin së përpjetës. «Digjet...» — dëgjuan ata edhe një herë shokun e tyre pas. Dhe qëndruan. Prej andej të gjithë hodhën shikimin nëpër atë brez toke të rrethuar nga male të ashpra. Vende-vende shiheshin gufimet e tymit të artilerisë, që qëllonte pa ndërprerje. Diku poshtë vezullonin zjarre mitralozi. Pastaj shuheshin. Të plagosurit morën prapë udhën e tyre. Partizani, që kishte folur ishte truplartë e nga fashat e përgjakura në kokë dukej akoma më i madh. Në duar mbante një maliher. Gjerdanin e kishte mbushur me fishekë. Q.D. shikonte atë partizan të plagosur tek i ngjitej malit dhe i kujtohej ajo kra-hina e dikurshme, e heshtur e gati e vdekur. Atëherë njeriu do të kishte menduar sikur në atë vend vetëm terrori i Zogut ishte i përjetshëm. Vetëm terrori i Zogut e asgjë tjetër. Dhe mbi këtë tokë mund të mbilleshin vetëm farë të frikës, të shtypjes. Dhe



mund të mbinin vetëm lule të poshtërimit e të mje-  
rimit njerëzor. Ato lule të zbeta jeta i mbante këtu  
nër duar prej lindjes e gjer në vdekje. Të tjera lule  
ky vend s'mund të rritte. Kështu do të kishte men-  
duar kushdo, që do ta shihte atëhere. Atëhere... Po  
nuk kishte kaluar veçse fare pak kohë, fare pak...  
dhe ja... shpirti i kësaj toke kishte marrë zjarr...  
Kush do ta kishte besuar? «Digjet» — pati thënë  
partizani trupmadh me kryet e mbuluar me fasha  
të përgjakura. «Digjet» — kishte thënë ai për ve-  
të atë tokë...

— Ulkonja do t'i sjellë ata këtu — tha më në  
fund shtatzana me një fije zëri.

Q.D. nuk u përgjegj. Pëllëmbën e dorës e  
mbante mbi ballin e nuses. Dhe nuk lëvizte. Ku nuk  
e çonte mendimin e grave ajo ulërimë e frikshme,  
ngjethëse e ulkonjës. Q.D-es ju kujtua Qafa e Bo-  
zhekut. Frynte e derdhte nga të katër anët. E gjë-  
monte. E bubullinte. Ato ishin vetëm një grusht  
gra. Iknin. Vetëm t'i shpëtonin terrorit të nazistë-  
ve. Gratë e fëmija i ngjiteshin malit nëpër shtrën-  
gatë. Kur mbi ta shkrepin. Rrufeja qëllon. Kurr-  
kush s'mori vesh se ç'ndodhi. U duk sikur lart qiejt  
u hapën. Sa mblodhën veten, panë që rrufeja kishte  
goditur një grua. Gruaja kishte rënë e vdekur, e nxi-  
rë mbi tokë, kurse foshnja e vogël qante e klithte  
në djepin e drunjtë. Foshnja kishte mbetur e gja-  
llë. Fëmija qante e lebetitej. Atë e morën me vete.  
Të vdekurën e lanë aty. Të nesërmen erdhën e e  
varrosën.

Uhuuu... Uhuuu... Uhuuu...

Ulërinte ulkonja jashtë. Ai vajtim i saj shkon-

te e përzjehej me gjëmimin e mbytur, të pandërprerë të artilerisë naziste. Pse nuk po ikte bisha? Tashmë ajo e dinte që nuk hynte dot në shpellën e mbyllur me gurë. E vazhdonte të vërtitej aty rreth e rrotull e të ulërinte me atë zërin e saj të egër e te neveritshëm.

— Nuk do të ikë.

— Ti mos ki frikë... ne jemi të dyja...

Q.D. ndjente se si tashmë gjithshka po mbështillej në atë ulërimën e ulkonjës që qante. Edhe mendimet e kujtimet e saj mbështilleshin në atë ulërimë, që i avitej pranë. Dhe ajo e shihte veten në Mal të Çipinit, në një shpellë të madhe, ku ishin fshehur gra e fëmijë. Rreth e rrotull binin gjylet e artilerisë. Goditnin e thyenin lisat e pyllit. Nën një lis gjylja kishte vlarë tetë partizanë të plagosur të spitalit. Partizanët po pushonin aty, kur predhara, u përplas në trung e shpërtheu. Gratë shkuan e i varrosën të vlarët në bokërina. Pastaj u kthyen përsëri në shpellë. Fëmijë e gra u mblodhën pranë njëri-tjetrit. Ftohtë. Rrinin gratë e shikonin se si ulur në bisht, te hyrja qëndronte një fshatar. I panjohur. I heshtur.

— Si ja çoni, moj gra? — foli më në fund ai.

— Ja çojmë... — u përgjegj njëra.

Fshatari s'foli më. Vetëm shikonte ato. E pastaj fëmijët. E përsëri shikonte gratë.

— Sa keni që s'keni ngrënë? — pyeti fshatari.

Ato s'u përgjegjën.

— Merrni dhinë, merrni e i therni... — tha fshatari. — Unë i prura gjer këtu me kokën në trastë. Thashë t'i shpëtoja nga kjo luftë. Dhe i solla gjer këtu. Po merrni e therni... — Ngadalë ai u

ngrit e iku. Gratë qëndruan në vend. Fshatari zbris-  
te poshtë malin pa kthyer kryet pas. Andej lufto-  
hej. Gratë shikuan njëra-tjetrën në sy. Dhitë ishin  
përhapur aty nëpër pyll. Kullotnin. Po kush mund  
t'i therte? Atëhere doli njëra. Mori thikën e madhe  
në dorë e tha:

— Ejani...

Gjysma-gjysma ato e ropën cjamin e kuq.

Nëpër atë ulërimë të egër të ulkonjës frynte  
erë e fortë. Partizanët ishin të lodhur e të këputur.  
Kishin udhëtuar ditën e natën. Dhe ditë e net në  
përleshje. Sulme e kundërsulme. Ashtu çanin udhën  
e tyre. Lufta zhvillohej në atë luginë po me atë  
fytyrë e po me ato ligje, që zhvillohej në kontinen-  
te të tëra: po dimensionet e saj të mëdha, ndërko-  
mbëtare e bënin atë më të egër e më të paduruesh-  
me brenda atyre caqeve të ngushta e shkëmbore  
të asaj krahine të vogël. Partizanët, shtrirë mbi  
borë, të lodhur e të këputur, dëgjonin komisarët  
që flisnin. Mbi një shkëmb, me duar ndër xhepë  
të xhaketës, qëndroi Q.D. Mendimi i saj përnjëhe-  
rësh shkoi te komunarët dhe ajo u thirri partiza-  
nëve: «Kujtoni komunarët! Ata sulmonin qiellin.  
Edhe ne po sulmojmë qiellin. Jemi të lodhur, po  
edhe nazistët janë të lodhur. Kjo tokë është jona.  
Çdo gur e çdo dru na njeh, kurse ata janë të huaj...  
Kujtoni komunarët e mos harroni kurrë se gjaku  
juaj tani bashkohet e bëhet një me gjakun e tyre...!»

Një zë i hollë, i panjohur, çau errësirën e shpe-  
llës. Q.D. shtangu. U mblodh e tëra aty. Ishte klith-  
ma e parë e atij, që lindte. Mendja e saj fluturonte  
tej, kurse ai aty lindte.

— Kujdes kërthizën...

U dëgjua të thoshte zëri i këputur i lehonës. Instinktivisht duart e gruas u shtrinë andej nga vinte ajo klithje njerëzore. Duart shtriheshin ngadalë, lehtë, të friksuara, sepse e ndjenin që do të preknin diçka, që s'e kishin kapur tjetër herë. Diçka të brishtë, të njomë, të gëzueshme e të panjohur. Duart shtriheshin e qëndronin në errësirë dhe nuk i afroreshin dot asaj klithjeje. Thua sikur vetë ai zë i trembte dhe donte t'i largonte, t'i shtynte, si era krahët e një fluturë. Ngadalë ajo preku brumin e ngrohtë të atij mishi njerëzor. Duke e mbështjellë me pëllëmbët e veta, u përkul e tëra mbi të. Foshnja klithi. Q.D. e vendosi në prehrin e vet. S'dinte ç'të bënte më tej.

— Lidhi kërthizën!

Q.D. as që e kuptoi se ç'po bënte. Duart dridheshin. Ato punonin. Q.D. e ndjente që ato s'i bindeshin më asaj, po dikujt tjetër. Duart e përgjakura punonin mekanikisht. «Lidhi kërthizën!»

Uhuuu... Uhuuu... Uhuuuu...

U dëgjua përsëri ulkonja aty te gryka e shpellës. Ajo ulërimë ishte më e egra dhe më e dhembshme nga të gjitha. Bisha s'donte e s'donte të ikte. Siç dukej, ajo nuk do të largohej prej andej. Q.D. ngriti foshujen në duar dhe ja dha së ëmës.

— Na — i tha.

— Çfarë?

— Mbaje... të qetësohet...

Kur tjetra e mori të porsalindurin në duart e saj, gruaja ndjeu një çlirim dhe një zbrazëtim të menjëhershme. Dridhej e tëra. Një dhembje e madhe i kaploi trupin. Fuqitë e kishin lënë. Ulërima e ulkonjës e gjëmimi i topave të artilerisë gjërma-

ne nuk e ngacmonin më. Tashmë gjithshka ishte larg e nuk i përkiste më asaj. Aty pranë lehonës u shtri edhe ajo vetë në tokë e dëgjonte të qarët e foshnjës, që s'po pushonte. Zëri i tij ishte i zakonshëm. Foshnja sikur qante për veten e vet. Q.D. ndjeu se si dhe kujtimet e atij operacioni të egër nazist u daravitën larg dhe, më në fund, ajo mbeti vetëm e me veten e saj. Q.D. u shtri aty bri lehonës. Toka ishte e ftohtë e brinjët ju vranë nër guriçka. Ajo u ngrit e filloi të pastronte vendin. Atëhere ndjeu se nëpër duart e saj u fut diçka e gjallë, e lëvizshme dhe e ngrohtë. Duke kërcyer, hija i rrëshqiti nëpër duar dhe u zhduk nga gryka e shpellës. Pastaj edhe një tjetër edhe një tjetër. Me duar gjysmë të hapura në errësirë Q.D. shtangu në vend.

Duke larguar gurët, ajo kishte prekur një diçka të gjallë e të ngrohtë. Nëpër errësirë shihte se si ato hije të vogla hidheshin e kacavireshin te gryka e shpellës. Këlyshët e ulkonjës. Tani te gryka e shpellës ata po kërkonin të dilnin jashtë, ku qante e ulërinte e ëma. Ja, pse bisha nuk ishte larguar prej andej. Gruaja s'po dinte ç'të bënte.

Uhuuu... Uhuuu... Uhuuu...

Ulërinte ulkonja jashtë.

Q.D. ngadalë shkoi te gryka e shpellës. Tri hijet kacavireshin; i futeshin nëpër këmbë, kërkonin ndonjë të çarë midis gurëve. Ajo u ul të kapte një, po ai i shpëtoi. Qëndroi ashtu në këmbë duke parë ato hije të vogla se si hidheshin pupthi para saj. Ulkonja s'kishte për të ikur që andej. Ajo kishte këlyshët e vet aty. Rreziku se nazistët e ballistët mund të vinin çdo çast ishte i madh. Aty ishin dy

gra mes atij terrori. «Dy gra dhe dikush tjetër»... , mendoj ajo. «Dikush tjetër.» Dhe ulkonja ishte nënë. Edhe ajo donte të mbronte këlyshët e vet. Dhe kurrën e kurrës nuk do të largohej prej andej. Q.D. filloi të hiqte disa gurë të vegjël. Një nga një. Hapi një vrimë. Njëpër errësirë e zgjati dorën. Përsëri këlyshi i vogël shkau e iku tutje. Po ajo përsëri mori ta kapte. E mbërtheu prej koke dhe e tërhoqi, pastaj e futi në vrimën e hapur. Dhe mbajti vesh. Jashtë dëgjoi të ecurën e ulkonjës. Ishte një e ecur e shqetësuar. Gruaja kapi këlyshin e dytë. Edhe të tretin. Dhe qëndroi ashtu. Asgjë s'u dëgjua. Asgjë. Q.D. nuk u largua prej andej, s'kishte fuqi. U ul atje pas murit të grumbullit të gurëve.

Uhuuuu... Uhuuu... Uhuuu...

U dëgjua përsëri ulërima e ulkonjës. Po ajo sikur ishte një ulërimë tjetër. Gjëmimi i topave naziste ishte po ai, i përershëm e i pandryshueshëm, kurse ulërima e ulkonjës sa shkonte e bëhej më e largët. Bisha po ikte njëpër atë natë, duke marrë me vete këlyshët e saj. Q.D. rrinte aty te gryka e shpellës. Rrinte e dëgjonte dhe me mendjen e saj ndiqte bishën njëpër atë luftë e njëpër atë natë të ftohtë. Ajo vetë nuk kishte lindur fëmijë. Po ishte femër. E, si femër, në ato çaste ndjente diçka të dhimbshme, të ngrohtë, diçka që s'e shpjegonte dot, por që e ndjente. Lehona e ulkonja ishin nëna, të dyja. Dhe, si nëna, njëpër luftë mbronin pjellat e tyre.

M'u kujtuan fijet e holla të hekurave, që shpeshherë lidhin skeletet e statujave. Njeriut të thjeshtë as që i shkon njëpër mend, po ato fije hekuri qëndrojnë brenda shtatores. M'u kujtuan ato dhe

në përfytyrimin tim unë pashë një pikëçuditëse të vërtetë, në të cilën mbahej e qëndronte fytyra e hequr, e zbetë, me dy sy të çiltër e njeriut, që ishte ulur shesh mbi gjelbërimin e barit të parkut.

— Rini! — tha ai dhe më ra shputa në shpatull. — Rini... luftuam në, ti po e trashëgon...

Në sytë e tij në çast vezulloi dhe u shua një dritëz dhe unë, duke buzëqeshur, mendova me vete se ai njeri, siç dukej po ma dhuronte luftën e tij, si një copë bukë. Shiko! Papritur e pakujtuar i paskam dalë përpara, ja paskam kërkuar, dhe ai, me shpirtgjerësinë e vet, atë çast po ma falte atë.

Nuk e pyeta se ç'ishte e ku punonte. Doja vetëm të dija mbi Q.D-en. Më kishin thënë se edhe ai e kishte pasë njohur. Po ai nisi menjëherë të më fliste për vete se kishte qenë këtu e aty, kishte bërë këtë e atë.

Një tufë rabecka u ulën mbi gjelbërimin e barit, pak larg nesh. Njeriu që bisedonte me mua uli zërin, nisi të kërkonte në tokë dhe, si gjeti një gur, hapi krahun e qëlloi. ... Donte të vriste rabeckat. Unë mendova të largohesha prej andej. Ajo fytyrë e hequr, e zbetë, që sikur qëndronte mbi një pikëçuditëse më shtynte e më largonte prej atij njeriu. Po edhe ai mund të dinte diçka për atë grua, edhe ai mund të mbante diçka nga lufta e saj dhe unë nuk duhej t'ja lija atij njeriu. Ajo luftë nuk i përkiste vetëm atij, na përkiste neve të gjithëve, u përkiste kohëve të ardhshme.

— E keni njohur Q.D-en? — e pyeta edhe një herë.

Ai vazhdonte të më tregonte përsëri për veten. Në një përleshje ishte kacafytur trup me trup

me një gjerman, e kishte vënë poshtë nazistin dhe e kishte kafshuar në zverk.

— Nuk e kuptoja se cilën haja: borën, apo qafën e gjermanit... gjithshka ishte përzjerë në gojën time.

— Q.D. ishte në atë përleshje?

— Ishte, sepse më kujtohet që një partizan po luftonte në fushë të hapur dhe ajo gjeti një gur dhe shkoi e ja vuri te koka. — Ruaju — i tha — kështu mund të vritesh... Rini, — më thirri ai prapë dhe më ra në shpatulla. — Luftuam ne...

— Atëhere ajo ishte përleshja jonë — i thashë unë, e duke u ngritur i rraha shpatullat nga pas. — Ajo ishte përleshja jonë dhe unë e mora prej teje.

Ai më pa në sy i habitur. **Pikëçuditësja** sikur ngriu e tëra brenda tij. Njeriu nuk po më kuptonte.

— Ajo luftë ishte edhe jona — i thashë unë prapë — dhe tani unë e mora prej teje.

Në degëzën e buzëve të mia qëndroi nënqeshja e ato u drodhën nga pesha e lehtë e saj, si dridhen fletët e trëndafilin nga pesha e një fluturë. Vështroja njeriun që, me gishtërinj të gjatë, të tultë, me cipë të lëmuar, goditte mbi tavolinë e fliste duke rokullyer me fjalët e tij mbi mua, gurë bojë kafë, gri, të zinj, njerëz të uritur e me barkun petë, me nga një qind krye në trupin e tyre; ditë të pista me nga një sy dritare në ballë; sokakë me peshkun e kurrizit të thyer keq, që rrëshqisnin zvarrë nëpër trupin e qytetit dhe që qëndronin përherë po atje: mbremje të lëngshme, që binin si luspa rrëshqanthe gjigant, mbi kodrat përreth, mbi dëtin kudo që



hante syri njerëzor. Në gojën e atij njeriu qyteti i fëminisë së dikurshme qante, çirrej, klithte e shkulte faqet, leshrat e kokës, aty para meje. «Kështu duhet të shkruash ti,» thoshte ai herë pas here, po në buzët e mia nënqeshja hapte krahët e vet të butë e fërfëllinte, e unë serioz dëgjoja atë njeri, që me gishtërinjtë e tij të gjatë e të lëmuar goditte mbi tavolinë e fliste qëruar, kujdesshëm, duke kërkuar çdo fjalë, po brenda, diku në trutë e tij ndodhte kasaphana e llahtarshme e fjalëve, që thereshin si delet, si lopët, si buajt e dhjamuar. Fjalët e therura pëllitnin të tmeruara, e nga goja e atij njeriu rridhte gjaku i trazuar i tyre: gjaku i shkëmbenjve i bëlyrur krejt, ai i ditëve ngjyrë finje, i zi e i piksur, gjaku i Çeço Arapit, i lëngshëm e bullëndër i lagjes së Çerekçisë, i gjelbër gjaku i bordellos, që ne e kishim patur mu në lagjen tonë, në shtëpinë e Eldës.

Ishim të dy nga i njëjti qytet e kishim pothuajse një moshë. Dikur të dy kishim luajtur me top në fushën e lagjes sonë dhe mua, sa e pashë, m'u kujtua ajo koka e tij e mbuluar me leshrat e dendura e të zeza. Mendova se mos edhe ai do ta kishte parë Q.D-en të vrarë e ndofta diçka do t'i kujtohej edhe atij. Vërtet, si e parafytyronte sot atë ditë prilli '944 një moshatari im? Si e kujtonte dhe si e shih-te ai atë grua tani?

— Jo — më tha mua njeriu me lëkurë të verdhë e të lëmuar në gishtrinjtë e gjatë e të tultë — asaj dite nuk binte shi i hollë, si thua ti, po, mua më kujtohet mirë, atë ditë vetë qiejt qanin, si kafshë të rrahura keq e nga sytë e tyre në tokë binin gjarpërinj të çuditshëm shirash dhe erërash, vërshonin poshtë e duke fërshëlyer e uluritur godisnin me bishtat e fuqishëm udhët e ngushta të qytetit e, «kë-

shtu duhet të shkruash ti», rrihnin shtëpitë e ulëta, që nga dhembja mblidheshin kruspull, përdridheshin, u thyheshin kockat e mbeteshin përjetë uloke. Gjarpërinjtë e shirave e të erërave fluturonin përmbi qytet, fëshkëllenin e të lëngshëm e tronditës rrëshqisnin pastaj nëpër qyngjet e ulluqeve, që me gulçima i thëthinin nëpër thellësira të errëta të tokës. Kurse prej toke dilnin tufa shushunjash, që nxinin nëpër gurë, nëpër praqe, nëpër trarë e veranda të shtëpive, nëpër vatra e tavane dhe hynin brenda vrimave të hundës së qytetit dhe si një tapë mishtore e piksur të zinin frymën. Nga deti dilte një përbindësh, në kurrizin e të cilit dallgët e akrruara ngrinin në çast, si luspa të mprehta helmuese. Përbindshi i sullej qytetit tonë të vogël . .

Përsëri nënqeshja u drodh tek unë dhe, duke u druajtur se mos e fyeja atë njeri, ngadalë shkova dorën te cepi i buzëve, kërkova ta kapja e ta hidhja tej, po nënqeshja qëndronte e qëndronte aty. «S'kam ç'të bëj. . .», mendova me vete.

— Ti — më thoshte ai mua — nuk e ke parë mirë atë ditë, ose ty nuk të kujtohet sot taman se si ka qenë ahëre. Po ti duhet të shkruash se edhe tani e sheh qytetin brenda breshkores së vet. Brenda breshkores? Ndofta duhet thënë brenda lëkurës me gjemba të egërsuar iriçi. Me duart e mia unë e shqyej dhe e hap atë lëkurë dhe e shoh se si lëkundern nga rrënjët shtëpitë e vogla, me themele të thyera, me nga një dritare-sy, në mesin e ballit lëkundern e afrohen pranë njëra-tjetrës dhe nga ato dritare dalin jashtë gratë, shkulin faqet e me zë të ulët mos i dëgjojnë armiqtë i flasin shoqja-shoqes: Korba ç'na gjeti! E dëgjuat? Borua e shkëmbeka natën gruan e tij me qeraxhinë. . . Ai i jep të tijën,

ky të vetën, Erdhi fundi i dynjasë. Vetëm plaku Sulo Tami ecën nëpër ato ditë, ashtu si dhe ditëve të tjera, i qetë, me bastun në dorë duke trokitur mbi gurët e kalldrëmeve. Sheh gratë nëpër dritare dhe u thërret: mbylleni, kuçka, hyni brenda, he-laqe, se ndohtët qytetin me gojën tuaj. Dhe ato i përgjigjen: plak matuf, ç'ecën ashtu rrugëve me kurrizin përpjetë, nuk e sheh se përmbysja po vjen? Ato ditë, tha ai, bien e përhapen mbi qytetin tonë, si pika e bojës së mellanit në një letër të keqe.

— Po a mbaruan ato rreshje rrëshqanore shirash? — e pyeta atë.

— Kaloi ca kohë. . .

— Dhe doli dielli?

— Doli. . . po qielli pas atyre rreshjeve ishte tullac e me lëkurë të lëpirë në tuçin ku i kishin rënë flokët, «kështu duhet të shkruash ti».

Si e shihte ky njeri fëmininë e vet? Prej ç'materiali ishin ngritur brenda tij ato ditë, ato udhë, ato shtëpi, ata njerëz, ato fjalë, që ai vërtitte mbi mua? Më dukej sikur gjithshka tek ai njeri ishte ndërtuar prej suvaje të lagur e të mykur nga igrasia. Sapo e prekje me dorë dhe gjithshka shkërmoqej e prishej, shkërmoqeshin udhët, shtëpitë, gurët, shkërmoqej fëminia e tij. . . Më erdhi keq për atë njeri.

— Po nuk ka qenë ashtu — i thashë.

— Të duket ty — më tha ai mua. — Edhe shikimet e njerëzve u ngjajnë peshqve: ato e hanë njëra-tjetrën. Edhe fjalët shembëllejné me peshqit; fjalla e madhe e gëlltit të voglën. Asaj dite nga deti në qytetin tonë nuk doli një përbindsh i çfarëdoshëm, ai

ishte një monstër i vërtetë me mijëra kokë në trupin e tij. . .

Unë qesha. Nuk u përmbajta dot dhe qesha fort. E duke qeshur i thashë:

— Çfarë deti? Atëhere binte një shi i hollë e deti ishte fare i qetë. Shiu rizonte mbi valët e lehta, që vetëm shushurin në breg. Këtë unë e mbaj mend mirë.

— Deti. Asgjë nuk mund ta ndante qytetin tonë prej detit. Mua më dukej sikur gjatë gjithë ekzistencës së vet ai qytet i vogël kishte shkuar drejt detit, drejt frymës, shushurimës, lëvizjes së përjetshme të horizonteve të tij. Një pjesë e jetës së atij qyteti i takonte detit, me anijet, hamejt, molet, maunet. Armiqtë kishin ardhur dhe prej detit, por jo si monstra të paqena e fantazmagorike. Armiqtë kishin ardhur, ashtu si vijnë armiq nga deti, apo nga toka qoftë. Dhe qyteti ynë përherë ashtu i kishte pritur ata, si armiq.

Në ato ditë lufte deti nxirrte përherë jashtë në breg njerëz të mbytur, arka, trarë, botile të markave të ndryshme. Ne i merrnim ato dhe e dinim se diku në det ishte bërë luftë dhe ishin mbytur vapura. Edhe në ato kohë lufte deti ishte gëzimi më i madh i fëminisë sonë, ai vetë e bënte fëmijë atë qytet të vuajtur e të cfilitur në ato ditë të përgjakshme.

Unë qesha.

-- Vetëm detin — i thashë — nuk mund ta përfytyroj dot ashtu si ti, si një monstër të llahtarshëm. . . Unë nuk e di se me ç'sy fëminia jote i ka parë ato ditë. . . . Pastaj, përse «duhet të shkruaj ashtu?»

Agullim agimi. Në sfondin e errët të maleve

gjarpëron i argjendhtë lumi. Partizanët turma-turma, të zënë dorëpërdorë, disa hedhin lumin, të tjerë zhvishen në breg e bëhen gati të hidhen matanë, ndërsa disa të tjerë shkojnë sa andej-këtej duke marrë e duke dhënë urdhëra.

— Shtrëngohuni dorëpërdorë dhe, me t'u hedhur matanë, lëvizni shpejt, përpara njësh kolonë, ruani distancën e mos harroni se zona rreth është e mbushur me nazistë!

— Dhe me partizanë...

— Ashtu është... edhe me partizanë... Gjermanët e ballistët do të tmerrohen kur të dëgjojnë për kalimin tonë.

Nga lumi dëgjohen të thirrura: «Ah, mbahu! Mos m'u shkëput nga dora, Dritë, se të rrëmben vala! Ohu! Ra mushka me gjithë mortajën... Ruh!»

— Lëreni mushkën! Lëreni mushkën! Hidhni lumin sa më shpejt... Çani përpara... Në drejt të vejë mushka!

— Vau qenka i ngushtë e këtu do të kalojë tërë batalioni partizan.

Kompania e dytë akoma s'ka mbërritur, do të zgjatë kjo.

— Vijnë ata, po ne të hidhemi sa më shpejt, e të ikim përpara.

— Xhà Braho, të erdhi më në fund radha: ti në njërën anë, S. Agaj në anën tjetër... do të të dëgjoj, kur të thërrasësh: «S. Aga, si ma ke kadënën»?

— Ku e di ti se si do t'i thërrasë xha Brahua?

— Kush e do këtë kapotë?

— Më mjafton kjo që kam, po mori ujë, lumi të gëlltit.

Dy partizane këndojnë me zë të ulët:

«Në sulm, në sulm, në sulm

po na thërret boria, —

vdekje për armiqtë,

liri popullit mbarë!

— Q.D. do të vijë me ne.

— Vërtet?

— Rri pranë meje se kam mitralozin dhe mund të më rrëshqasin këmbët.

— Me mitraloz përsipër je më i rëndë, s'të merr dot vala e lumit. (Ata qeshin).

Nga lumi dëgjohen të britura: «Ecë në brinjë... në brinjë... mos i vërë gjoksin rrëmbesës... Kujdes, zajet, që rrokullisen nën këmbë, mund të të vrasin!»

— Shoku komandant i batalionit, nga Repishti gjermanët janë nisur e janë vënë në ndjekje të brigadës. Prandaj batalioni i parë mori urdhër që t'i ndalojë gjermanët në Konçë, kurse batalioni i tretë urdhërohet që t'u dalë përpara në Bashtë. Të mbrohen partizanët e të sigurohet hedhja e tyre matanë lumit.

— Dreqi ta hajë, edhe kjo na duhesh... Nga Repishti, the?

— Po.

— Batalioni i parë, the, mbron krahët e vet në Konçë?

— Po. Ju duhet të rezistoni në Bashtë, gjersa të hidhet matanë brigada. Atëhere do të jepet sinjali: një fishekzar në malin e Hoçit. Kjo do të thotë se brigada kaloi.

— Dihet gjë mbi numrin e armikut?

— Jo, shoku komandant, nuk dimë gjë.

— Ballistë a ka?

— Mua më thanë vetëm gjermanë.

— Lajmëro shtabin e brigadës se gjermanët nuk do ta kalojnë Bashtën. Vdekje fashizmit!

— Liri popullit!

Një partizan i veshur dhe i armatosur futet në lumë.

— Ku i ke shokët, ti, more? Ashtu i pazhveshur dhe i vetëm do të mbytesh.

— Unë e kam mik të vjetër lumin.

— Qerratai, ditka not. . .

— Q.D.

— Q.D.

— E shkëmbejmë topçiuin me belxhik?

— Në marshime të gjata, si ky, i lehtë është vetëm automatiku.

— Dëgjo, nga kompania jote merr njëzet vetë, Bredën e rëndë të skuadrës së parë, dhe një mitra-loz të lehtë e dil sa më parë në Bashtë! Mbrëmë, kur kaluam andej, ishte natë, nuk e pamë dot, kurse tani përpiqu ta njohësh më mirë terrenin. Forcat gjermane janë vënë në ndjekje të brigadës. Ato duhet me çdo mënyrë të ndalen e të sigurohet hedhja e partizanëve matanë lumit. Nuk dimë se cili është numri i njisive armike që po na ndjekin, por unë s'mund të të jap më tepër partizanë. Me ta, gjallë a vdekur, do të mbulosh hedhjen e brigadës.

Nuk do t'i lini pozicionet, veçse kur të jepet sinjali: një fishekzar i kuq në qiell, në majë të malit të Hoçit, që është përkundrejt matanë lumit. Atëhere edhe partizani i fundit do të ketë kaluar e ju mund të tërhiqeni të bashkoheni me batalionin. A më kuptove?

— Po, Mund të shkoj?

— Situata është e rëndë... Vështirë do ta kesh, po ti e kupton: me çdo mënyrë duhet të sigurohet hedhja e brigadës dhe unë vetëm ty mund të dërgoj atje... Ç'të të them tjetër?

— Vdekje fashizmit!

— Liri popullit! Mos harro se i vetmi va për të kaluar lumin në këto anë është ky këtu.

— E di.

— Ç'është ai partizan mbi gomar aty?

— Një i sëmurë, shoku komandant.

— (Me vete) Po tani?... Ç'të bëjmë me të sëmurin? (partizanit) — Shumë i sëmurë është?

— Liksht është, s'ecën dot.

— Hidhe në krahë të sëmurin e me partizanët e tjerë kalo matanë lumit. Atje merr edhe Alinë, që është nga këto anë e në Gjonçaj kërkoni e gjeni ndonjë bazë të sigurtë. Lëreni shokun atje, se ai nuk mund të vazhdojë dot marshimin.

— Po në ç'bazë?

— Unë që këndeje do t'jua gjej bazën juve? Me Alinë siguron shokun e sëmurë, se ndryshe përgjigjeni për kokën e tij.

— Do ta gjejme një bazë, shoku komandant.

— Q.D.

— Q.D.

— Rrëmbeu lumi një shok.

— More, po ku i keni repartet ju? Partizanë jeni, apo ç'jeni? Thuaj Brahimit, matanë të nxjerrë menjëherë partizanë, që të kërkojnë shokun e mbytur. Dëgjoni? (me vete) Qoftë kjo humbja jonë e vetme këtu...

— Në sulm, në sulm, në sulm.

Po na thërret boria...



— Ç'do të bëhet në qytet, kur të marrin vesh se partizanët hodhën lumin?

— Ç'do të bëhet, moj shoqe?

— Të gjithë do të luajnë meç: nazistët e ballistët nga frika, populli prej gëzimit.

Dëgjohen fjalë, të thirrura, biseda, të qeshura të partizanëve, që kalojnë lumin dhe pastaj përnjëherë në thellësi ushtojnë të shtëna pushkësh e breshëri mitralozësh.

— Pararoja u ndesh me armikun, shpejtoni, shokë!

— Q.D.

— Q.D.

— E dëgjon? Lufta krisi nga të dyja anët.

— Qentë.

— Nuk e sheh që gjithë zjarrin e tërheq ti mbi vete? Ndërro vend e zërë pozicion tjetër!

— Të goditi rëndë?

— Më gërvishi plagën e vjetër, rufjani.

— More pionier, na verbove sytë me atë topçiun tën; bën aq flakë...

— Ç'të bëj unë?

— Dëgjo xha Brahon ti, qëllo rrallë bir'i ba-bait, rrallë... se gjermanët qëllojnë në flakën e topçiut dhe na dëmtojnë... Po atij gjermanit të madh mirë ja bëre, mbeti atje tej gërmuq.

— Pse, unë e vrava? Mua m'u duk se e vrave ti me maliher.

— Ashtu të është dukur, po atë e goditi topçiun yt.

— Zeqo, na këtë torbë me bomba.

— Ku i gjete? Oh, s'të ka kush, moj Q.D. Tani këto më duhen... vetëm këto. Q.D., merr një gur të madh e ja vë te kryet. Ti nuk zure e nuk zure mend. Nuk gjen as një gur për të mbrojtur kokën tënde, apo mendon se plumbi ty nuk të shpon?

— Nuk e sheh ti, more, që ne u bëmë thela këtu?

Ja, ajo beteja partizane...

Më kot isha munduar të shkruaja e të zhgarravitja diçka në fletoren time. Nuk mundja. I heshtur në mesin e dhomës qëndroja në këmbë, shihja librat, letrat përhapur sa andej-këtej — mbi tavolinë të punës dhe ndjeja një zbrazëtirë të thellë e të ftohtë. Asaj nate nuk gjeja për të thënë asgjë dhe pesha e zbrazëtirës më dukej nga më të rëndat, që mund të kisha ngritur ndonjëherë. Në qetësinë e plotë të natës rrija i heshtur e mendoja se në të vërtetë isha hamall i asaj zbrazëtire të thellë e të ftohtë. U shtriva në shtrat. Menjëherë sytë e mij shkuan e ranë mbi stivat e librave që qëndronin të ngrira njëra pas tjetrës në rafte. Më shkoi ndër mend se ai bashkëmoshatare im me ata gishtërinjtë e gjatë, të tultë e të lëmuar, tashmë sigurisht që do të kishte menduar se do të mjaftonte vetëm të ulte e të prekte sado pak me majë të gishtit të tij njërin prej atyre librave dhe gjithshka do të lëvizte e prej tyre, si prej kutish të çuditshme, do të dilnin ditët, netët, pranverat e dimrat, që me fërshëllima rrëshqanorësh të llahtarshëm

do të zvarriteshin nëpër dhomë. Të tjerët gjysmë zvarranikë e gjysmë zogj, me krahë e çapokë të stërlash-të, do të mbushnin ajrin e rëndë e të fëlliqur. «Kësh-tu duhet të shkruash ti,» m'u kujtua porosia që më jepte ai herë pas here.

Çfarë sy kishte montuar në ballin e fëminisë së vet ai njeri? Apo në të vërtetë fëminia çfarë sy kishte sajuar në ballin e atij njeriu? Kur ai bisedonte me mua, më dukej sikur para tij fëminia shfaqej si një qengj i bardhë, i bukur dhe ai e ndillte dhe i zgjatte përpara dorën me bukë e kripë po, kur ndjente gjuhën e ngrohtë e të lagur nga jargët që lëpinte, njeriu shihte se te këmbët e tij nuk ishte qengji i bardhë, por një monstër, që hante bukën e kripën.

U ngrita e mora prej raftit një numër gazetash të vjetra. Nisa t'i shfletoja njëra pas tjetrës, më tepër për t'u harruar e për të kaluar kohën. . . .«Sulmet ajrore tanimë janë një front i dytë. Me 22 divizione sovjetikët sulmuan pozicionet gjermane gjithë natën. Ushtritë gjermane korrën edhe një sukses të ri mbrojtës». «Le të vijmë — po i presim» — deklaroi Ribebentropi. «Humbje të mëdha nga kolerë në Bengala.» «Agjencia angleze «Reuter» jep me rezervë lajmin se ish-ministri i punëve të jashtme të Italisë konti Ciano qenka pushkatuar sot në orët e para të mëngjezit. Një tjetër gazetë: ekzekutimi i kontit Ciano përgënjeshtrohet nga ana e autoriteteve kompetente italiane. Procesi nuk ka filluar ende. «Bashkimi i kombit» uron shqiptarët për shumë vjet e gëzuar bajramin. Nga shkaku i

festave të bajramit gazeta nuk do të dalë për dy ditë. . .»

I lashë gazetat në vend dhe përsëri u shtriva në shtrat. Ajo zbrazëtirë e ftohtë rëndonte gjithnjë tek unë. Në spektrin e atyre lajmeve, kumtesave, betejave, të vrarëve të fronteve shihja kronikën e jetës e të vdekjes së njerëzve, të dashurisë dhe të urrejtjes së tyre. Mendoja se edhe kronikat ndryshojnë, për të mirë, apo për të keqe, plaken, rinohen e, kur kanë nevojë, ndofta frymëmarrin me mushkëritë e asaj gruaje të pushkatuar nga SS-ët. Në qetësinë e natës, i vetëm, nisa të dëgjoja zërat e atyre ndodhive e, duke mbajtur vesh, ndjeja se si prej atyre zërave, si bisqe fare të njoma dilnin e dëgjoheshin zëra të tjerë, e pas tyre të tjerë që, njëri më i tingëllueshëm se tjetri, arrinin prej ditëve të largëta të fëminisë gjer në ditët e sotme. Duke dëgjuar ata zëra, nuk po vendosja dot nëse duhej apo jo, të shkruaja atë ndodhi, që më tregoi ai oficeri. Ndjeja se hezitimi hapej mu në mes të zbrazëtirës sime të ftohtë, që më rëndonte ashtu asaj nate.

— Ahere unë isha komisar çete dhe Petrua ishte një partizan i thjeshtë — më pati thënë oficeri.

«Ç'më duhet ky Petro», mendova me vete, po atij nuk i thashë gjë. Unë kisha shkuar dhe e kisha pyetur oficerin për Q.D.-en, po ai nuk e kishte njohur dhe vetiu pastaj biseda erdhi te ky partizani.

— Petrua ishte njeri i heshtur, që fliste rrallë dhe disa herë, kur ishin ndarë nëpër baza të flinin, ne e kishim harruar. Mbante gjithnjë mbi supë një hejbe të mbushur plot me fishekë bomba dore e

me rrobot e trupit, se edhe partizani njeri ishte, morrat mund t'i pinin sytë edhe atij.

«Ç'më hyn në punë ky Petro, mendova përsëri unë dhe çfarë na paska të habitshme, që një partizan ecën nëpër male me hejbe në krahë...»

— Një ditë — më tha oficeri — ne u përleshëm me nazistët. Më kujtohet si tani që u zumë gjermanëve një mitraloz të rëndë, nja shtatë pushkë e disa arka me fishekë. Ua shpërndamë partizanëve dhe, pasi pushuam në një kodër, u thamë atyre të pastronin armët, se përsëri do të niseshim në marshim. Grumbuj-grumbuj partizanët u përhapën nëpër bar e nisën të fshinin mitralozët e pushkët. Unë kërkova e gjeta një vend mënjanë, hapta fletoren dhe nisa t'i shkruaja komandës mbi rezultatin e përpjekjes me nazistët. Isha duke shkruar, kur dëgjova disa kumbora të largëta dhensh. Ngrita kryet të kërkvoja nëpër kodër kopenë e deleve. Po nuk po shihja asgjë, kurse kumborët dëgjoheshin aty pranë meje. Atëhere ndjeva disa partizanë të qeshnin, thërrisnin e vinin nga unë duke tundur disa kumborë në duart e tyre. Pas tyre rendte Petrua, edhe ai duke thirrur e duke britur:

— Më jepni zilet...

Partizanët qëndruan para meje.

— Shiko, komisar, se ç'mban Petrua në hejbenë e tij — më tha njëri prej tyre duke qeshur...

— Kumborët... Unë u habita fare.

— T'u mbylltë — i thashë partizanit — ku i ke gjetur?

— M'i dhanë në Skrapar — tha ai. — M'i dha një kushëriri im, m'i fali. Aman, komisar, m'i jep!

Çeta jonë kishte qenë në Skrapar vetëm një herë para gjashtë muajsh. I mora ato dy palë zile të rënda ndër duar, i tunda. Kumboi një zë i ëmbël dhe i dashur...

— Shoku komisar... — dhe Petrua m'i rrëmbeu nga duart kumborët. Nisi t'u binte e t'i dëgjonte ato me vëmendje të madhe... — Kur të mbarojë lufta, do t'ua vë në qafë përçorëve.

— Këto ke mbajtur kaq muaj në hejbe? — e pyeta unë.

— Po...

Partizanët po qeshnin.

— Petro — i thashë unë — ne do të luftojmë shumë dhe lufta jonë është e gjatë. Ne kemi menduar se në hejbe ti mban bomba e fishekë...

— Ato i mbaj në mes — tha partizani... — Të lutem, komisar, m'i jep kumborët...

U ngrita nga shtrati dhe hapa dritaren e dhomës. Ajri i freskët i natës më ra në fytyrë, po nuk u largova prej andej. Ajo ngjarje nuk i përkiste jetës së Q.D-es, po një njeriu tjetër, një farë Petroje. Dhe unë e dëgjova rastësisht. A duhej ta shkruaja atë? U kujtuash se si ai bashkëmoshatari im, duke goditur me gishtërinjtë e tij të tultë e të gjatë mbi tavolinë, duke kërkuar të më bindte se asaj dite, kur ishte pushkatuar ajo grua, shpatulla e qytetit tonë ishte thyer dhe udhët e mëhallëve të vockëla mbetën të gjymtuara dhe uloke përgjithnjë, — ai në të vërtetë shikonte thellë vetes së vet (vetëm brenda vetes së vet) dhe kërkonte rrënjët e fëminisë së tij, të qenjes së tij.

Tani, aty te dritarja e dhomës sime, në atë

qetësi të natës unë shikoja thellë vetëvetes e dalloja nëpër ato ditë të shkuara vijat e përgjakura të fronteve të luftës, llogoret, divizionet e ushtarëve që lëviznin, gërmadhat e qyteteve, kolonat e gazetave, fjalimet e copëtuara të burrave të shteteve, të gjitha, si fije të rrënjëve të mia, përhapeshin nëpër shtete, kontinente e popuj, që s'i kisha parë kurrë ndonjëherë, por që tani i ndjeja kaq afër. Dhe si një statujë e rënë midis atyre shtresave të kohëve e të dheut, qëndronte një emër Q.D. Po tani mbi të gjitha ato ç'kisha parë e dëgjuar binin e kumbonin kumborët e atij partizani, që e quanin Petro.

A duhej ta shkruaja atë ngjarje?

Ra zilja e telefonit dhe unë me përtim ngrita dorezën.

— Alo?

— Alo — erdhi zëri që andej.

— Kush je? — pyeta unë.

— Gjeje.

Mendova pak.

— Të lutem, kush je — i thashë.

— B.B.

— Oh! po ku je, more? si dole këtej?

— Sapo kam ardhur. Kujtimet që më ke kërkuar ti, i kam sjellë. Në ora tetë takohemi të sahati.

Në ora tetë u takuam. Unë doja të pinim ndonjë birra, po B.B. nuk kishte kohë, ai ishte inspektor finance në një qytet tonin të vogël dhe e kishin thirrur për mbledhje në ministri. E pashë shumë të dobësuar dhe i thashë:

- Ruaj shëndetin!
- Nuk ka gjë — tha ai.
- Je shumë i dobët, shko njëherë te doktori!
- Do të shkoj — tha ai, me sa dukej më tepër për të mos ma prishur mua.
- Dëgjo — i thashë unë — bëje për mua, shko...
- Do të shkoj... — U përqaftua dhe ai la në duart e mia disa faqe shënimesh të shkruara, që ja kisha kërkuar më parë.

...Një mbrëmje tjetër, kur unë po rrija para dyqanit të fshatit, erdhën dy partizanë. Ata ishin nga fshatrat e Vlorës, bile njëri nga ata kishte punuar edhe në qytet edhe unë e njihja si fytyrë. Partizanët më treguan se gjatë luftimeve me armikun vëllai im ishte plagosur në kokë. Ai ishte plagosur në luftë me ballistat dhe me gjermanët në Qafën e Koçikut dhe, siç më thanë të dy partizanët, ishte shtruar në spitalin partizan, në Zagori. «Po deshe të vish me ne — thanë partizanët — pregatitu për t'u nisur, mbasi ne do kalojmë në Zagori».

Pa e zgjatur, lajmërova shtëpinë dhe u bëra gati për rrugë. Koha ishte e ftohtë, por e bukur. Me vete kisha marrë një kulaç gruri e pak djathë. Isha veshur tamam si një partizan. Kisha veshur një palë rrobe ushtarake të leshta italiane, në kokë kisha bustinën me yll të kuq, kisha ngjeshur në brez një gjerdan me fishekë dhe në krah një pushkë nga të karabinierisë italiane. Në këmbë kisha një palë këpucë alpine dhe në kurriz një çantë shpine. Kisha me vete edhe një palë dorashka e një kokore të leshtë.



E lamë Shkozën pas dhe kaluam në Gurin e Ylyncit, nëpër disa shkallë që binin thikë mbi Vjosë. Shkëmbi ose Guri i Ylyncit është ballë për ballë Kalivaçit e ka një bukuri të rrallë. Pasi kaluam Gurin e Ylyncit, mbërritëm në Dorrëz, një fshat malor. Banorët e tij merren kryesisht me blegtori dhe janë të gjithë çobenj. Nga Dorrëza giyshi im ka zbritur në Vlorë, pra këtu ka prejardhjen edhe familja ime. Kështu unë u gjenda në fshatin e gjyshit tim. Prej Dorrëze dolëm në Sinauj, Matohasanaj, Dhëmbjan e në shumë fshatra të tjera të Tepelenës, që tani nuk më kujtohen, sepse qysh atëhere unë nuk kam kaluar më në ato anë. Mbaj mend se në mbrëmje mbërritëm në teqen e Turanit. Ajo natë më kujtohet fare mirë. Në teqe ishte një dervish llafazan, që të shkrinte me muhabet. Kishte zakon që për çdo fjalë të përdorte shprehjen «dmth» dhe këtë e kishte për gjë të madhe. Për babanë, dervishi pregatiste si gjellë oriz me lëng mishi, që zjente ngadalë jo mbi zjarr, por mbi afshin e prushit.

Të nesërmen në mëngjez herët u nisëm për udhë duke kaluar nga Lekli, Hormova e Labova dhe, pasi ndenjëm një natë në një fshat të Zagorisë, që tani nuk më kujtohet, duke kaluar kështu grykën e Selckës mbërritëm në Poliçan.

Duke pyetur se ku ndodhej im vëlla, rastësisht takova atëhere përgjegjësën e spitalit të Nivanit (spitalit partizan) emri i të cilit nuk më kujtohet, vetëm se mbaj mend që ishte një djalë i shëndoshë. Ai me kënaqësinë më të madhe më ndihmoi duke më treguar se vëllai im ndodhej i shtruar në spi-

talin e Nivanit dhe se, po të doja, mund të shkoja së bashku me të.

Kështu më në fund, pas një rruge të gjatë unë mbërrita në Nivan dhe munda të takoja vëllain tim. Më kujtohet si tani, që ai më priti tërë inat, nuk i pëlqeu vajtja ime (kishte merak mos pësoja ndonjë gjë) dhe më tha: — Ç'deshe që erdhe? — Ju përgjegja se më kishin dërguar nga shtëpia për ta parë. Vëllai ishte plagosur në nofullën e poshtme, e kishte thyer, në qafë mbante një peshqir, ku pështynte gjakun dhe qelbin që i dilte nga plaga. Pasi qëndrova pak, ai u ngrit dhe më dha edhe mua një nga ato çokollatat e atëhershme, të cilat ishin shumë të mëdhaja; gjysmën e saj e hëngra menjëherë, ndërsa pjesën tjetër e ruajta. Pastaj ai me një ton urdhërues më porositi që të nesërmen të nisesha sa më parë në shtëpi.

Ju binda. Të nesërmen në mëngjez herët, nuk e mbaj mend mirë se me kë udhëtova, u nisa për në Lunxheri (Labovë), veç kësaj radhe jo nga ana e grykës së Selckës, por nga Mali i Çajupit. Mali i Çajupit, por sidomos fusha që shtrihet në mes të tij ishte madhështore: mal nga lindja, mal nga perëndimi, mal nga veriu dhe nga jugu, ndërsa në qendër një fushë e bukur. Në mbrëmje mbërritëm në Labovë, ku çdo gjë kishte ndryshuar, kisha kishte filluar të prishej sikur edhe ajo po lajmëronte për rrezikun që po vinte. Në Labovë shihja njerëz që iknin malit, gra që bërtisnin për fëmijët e tyre, kafshë të ngarkuara gati për nisje. Nuk kuptoja ç'po ndodhte. Isha ulur te praku i një shtëpie e po rrija i mërzhitur. Po mendohesha se nga duhej t'ja mbaja, kur papritur m'u afrua një partizan, që unë

nuk e njihja. Ai ishte partizani gjirokastrit Beso Baboçi që, siç kam marrë vesh më vonë, ka vdekur pas çlirimit. Besua më tha se pa humbur kohë ne duhej të iknim që andej. Sipas tij rruga e vetme nga duhej të shkonim ishte mali i Çajupit, prej nga unë kisha zbritur atë ditë. Sipas Besos ne prej andej do të kalonim në Zagori, ku kishte baza të forta partizane e pastaj, pasi të mbaronte operacioni i gjermanëve, që kishte filluar, mund të ktheheshim secili në punën tonë. Besua më tha se gjermanët ishin në Hormovë ose Lekël, jo më larg se gjysmë ore prej andej (prej Labove); ndërsa në Zagori, sipas Besos, nuk kishte gjerman që të shkelte i gjallë. Të them të drejtën, nga rruga që kisha bërë isha shumë i lodhur. Koha atë mbrëmje ishte prishur fare, binte një shi i hollë e i ftohtë dhe unë po ngrija së ftohti.

I mbushur me besim e shpresë nga Besua mora së bashku me të udhën për në majën e Çajupit. Rrugës na zuri një shi edhe më i madh, ishte krejt errësirë dhe mezi shihnim njëri-tjetrin, bente jash-tëzakonisht ftohët. Unë isha edhe më i lodhur se Besua. Nga të ftohtët dhe lodhja nuk mund të nxirrja as dorashkat prej xhepi. Gjatë natës u bëra krejt ujë, nuk kishte pjesë të trupit që të mos më ishte lagur. Sikurse thashë, në krah unë kisha një pushkë të karabinierisë italiane dhe pak fishekë. ndërsa Besua, shoku im i rrugës, kishte vetëm një revolver por jo të saktë. Ai më tha se gjatë rrugës duhej të kishim kujdes nga ujqit, që andej, në male dhe gërxhe ishin të shumtë. «As ti me pushkën tënde dhe aq më tepër unë, nuk kemi se ç'u bëjmë atyre më» — tha Besua.

E përpjeta e Çajupit mori fund dhe së bashku

me Beson ecnim nëpër fushën e lartë të Çajupit nëpër ujë e baltë. Nuk e mbaj mend mirë sa zgjati ky udhëtim, por më duket se në mesnatë mbërritëm në hanin ose hotelin e Çajupit. Ajo shtëpi, që ishte kthyer në gërmadhë, dikur paskësh shërbyer si shtëpi pushimi për njerëzit e sëmurë nga tuberkulozi. Sapo hymë brenda, disa gryka pushkësh u drejtuan kundër nesh, por ato u ulën menjëherë pastaj. Siç dukej na njohën, që ishim edhe ne partizanë. Aty takuam një skuadër partizanësh, një zjarr të madh dhe ne filluam të tereshim. Sot nuk më vijnë ndër mend fytyrat e tyre, por ata u treguan shumë bujarë, na bënë vend dhe u vinte keq për ne. Të dy, si unë ashtu dhe Besua, ishim të vegjël: unë sapo kisha mbushur 13 vjetët, ndërsa Besua, shoku i rrugës, nuk ishte më shumë se 15-16 vjeç. Nuk di se si gjeta në çantën time një kothere buke dhe fillova ta haja me oreks. Gjatë tërë asaj dite nuk kisha futur gjë në gojë. Shokët që takuam në atë gërmadhë na thanë se ishin artilierë të një brigade partizane.

Ndaj të gdhirë, pa zbardhur mirë dita, u nisëm për marshim në drejtim të fshatrave të Zagorisë. Shumë herët në mëngjes kaluam mbi Topovë, kaluam nëpër disa përrenj e rrugë të këqia dhe në agim ne ishim në Sheper. Kujtuam se vuajtjet tona morën fund, por ajo ishte fillimi. Në Sheper ne takuam kompaninë e fundit që po tërhiquej. Ajo kishte rënë në përpjekje me një kolonë gjermane, po vinte nga Greqia në drejtim të Poliçanit dhe shumë partizanë ishin të plagosur. Për këtë arsye qëndrimi në Sheper ishte i pamundur. Të gjithë

ishin larguar, bile edhe spitalet partizane në Sheper në Nivan. Në Sheper ne takuam gjithashtu përgjegjësit e depove partizane, të cilët shpërndanin materialin kudo që mundnin. Mua dhe Beson na ftuan të shkonim në ato depo dhe të merrnim ç'të dëshironim: ushqim, veshmbathje. Bashkë me Beson mbushëm çantën time të shpinës me bukë misri, rreth 10 kuti me ushqime të ndryshme si gjalpë derri, marmallatë e reçel. Përgjegjësit e depove partizane bënëin çdo përpjekje për ta asgjësuar ose groposur materialin, me qëllim që ai të mos binte në dorë të fashistave gjermanë. Pastaj, së bashku me kompaninë e fundit partizane u nisëm në drejtim të qafës së Dhëmbelit, në malin e Nemërçkës. Si tani e kam parasysh atë marshim në drejtim të atij mali. Isha pa gjumë dhe shumë i lodhur, isha krejt i lagur dhe në kurriz kisha çantën time të shpinës plot e përplot me ushqime. Nga të lagurit e shiut, nga pesha e çantës dhe nga të ftohtët kapota ime ushtarake më ngriu si tendë mbrapa kurrizit. Rrugica ku ne shkonim i ngjante më tepër një kanal të hapur në borë, që arrinte gjer në brez. Ne ecnim nëpër atë kanal, që ishte hapur nga repartet partizane që kishin kaluar para nesh. Gjatë rrugës shihnim plaçka të ndryshme të hedhura sa rrethë-këtej. Rrëzë një shkëmbi një mushkë kishte rënë dhe po ngrinte në borë, po ngordhte, s'kishte kush e merrte. Më tej një kapotë ushtarake, një çantë shpine, një copë garzë, një vijë gjaku në borë, që e kishte burimin nga ndonjë partizan i plagosur. Pas një udhëtimi të lodhshëm dhe të vështirë më në fund ju ngjitem qafës së Dhëmbelit. Aty më

kujtohet se kishte një burim uji por unë nuk piva, jo se s'kisha etje, por mbërdhija së tepërmi dhe e kisha të vështirë të lagja dorën. Pas një pushimi shumë të shkurtër, filluam të zbrisnim poshtë në Përmet. Udha, ose më mirë, shtegu ku ne kalonim ishte shumë e ngushtë dhe i pjerrët, bora ishte ngrirë dhe ne më tepër shkisnim se sa ecnim. Për të mos rënë në ndonjë greminë, mbaheshim nëpër drurë e nëpër shkurre. Para se të arrinim në Përmet, u ndalëm në një fshat (më duket Leusë) dhe aty bashkë me Beson menduam të bënim pushim të shkurtër. Me bajonetën e pushkës sime hapëm një nga kutitë e reçelit, që kisha në çantë dhe filluam ta hanim. Edhe bukë kishim në çantën time të shpinës. Harrova të thosha se çantën e mbanim me radhë, herë unë dhe herë ai; kur lodhej njëri, e merrte tjetri, kohën e ndërrimit e llogaritnim me mendje. Nuk kishim ngrënë as tri-katër kafshita bukë, kur dy aeroplanë gjuejtës fluturuan mbi ne për të na mitraluar. E lamë bukën në vend e nisëm të vraponim, kaluam në Përmet dhe u ndodhëm buzë Vjosës, ku me një pasarele kaluam matanë lumit. Vjosa aty vinte shumë e ngushtë në krahasim me vendin e gjerë që ajo zinte në fushën e Shkozës. Në disa kodra përtej Vjosës (afër Tremishtit) ne takuam batalionin e Baba Fejzos. Edhe aty na sulmuan dy aeroplanë gjermanë. Më kujtohet si tani, kur Baba Fejzua, sa pa aeroplanët, thirri me tërë forcën: «Hapuni, djema, se aeroplanët!» Të gjithë partizanët u shpërndanë nëpër përrenj e gropa dhe shkurre. Aeroplanët nuk na diktuan, dhe ne nga ata nuk pësuam asgjë. Në mbremje mbërritëm në fshatin Tremisht. Isha shumë i lodhur dhe gjer aty

nuk kisha marrë asnjë sy gjumë. Në fshat na ndanë nëpër shtëpira. Unë së bashku me Beson dhe një grup partizanësh shkuam në një shtëpi. Me qenë se nuk kishin ç'të na jepnin, veç bukës, së bashku me Beson hapëm një kuti mish derri, të cilën e skuqëm në një tenxhere dhe filluam ta hanim së bashku me partizanët. Më në fund ramë për të fjetur. Por natën dikush më tërhiqte nga këmbët dhe më thërriste: «Çohu, se duhet të ikim». Nuk di sa ishte ora, vetëm mbaj mend mirë që nuk ngrihesha dot nga lodhja e pagjumësia. Partizani që më tërhiqte nga këmbët nuk më ndahej. Nëpër gjumë u bëra gati për rrugë. Nuk merrja vesh se ku shkonim; kur pyeta disa herë me radhë, më thanë se po shkonim në një fshat të afërt. Për fat të keq ai fshat nuk dukej gjëkund dhe ne udhëtuam nëpër errësirë e të ftohët pothuaj se përmbi dy orë. Ashtu mbërritëm në Kosovë të Përmetit. Atëhere thashë me vete: «mori fund edhe lodhja ime, do të shkojmë në ndonjë bazë e do të flemë». Por shpresat ishin të kota. Sapo ne mbërritëm në fshat dhe në kohën kur unë isha shtrirë në atë të ftohët në një cep të murit të kishës së Kosovës, dëgjova thirrjet e komandantëve të repar-teve partizane që thoshin:

Partizanët e Batalionit Naim Frashëri, — këtu.

Partizanët e Brigadës VI, — këtu.

Partizanët e Batalionit Baba Abaz, — këtu.

Partizanët e Brigadës I, — të mblidhen këtu.

Një marshim i ri dhe më i rëndë po fillonte përsëri.

Duke ndejtur pranë murit të kishës së Kosovës po mendohesha me vete dhe po thosha: «Vallë, ku

do të shkojmë ne tani pas kësaj lodhjeje të tmerrshme? A më kanë mbetur mua më fuqi që t'u qepem mbrapa reparteve partizane?» Së largu, matanë Kosovës më zunë sytë disa drita që lëviznin nëpër errësirë. Pyeta një partizan se ç'ishin ato zjarre. Ai m'u përgjegj se një kolonë gjermane po vinte në drejtim tonë, prandaj duhej të largoheshim pa humbur kohë. Shpresa për ta takuar edhe një herë vëllain më jepte akoma fuqi e vullnet. Dhe ja tani filloi marshimi tjetër në drejtim të malit të Kokojkës. Filloi nisja e kolonës partizane. Asnjëri nuk interesohej për mua. Unë nuk isha i rreshtuar në formacionet partizane, d.m.th. nuk bëja pjesë në ta, por shkoja vetë mbrapa tyre. Ishte dimër i madh, frynte erë dhe bënte shumë ftohtë, ishte me të vërtetë acar. Dëbora kishte mbuluar krejt vendin, e murlani ta përplaste atë në fytyrë. Rruga nuk dukej gjëkund. Ne ecnim njëri pas tjetrit. Dhe ja më në fund pothuaj ishim sipër në majë të malit të Kokojkës. Për t'u mbrojtur nga era, rrugës shkoja anës ndonjë mushke, se tjetër mbrojtje nuk kishte. Duke ecur ashtu anës një mushke, unë dëgjova zërin e tim vëllai. U hutova, nuk dija si të veproja, t'i flisja apo jo, por unë nuk i dhashë aspak të njohur dhe nën vete nisa të qaja. Ishte një moment shumë i vështirë. Ne kishim humbur rrugën në dëborë. Partizanët bërtisnin që të pushkatohej ai që udhëhiqte kolonën se ishte tradhëtar dhe na ngriu në dëborë. Një partizane, një vajzë e re, më kujtohet si tani, nuk kishte më fuqi, dhe shokët filluan ta tërhiqnin zvarrë nëpër borë. Pra a mund t'i flisja unë vëllait në ato momente. Përveç plagës së tij që i pëllciste herë pas here gjak nga të ftohtët, ai duhej të më kishte në



kujdes edhe mua. Unë nuk i fola. Ai vendim më erdhi në kokë menjëherë.

Sikur unë të isha i çlodhur dhe të isha në gjendje të mirë që të mund të vështroja se ç'ndodhte përreth, unë do t'i jepja këtij tregimi të gjitha ngjyrat, sepse ajo ka qënë nata më e vështirë që kam kaluar në jetën time gjatë Operacionit të Janarit 1944. Por për fat të keq pas 5-6 ditë udhëtimi pa gjumë, unë ecja, e borigat e Kokojkës më dukeshin pallate, kodra përtej më dukej si një qytet plot drita, shihja dhe ëndrra të tjera, bija përtokë nga lodhja e pagjumësia dhe ngrihesha përsëri me forcat e fundit që më kishin mbetur dhe ecja pas partizanëve me shpirt nër dhëmbë. Edhe sot unë çuditem për kujdesin që tregoja në atë kohë për veten time. Pakujdesia më e vogël të kushtonte jetën, e paguaje me vdekjen e sigurt, duke ngrirë në dëborë.

Herët në mëngjez ndodheshim në të hyrë të katundit Frashër. Aty u ulëm për të pritur kolonën (shokët e tjerë) në disa shkëmbenj. Nga lodhja nuk mundja të qëndroja në këmbë, por edhe të ulesha ishte e pamundur, sepse më kapte përnjëherë gjumi dhe në atë rrëmujë ishte rrezik të të harronin. Unë gjeta atëhere një mënyrë origjinale për të pushuar: gjysmën e trupit (pjesën e sipërme e mbështeta në shkëmb ndërsa pjesën tjetër nga këmbët e poshtë) e lashë në ajër duke takuar vetëm majat e këmbëve. Kur më zinte gjumi, unë bija përtokë dhe vendosesha përsëri në pozicionin e mëparshëm.

E ndërpreva aty leximin e atyre kujtimeve dhe u ktheva sërish të lëcit në ato faqe ku shkruhej: «... mua borigat e Kokojkës më dukeshin pallate, kodra përtej më dukej një qytet plot drita, shihja dhe

ëndrra të tjera, bija përtokë nga lodhja e pagjumësia dhe ngriheshja përsëri me forcat e fundit, që më kishin mbetur dhe ecja me shpirt nër dhëmbë pas partizanëve. . . »

— Eh, ajo. . . fëminia ime!

## IX

Burgu. Dy palma të vjetra, të zhveshura e të rjepura nga era e shiu. Dy të vetme. Të trishtuara ngriheshin mbi shtëpitë përdhese prej kallami e balte të asaj lagjeje bostanxhinjsh e argatësh. Midis atyre palmave kalonte një udhë e zhavarrrtë, tërë gropa e ujëra. Pastaj ngrihej shtëpia e verdhë, dykatëshe. Burgu. Dhe lagjja. Ku mbaronte burgu e ku fillonte lagjja? Netve dikush trokiste nëpër dritaret e shtëpive përdhese. Hapej një derë, një mërmërimë e fshehtë dëgjohej. Ndërsa burgu ngrihej i ngrysur e i akullt mbi tërë lagjen. Ashtu qëndronte ai përherë mes mendimeve të njerëzve. Dhe mendimet s'mund të heshtnin. Asnjë burg s'mund t'i shuante ato. Banorët e lagjes së varfër e dinin se në fund të fundit brenda tij jetonin njerëz, njerëz si ata vetë. Po përsëri, kishte diçka të akullt e të panjohur në hijen e asaj shtëpie të verdhë, nëpër të cilën, të mbështjellë me kapotat e gjelbëra lëvrinin SS-ët. Brenda asaj ndërtese thureshin drama nga më çnjerëzoret, që imagjinata e njerëzve kërkonte t'i zbërthente, sepse edhe dramat,

sado tragjike të ishin, prapë edhe ato kishin lo-  
gjikën e tyre.

Cilido që do ta dëgjonte e do të shikonte atë  
tkurrje të menjëhershme të fytyrës së saj do të  
kuptonte se ato fjalë ajo kaq e kaq herë ja kishte  
thënë edhe vetëvetes. E përsëri kujtimet vinin tek  
ajo, ashtu si vijnë zogjtë në të vetmen pemë në  
mes të fushës së hapur. Fluturojnë sa fluturojnë  
e pastaj vijnë e ulen aty. Ajo donte t'i largonte, po  
kujtimet vetë nuk largoheshin dot prej saj. Gruaja  
zemërohej. Më tepër me veten e vet zemërohej.

Hidhja shikimin nëpër dhomë: një sobë, një  
nim, rafti i librave. «Janë të djalit» — tha gruaja.  
Hodha shikimin nga dritarja. Zhurma e rrugës vin-  
te aty e përzier me zërat e fëmijëve, që luanin për-  
jashta. Gruaja qëndroi ca kohë e heshtur në karrige  
e pastaj u ngrit. Ndezi furnelën e vuri xhezven e  
kafesë.

— Q.D. ishte në burg?

— Ishte — tha ajo.

Dhe vazhdoi të ziente kafenë. Vëreja nga pas  
atë grua. Duhej t'i kishte kaluar të 50-tat. Me një  
shami të zezë lidhur kokën. Me një fustan shtëpie,  
pak më të gjatë se sa i mbajnë zakonisht gratë tona. Ki-  
sha shkuar atje pa e lajmëruar. Ajo më priti ashtu  
siç ishte. Kishte shpatulla të mbledhura e një trup  
të hollë. Nën atë fustan të gjerë, ai trup nervoz lë-  
vizte gati i tëri.

— Kur e pushkatuan, ju atje ishit?

Ajo nuk u përgjegj. Mori sheqerin e filloi ta  
përziante në kafe. Vërtitte lugën brenda xhezves.

Mendova se kafeja do të derdhej, po ajo e ngriti përnjëherë, kur pa valimin e lëngut.

— Atëhere vdekja ishte mjaltë...

Dhe u kthye nga unë. U afrua te tavolina. Rregulloi filxhanët e filloi të hidhte mbi ta kafënë. Vështrova fytyrën e saj e përsëri sytë më shkuan tek ajo vizë e thellë mbi vetullën e majtë.

— Plumbi... Kush pyeste për të?! Thoshte: ku je, varr, hapu... Sikur ajo të ishte gjallë tani e ta pyesnit, do ta dëgjonit vetë...

Ajo përsëri heshti. Kurse mua më çuditi vetë mendimi i saj: «sikur të mundnit e ta pyesnit tani Q.D-en...» — Vërtet, sikur të kishte mundësi. Po ku ta gjeje tani atë? Ajo kishte vjet që s'ishte më.

— Po të ishte gjallë...

— Urdhëroni... — gruaja më solli kafënë. Filluam të pinim. Qëndronim ballë njëri-tjetrit. Shihja sytë e saj. Dy sy të zez, picigjatë. Nën ta dy vijëza të holla hiqeshin e zgjateshin duke formuar një si krah zogu.

— Kishte ditë — tha gruaja, — kur ne nuk mendonim më për jetën. As për vdekjen... — Ajo nduku buzën e poshtme, po vetëm një çast... Gjithshka përsëri u zhduk në fytyrën e saj... — Ne ishim në duart e tyre... Edhe koha e tillë ishte... Ne ishim gra... kurse ata...

Përsëri heshti. Tashmë unë e dija që ajo do të vazhdonte. Do të fliste vetë. E kishte filluar rrëfimin e saj, e s'kishte për ta ndërprerë më. Pija kafënë e prisja. Dhe me të vërtetë, pas pak gruaja filloi të fliste.

— ... Atë natë ... t'ja tregoj varrit, kur t'i vete... Asaj nate gjermanët vetëm pinin e gërthisnin.

Gërthisnin e vinin te ne... E na fyenin e na kërcënoheshin... Menjëherë e kuptuam mendimin e tyre. U bëmë një grusht. Hapu varr, të futemi... Vdekja ishte mjaltë... Ata na shihnin me ca sy të zgurdulluar...

Gruaja heshti.

— Po burrat? — e pyeta unë.

Në fillim ajo nuk e kuptoi. Pastaj tha:

— Ai ishte burg gjerman... dhe ata mund të të bënin ç'të donin... Ne si gra e kishim kuptuar që komandanti i tyre ishte një maskara. Disa net ai mbante një grua të panjohur në dhomë të tij... e pastaj na e fuste në qeli... Po ne e dinim... Kurse atë natë të gjithë ata ishin ashtu... Dhe ishin të pirë... Asnjëra prej nesh s'mendonte për plumbin... Ata e kishin vendosur... O! — gruaja kaloi dorën e vet nëpër ballë. E fërkonte atë dhe unë pashë si fytyra e zgjatur filloi sërish të tkurrej.

— Ndofta gabova që erdha pa ju lajmëruar, — i thashë unë. — Ju duhet të më falni.

— Si tani më kujtohet, kur u ngrit nënë Fetua. E gjatë, me çitjanet e saj të zeza e të gjera, plaka u ngrit e na tha: «Çupa, mos u trembni. Mbahuni, se ua rregulloj unë atyre qafirëve...» — Kapërceu mbi ne e shkoi drejt e te dera. SS-i, që ruante, e ndali, po plaka i gërthiti atij: «Ku e ke komandantin tënd?» — Dhe shkoi drejt e në dhomën e togerit. Atje ata po pinin. Gërthisnin. Nënë Fetua qëndroi te dera. «Dëgjoni» — u tha. Gjermanët, kur e panë në fillim, u çuditën dhe heshtën. Pastaj ja shkrepën të qeshurit. Gjithë burgu ushtonte prej të qeshurave e të thirrurave të tyre. Nënë Fetua ju drejtua ballistit, që ishte me ta. «Thuaju këtyre» — i tha ajo — se

mund të na vrasin kur të duan e të na hedhin tej, si kërmë. . . Ajo është punë e tyre. Po mos, o zot, të guxojnë e të vënë dorë mbi nderin tonë. . . Ta dinë, që edhe nga varri të vdekur do t'i nxjerrim e do t'ua marrim prapë shpirtin. . . » Nënë Fetua u kthye te ne e na tregoi se ç'kishte ndodhur. Neve na dukej sikur burgu s'merrte më frymë. Kur dëgjuam kërcitjet e këmbëve të tyre. Para derës së qelisë sonë u duk vetë komandanti. Mbante në dorë kamxhikun e tij të veshur me lëkurë. Pas qëndronte tërë trupi i SS-ve. Na shikonin e heshtnin. Komandanti thirri:

— Marsh. . . putana. . .

Ne e dinim ç'na priste.

Gruaja fliste shpejt e shpejt. Fërkonte ballin me dorën e saj të djathtë. Shikoja atë vijëzë të zezë, që shkante e humbte gjer lart rrëzë flokëve të asaj gruaje. Fytyra i ishte tkurrur e gjitha. Ajo nervozohet me veten, sepse ato skena kishin mbetur të freskëta, të freskëta në kujtesën e saj. Ajo dëshironte t'i harronte, po s'mundte. . .

Ngrita kryet e pashë mbi vete një degë ulliri. Këputa një bisk të mbushur me kokrra të zeza, të pjekura. Kërkoja nëpër to ndonjë kokërr të vyshkur. Kur ishim të vegjël, ne ato i hanim të gjalla. Shëtija nëpër ato kodra me ullinj e po mendoja për kohërat. Ato shembëllejné me njerëzit. Dhe ashtu si ata, shikojnë edhe ato njëra-tjetrën. Unë dhe ajo gruaje me atë vijëzë të thellë në ballë. Ajo vajza, që, punonte në fermën e portokallave dhe ai ish — i burgosuri, që kishte shpëtuar gjallë nga kampi i Dahaut e ishte kthyer sërish atje, tek ajo

shtëpi e verdhë, burgu i dikurshëm. Si e shikonin ata njëri-tjetrin? Ç'kërkonin e ç'dëshironin të shihnin te njëri-tjetri? Unë e kuptoja, që ajo grua shtëpiake me fustan të gjerë nën të cilin lëvizte i tërë trup, nervozohet me vetë. Sikur donte të dilte jashtë vetes së saj, po nuk mundte. Sepse, edhe tani, ajo i kujtonte skenat, që më tregonte pikërisht ashtu, siç i kishte jetuar atëhere. Pikërisht ashtu: «në në Fatua kapërceu mbi ne...» ashtu, si atëhere. «Marsh, putana»... — thirri komandanti. Koha kalonte, ndërsa ato pamje qëndronin para saj të pashlyeshme. Dhe ajo vetë e njëjta brenda tyre. Dhe, kur rrëfente, ajo grua dëshironte që edhe unë t'i shihja ato ditë ashtu, si i kishte parë ajo vetë. Ashtu. «Ne atëhere e ndanim bukën, që i vinte shoqes në qeli, në pjesë të vogla, të barabarta, duke i peshuar në dy pëllëmbët, si kandar...» Dhe ajo shtrinte e peshonte para meje të dyja duart e saj. Ndërsa unë mendoja se Q.D. nuk jetonte më. As nazistët nuk ishin më. Ata ishin zhdukur prej tokës sonë. Unë shikoja vetëm atë grua, që zgjatte para meje dy duart e saj, si dy krahë peshoreje. Kjo ishte për mua skena më e gjallë. Të tjerat ishin të gjalla vetëm për atë, gruan. Kohërat shohin te njëra-tjetra atë, për të cilën kanë nevojë. Atë që dëshirojnë ato. Ai burri, ish-i burgosur, që ishte kthyer sërish atje, ndofta i shikonte ato shkallë, ato mure, ata gurë, si në ato ditë. Dëgjonte edhe tani në qetësinë e plotë zërat, klithmat, zhurmën e atij burgu. Ndërsa ajo vajza, që punonte në fermën e portokalleve, nuk shihnte asgjë të tillë tek ato mure. — Shtëpi, si çdo shtëpi. Dhe duke qëndruar para atij burri disi të habitur, ajo i shihte ato ditë te vetë ai, që i kishte jetuar. Ai vetë, ndofta, ishte më i rëndësishëm për të.

Atëhere mjekja kishte qenë vajzë fare e re dhe kohën e burgut e mbante mënd shumë mirë. «Asaj nate, më thoshte ajo, brenda në burg papritur u shkreh mitralozi. Shkrepi pothuajse mbi kryet tona. U tund gjithë burgu. Kurrë s'kishte ndodhur një gjë e tillë. Shtangëm në vend. Ç'të ishte vallë? «Sigurisht kanë vrarë dikë» — tha njëra. «Po cilin?» «Atë... — tha Q.D... atë...» dhe e kuptuam, që ajo fliste për të kunatin. «Ai ka qenë kunati... ai ka qenë vëllai im» — tha pastaj e trishtuar... Pas pak mbi qelinë tonë u dëgjuan këmbët e rënda të SS-ve. Dera u hap.

— Q.D. — thirri njëri prej tyre.

Ajo u ngrit. SS-i e la sa kaloi prakun e mbylli derën me furi. Mbetëm vetëm. Kurrkush nuk guxonte të thoshte një fjalë. E kuptuam: atë do ta vrisnin. Prisnim me ankth. Prisnim. Nuk dëgjohej asgjë. Ndofta vazhdonin ta pyesnin, ndofta po e rrihnin... Kërrr... Ishte po ai mitraloz, që shkrepiti pak më parë. «E vranë», menduam menjëherë të gjitha. Të heshtura shikonim njëra-tjetrën në sy. Si fëmijë jetimë. Atëhere dikush tha: «Tani mbetëm vetëm... Q.D. nuk është më.» Ne të gjitha e mendonim atë, por, kur e dëgjuaam prej asaj tjetrës, sesi na erdhi. Nuk donim të besonim se ajo nuk ishte më...

Atë e sollën ndaj të gdhirë. Nuk u besonim dot syve kur e pamë. Zbathur. E torturuar. Nuk fliste dot. Copa-copa na tregoi se ç'i kishte ndodhur. Togerit SS-ve e kishte marrë vetë në pyetje. I kishte thënë:

— E dëgjove mitralozin?

— Po.



— Tët kunat e vramë.

Ajo s'ishte përgjegjur.

— Tani është radha jote.

— Ti i njeh dhe duhet të na tregosh komunistët e qytetit e të fshatit, bazat e tyre. Ti i di...

Ajo kishte heshtur.

— E harrove kunatin?

Befas pas saj ishte shkrehur mitralozi. Q.D. s'kishte lëvizur prej vendi. Vetëm kishte parë gjermanin në sy. Atëhere ai e kishte qëlluar. Me gjithë urrejtjen e vet. E kishte qëlluar me grushte, me shqelma. Pastaj e kishin nxjerrë jashtë. E detyruan gjithë natën, zbatuar e zhveshur të vinte rrotull burgut. Tërë natën. Në të gdhirë e sollën te ne.»

Më në fund kisha në duart e mia një ditar, një radhua të vogël shënimesh, me një mbulesë të hollë kartoni të bardhë, ku me kalem ishin hequr vija të zhgaravitura të padukshme. Radhoi ishte mbështjellë me një shami të pastër, të hekurosur mirë.

— Të lutem, të ma kthesh prapë — më tha punëtorja e kombinatit të peshkut duke më lëshuar me kujdes në duar atë fletore të mbështjellë me shami të bardhë. Nuk ja kam dhënë askujt; as fëmijët e mi nuk e dinë, që unë mbaj një kujtim të tillë nga tezja e tyre.

— Sa vjeçe ishte atëhere motra?

— Gjashtëmëdhjetë — tha punëtorja — po ajo vuante prej tuberkulozi e vdiq gjashtë muaj pasi doli prej burgu. Menjëherë pas saj vdiq edhe nëna. Të lutem, të ma kthesh prapë, këtu brenda është motra ime.

Gruaja i tha ato fjalë vetiu, pa kërkuar mendimin e saj dhe unë menjëherë e besova, se për atë njeri motra e ydekur qëndronte aty, midis fletëve të atij radhoi të vjetër e jo atje në vorrezat e qytetit.

Faqet e para s'kishin asgjë. Nëpër to ishin përhapur pika vaji e dylli qiriri. Disa fletë edhe ishin djegur prej qiririt e disa fjalë të shkruara nuk mund të shkoqiteshin. U përpoqa t'i deshifroja ato gërmagati të padukshme, po ishte e pamundur. Në faqen tjetër ishte shkruar vetëm një emër: Jeta. Ky emër i vetëm. Në dy faqet e tjera asgjë, pastaj po ai emër: Jeta. Emri i asaj të burgosur, mendova. Unë kisha harruar ta pyesja të motrën punëtore se si quhej ajo vajzë, që i kishte mbajtur ato shënime. Në një fletë tjetër nuk ishte shkruar asgjë, po vetëm, si me një dorë fëmije ishte vizatuar një pemë, me ca degë e gjethe të gjata, që dilnin tufë njëra mbi tjetrën. Dhe tutje nën trungun e pemës ishin hequr dy vija në formë kryqi. Në krye të vijës vertikale një pikë e zezë e madhe. Rreth asaj pike ishte përpjekur të vizatonte një helmetë, që i ngjante më shumë një çanaku të zakonshëm qumështi. Duke parë me vëmendje ato vija, përfytyrova postblokun e burgut. Sigurisht që ajo pema me gjethe e degë të gjata ishte palma, dhe ai, që mbante në kokë helmetën, — roja. Njeriu që i kishte vizatuar ato nuk kishte asnjë të dhënë për pikturë, po me sa dukej vizatonte vetëm një objekt që i qëndronte përherë në sy. Në fletën tjetër ishte vizatuar një fytyrë e re gruaje; kështu m'u duk mua në fillim, po pastaj, duke parë me kujdes nofullat e prera të asaj fytyre, ndërrova mendim e thashë me vete se vizatimi shprehte një djalë. Edhe në anën tjetër të asaj flete, po ajo fyty-

rë ishte vizatuar, po edhe flokët (tani ata ishin më të dendur dhe më të zezë) edhe balli, edhe sytë lëviznin, kurse te qafa ishte ngjitur një si kënd, molla e adamit, mendova. Atëhere dallova dy gërma të shkruara nën atë kokë. Lëçita ngadalë: Ai... Cili ishte «ai»? Pra mashkull, djalë... Cili ishte ai? Ish-te koka e ndonjë njeriu në burg, apo e ndonjë tjetri, për të cilin e burgosura mendonte në ato ditë? Fletët që vinin më pas ishin të pashkruajtura e gjithë pika vaji e dylli. Ndofta mbi to kishin ngulur qirinj për të ndriçuar qelinë e errët. Në faqen tjetër prapë një pikturë, një kokë peshku, koka e një kocé, e madhe, pafkë, me gojë të hapët, me dy sy të zez, vetëm ajo kokë, që mbulohej me vija të lehta të përkshkuara nga maja e kalemit. Dallgët e detit? Njëpr ato vija, tej nga ana e djathtë e faqes ishte shkruar prapë me gërma të vogla ai emër: Jeta. Aty ishte shkruar edhe diçka tjetër, që unë nuk munda e nuk munda ta zbërtheja dot. E ktheva atë faqe e pas saj lexova: 3 janar 1944. Nëna më solli një palë çorape të leshta. I mbatha menjëherë. Të vjetrat ja dhashë Anës. Kush ishte ajo «Anë»? Nga gjithshka që kisha mësuar gjer atëhere, nuk më kishte zënë veshi ndonjë të burgosur me emrin Anë. «Duhet ta kërkoj atë», thashë me vete. Në faqen tjetër ishin vizatuar dy sy njerëzorë, pranë njëri-tjetrit, me dy vetulla të harkuara lart. Sytë shihnin përherë drejt atij, që i kishte vizatuar. Nën ta, po ato dy gërma: Ai. Ngado që ta rrotulloje, atë fletore, ata sy ishin aty, të vizatuar fare keq nga një dorë e ngathët, se prej tyre nuk mund të dalloje dot diçka të veçantë. Kurse nën ata sy ishte shkruar: Ai — Vetëm «ai»? Ajo vajzë në ata dy sy të çfarëdoshëm njerëzorë, që mund t'i

vizatonte çdo nxënës shkolle, dallonte vetëm: Atë. Faqja tjetër më habiti fare. Nga një pikë e vetme hiqeshin një tufë vijëzash të drejta, të zeza, që shpërndaheshin nëpër letër, si tufë rrezesh, midis hapësirave të tyre ishin shkruar me gërma fare të vogla fjallë të ndryshme. Lexova: Natë. Natë. Natë. Natë. — tmerr. Tmerr. Presim me ankth të internohemi. Nëpër vija: Internimi — Poloni. Internimi. Në një vijë: Thonë se gjermanët ata që i internojnë i vrasin rrugës. . . Ajo vajzë kishte patur frikë të mbante ditar të rregullt. Shënimet e pakta, të thjeshta, i mbante brenda atyre zhgaravinave figurative, abstrakte, do të thoshte dikush. Tani unë nga pak po hyja nëpër botën e panjohur të asaj vajze të vogël të burgosur, që kishte lënë ato ditë të saj nëpër faqet e vjetra të atij radhoi. Ajo ndofta dhe fare rastësisht i kishte mbajtur atëhere ato shënime, mbi të cilat unë, tani, i përkulur po lexoja: 28 Janar 1944. Sot na thanë se P.M. paska dalë prej burgu. Prindërit e tij i paskan dhënë 100 napolona flori togerit gjerman dhe ai vetë e paska marrë dhe e paska çuar në dyqanin e një këpucari. Prej andej P.M. paska shkuar pastaj në fshat. Ai ditar ishte copa-copa. Unë u ktheva përsëri e nisa ta shfletoja edhe një herë qysh nga faqet e para. M'u duk sikur ajo vajzë dëshironte të fliste në çdo vijëzë, me çdo gërmë, me çdo figurë që shkruante aty. Po ajo kishte qenë fatkeqe, nuk kishte patur asnjë të dhënë në pikturë, kurse imagjinata i punonte në atë drejtim. Nuk kishte dyshim se pema në fillim ishte palma, poshtë roja dhe (unë tani po e dalloja) vija në mes ishte trangu, që mbyllte postbllokun. Po ajo kokë keceje, që notonte midis valëve të detit, me atë

gojë të hapët? Valët mos ishin vetë ato ditë? Mua kështu më pëlqen t'i shpjegoj tani, ndryshe ç'kuptim do të kishin ato, përveç asaj, që s'kishin asnjë kuptim? Në një fletë tjetër ishte vizatuar një krahu i hapët dhe i shtrirë shpendi. Krahu i fuqishëm ishte shtrirë në ajër e midis pendëve të tij ishte vizatuar pranga e të burgosurit, që mbaronte në një këmbë të zbathur njeriu. Asnjë shkronjë e asnjë shënim. Vetëm krahu i shpendit i shtrirë në tërë gjerësinë e vet, prangat, zinxhiri e përsëri prangat që mbërtheheshin në një këmbë të zbathur njeriu. Në faqen tjetër: 6 shkurt 1944. Na japin një lloj buke të zezë, të papjekur që të ngjitet në dhëmbë si brumë dhe që mban erë myk. Gratë bisedojnë dhe nuk e gjejnë dot prej se është gatuar kjo bukë. Dikush thotë prej himesh druri. Disa ditë me radhë nuk e hëngrëm dot, po pastaj nisëm ta përtypnim. Në faqen tjetër prapë ishte një vizatim. Një çizme gjermane, me majën pingul drejt diçkaje të lëmshtë, të zezë, që nuk kuptohej dot se ç'ishte. Çizma binte prej lart-poshtë (i dukej patkoi i thundrës) kurse nga toka, prej atij lëmshi ngriheshin ca vijëza që lëshonin ca si gishtërinj të vegjël, sapo çizma afrohej tek ai lëmsh. Poshtë ishte shkruar diçka, që unë s'po e lëçitja dot. Gërmat gati ishin shuar dhe vetëm një *b* dhe një *t* dalloheshin disi qartë. Pastaj asgjë s'mund të deshifrohej. Çdo të thoshte ai vizatim? Zhgaravitje e kotë? Me shkoj mëndja tek ato dhoma të mëdha e të gjera të asaj shtëpie-burg. Përfytyrova atë vizatim në ndonjë mur të atyre dhomave e me përmasa më të mëdha. Çfarë do të thoshte dhe si do të dukej ai vizatim

aty? Çizmja gjermane dukej fare e plotë, dukeshin goftë edhe në formë skeleti vijat, që përhapeshin si gishtat e dorës pranë saj. Pastaj një lëmsh i tërë vijash, që s'dihej se ku fillonin e ku mbaronin. Sapo kërkoja të ndiqja fillimin e njërës, pa pritur e kujtuar nëpër të më shpërthehej tjetra. E ktheva atë faqe. Pas ishte shkruar: 10 shkurt 1944. Sot na nxorën në sheshin e burgut, të gjithë, burra e gra, na rreshtuan e pastaj thirrën e nxorën para nesh një burrë plak, fshatar, të veshur me shajak. Filluan ta rrihnin me shqelma. Burri ra në tokë. Gjermani e rrihte dhe gërthiste fjalë, që ne s'i kuptonim. Burri me shajak rënkonte, mblidhej kruspull. Ai donte t'i ikte goditjes së rreshterit, por çizmja e tij e qëllonte. Duart e njeriut poshtë e mbërthenin atë çizme dhe nuk e lëshonin. Gjermani e goditte me shqelmin tjetër. Më në fund ai e goditi atë fort në brinjë. E goditi disa herë, dhe njeriu nuk lëvizi më. «Vdiq», tha dikush pranë meje. Vdekja e të burgosurit. «Domethënë, thashë unë me vete, vizatimi në faqen e parë qenka»: «Vdekja e të burgosurit»? E ktheva përsëri atë faqe dhe po vëreja me kujdes atë top vijash nën çizmen me patkua. Tani në mendjen time më bëhej sikur e zbërtheja atë vizatim. Ato, që drejtoheshin drejt çizmes me gishtërinjtë e thyer ishin duart? 18 Shkurt 1944. Mezi e takova nënën te dera e burgut. Ajo i kishte dhënë ca pako me duhan të mirë gardianit e ai na la të takoheshim. Nëna, sa më pa, qau. «E mjera unë, si qenke bërë kështu!» Unë kisha shumë ftohët, po nënës nuk i thashë gjë. Në fletën tjetër s'kishte asgjë. Ishin faqe të pastra e gati të reja, të papërdorura. Kurse pas tyre ishin vi-

zatuar pesë palë këmbë grash. Këmbët dhe gjunjët. Vetë gratë duket kishin qëndruar të mbështetura pas murit dhe kishin përthyer përpara gjunjët. Një palë gjunjë mezi mbuloheshin nga një fustan i vogël, ndërsa për dy të tjerë fustanët arrinin gjer poshtë te këmbët. Një palë gjunjë të tjerë ishin mbuluar me çitjane. Ajo? mendova unë duke kujtuar Q.D-en. Të jenë gjunjët e saj, ata të mbuluar me çitjane? Po ato çitjane, që ai merce-nari i goditte me shqelma asaj dite, kur ajo grua u pushkatua? Gjer atëhere ajo vajzë e re e burgosur, nuk kishte përmendur asnjë emër. Ajo, me sa duket, me veten e vet fliste më tepër me ato zhgarravina vizatimi, sepse druhej se mos ditari binte në duar të SS-ve. Nga gjithshka që kisha parë në atë fletore, ato pesë palë këmbë e gjunjë të vetëm në humbëti-rën e atyre mureve, m'u dukën më të trishtueshmit. Këmbët e mbuluara me fustanin e shkurtër ishin të vogla, të puqura njëra me tjetrën e gjunjët e tyre gati shkriheshin në një. Ato i mbulonte lart fustani e pa-staj asgjë nuk shihej (as trupi i njeriut). Kjo të jetë ajo. Jeta, mendova unë. Kërkova po s'pashë gjëkun-di asnjë germë të atij emri, që e kisha takuar disa herë në ato shënime. Këmbët e tjera, megjithëse pra-në njëra-tjetrës, përsëri ishin më të larguara se të parat dhe mbi kupat e gjunjve të tyre, sikur ishin vizatuar disa degëza merimangash. Kështu në të dyja kupat e gjurit. Duart. Duart e të burgosurve të vendosura mbi gjunjë. Edhe ato dy duart e atij të burgosuri, që vdiste nën goditjet e çizmes gjermane, ashtu ishin. Ktheva faqen tjetër, 20 Shkurt 1944.

Mbrëmë internuan 17 vetë. I dërguan në Poloni, thonë. Të tjerët thonë se i çuan në Gjermani. Neve gardiani na tha që të jemi gati se do të na internojnë. . . Kemi pritur gjithë natën në ankth. Po te ne s'erdhën. Në mëngjez na thanë se kishin internuar të tjerë. Në faqen tjetër kishte një vizatim fare të thjeshtë. Jo vetëm një dorë e ngathët, por edhe imagjinata e një fëmije të rëndomtë mund të vizatonte ashtu. Disa vija të përthyer në formë kodrash njëra mbi tjetrën. Në kulmin e një rës prej tyre ishte vizatuar një si shtëpi katrore me disa si tulla përsipër. Pastaj ca pushkë: dy vijëza të drejta e kondaku. Rreth mbarimit të dy vijave përhapeshin tufë pikash të zeza. Dhe asgjë tjetër. Unë hapa faqen, që vinte pas e atje lëçita: «Mbrëmë partizanët sulmuan qytetin». Tani për mua s'kishte asnjë dyshim se ajo vajzë e ré përpiqej të mbante shënime duke iu fshehur çdo zbulimi të SS-ve. Po pse ato vizatime aq naive e të parëndësishme? Punëtorja mua më tha se, kur e motra ishte e burgosur, kishte qenë 16 vjeçe, kurse ato vizatime sikur thoshin që ajo ishte më e vogël. Mua m'u duk sikur kisha rënë në një nga ditarët më të çuditshme, që ishte shkruar ndonjëherë në burgjet e SS-ve, që nuk dija si ta përcaktoja. Në faqen tjetër prapë një kokë peshku dhe valët e detit. Peshku notonte po ashtu me gojë e veshilëza të hapët. Në ato faqe nuk kishte asnjë shënim të shkruar. E ktheva atë fletë e nga pas lexova: 10 mars. Mbrëmë Q.D-en e prunë të rrahur, të vdekur. (Më në fund, thirra unë, më në fund ajo: Q.D.). E përplasën në qeli. E kishin rrahur aq tepër, sa e ki-



shin bërë blözë. Asnjëra prej nesh nuk guxonte t'i afrohej. Unë nisa të qaja, po nënë Fatua më goditi me pëllëmbë në fytyrë.

Q.D. Duke e shfletuar atë ditar, unë e kisha vendosur që kujtimet e asaj vajze t'ja jepja edhe Q.D.-es, sepse në fund të fundit jeta e një të burgosure, nuk mund të ndryshonte shumë nga ajo e një tjetre në atë burg. Tashmë unë isha fare i qetë. E kisha gjetur emrin Q.D. dhe ato kujtime nuk ishin më për mua transplantim në një trup të huaj, po në të njëjtin trup të atyre dy jetëve të burgosura. Faqja tjetër ishte mbuluar me njolla të mëdha vaji e midis tyre unë dallova disa shkronja, u përpoqa t'i lëçitja, po ishte e pamundur. Ato nuk kuptoheshin dot. I numrova, gjithsejt nja gjashtë a shtatë fjalë. Të pakuptueshme fare. Në faqen tjetër ishin shkruar thjeshtë: Për mjerime nuk ka lé rinia, skllavërinë dot ne s'e durojmë. Shihni se si zhduket skllavëria ... Ato fjalë ishin shkruar pikërisht ashtu në rresht, po unë e njihja atë këngë, që ne të gjithë e këndonim kur ishim të vegjël. Për mjerime nuk ka lé rinia. . . Ajo e këndonte atë këngë atje në burg me zë të ulët, apo atje e kishte mësuar dhe prandaj e kishte shkruar? Ndofta. 16 mars 1944. Jam shumë e sëmurë. Vetëm kaq. Fleta ishte e pastër. Dhe ishte shkruar qartë: Jam shumë e sëmurë. Shkrimi ishte pothuajse ai i faqeve të mëparshme, gërmat mezi uleshin mbi letër. Në fund të asaj faqeje. me gërma fare të padallueshme, shumë të vogla, ishte shkruar diçka: Nisa të lëçitja me zor: në Vlooorëëë çdooo natëëë bëhen interniiimeee... E ktheva faqen dhe u çudita, më në fund ajo kishte shkruar me shkrim thujajse të lirshëm një faqe të tërë të atij radhoi.

Tregojnë këtë histori: E shoqja e A.D., vëllait më të madh, nuk donte të jetonte bashkë me të kunatin, «nuk i laj dot brekët e tij — thoshte — më mjaftojnë m. . . e të tre fëmijëve të mi». Ata të dy ishin rritur jetimë, prandaj vëllai i vogël nuk donte të ndahej prej të vëllait e prej të nipërve, por mbrëmë, sapo ishte kthyer e kunata me të shoqin, e kishin rrahur dhe e kishin ndarë duke i dhënë vetëm rrobat e trupit, një dhomë të vogël dhe një shtrat për të fjetur. Të tjerat i kishin marrë ata vetë për të «rritur fëmijët». I dëshpëruar vëllai i vogël kishte dalë nga shtëpia, kishte pirë gjithë natën dhe ishte kthyer fare mirë. Pas ndonjë ore ishin dëgjuar të goditura të forta në derë, gjermanët thërrisnin: «A.D., dil jashtë, A.D. . .» Kishte qenë toga gjermane, që mblihdhte ata që internoheshin. Gjermanët godisnin nëpër errësirë, kurse gruaja brenda shtëpisë nisi të qante e të ulërinte, duke pushtuar të shoqin: «ku do t'i lësh, rrugëve fëmijët... Ku do të më lësh mua?» . . . Atëhere ishte ngritur vëllai i vogël, i kishte përshëndetur ata dhe nëpër errësirë u kishte thirrur atyre, që trokisnin te dera: «Unë jam. . .» Atë e kishin internuar.

Në faqen tjetër ishte vizatuar një shtëpi e vogël me tulla, rrethuar me tela, me një oxhak të vogël në majë të çatisë, që tymoste një bisht tym. Në oborr dukej një pus e pranë tij ishte shkruar: shtëpia ime. E ktheva atë fletë. 20 mars 1944. Bisedë.

— Të gjithë S S-ët do të zhduken?

— Të gjithë.

— Të gjithë?

— Ti nuk beson?

— Ata janë shumë. Gjermani, Francë, Rusi, Shqipëri, Jugosllavi, Greqi. . .

— Prandaj do të zhduken. Ti do jetosh se je e  
xë, unë s'do të jem.

— Si s'do të jesh?

— Ashtu, s'do të jem.

E kujt ishte ajo bisedë, me cilën bisedonte atë-  
here ajo vajzë? Faqet e tjera ishin fare të bardha e  
të paprekura. Unë i shfletoja ato një e nga një dhe  
vetëm nga fundi i radhoit, në një faqe qe vizatuar  
po ajo fytyrë e atij djali me tiparet e prera, me mo-  
llën e adamit të ngjitur në qafën e gjatë e poshtë  
ishte shkruar: Ai. 26 mars 1944.

Dhe asgjë tjetër.

Dhjetë ditë më vonë Q.D. ishte pushkatuar.

Sapo më nxorën prej qelie, pashë diçka të llah-  
tarshme: në të dyja anët e shkallëve, pranë njëri-  
-tjetrit, me helmata në kokë, me pushkë në supe,  
të heshtur, të ngrirë, qëndronin SS-ët. Tek-tuk mi-  
dis tyre digjej ndonjë qiri, që fekste mbi helmata e  
pushkë dhe luhatte hijet e frikshme të ushtarëve. Të  
përgjumur mua më tërhiqnin prej krahu dhe më  
dukej sikur pengohesha nëpër ato hije e nëpër ku-  
mbimin e hapave të mia. Nuk po përmendesha dot,  
nuk po kuptoja se ku gjendesha. Shkelja këmbëzba-  
thur nëpër ato hije të përbindshme. Atëhere pashë  
togerin, që qëndronte para meje. Po dridhesha e  
tëra.

— Prej shtëpisë sate dolën ata që vranë A.G.?  
— më tha ai.

— Jo — i thashë unë. — Në shtëpinë time atë  
ditë s'ka qenë fare njeri.

— Ne e dimë shumë mirë, ata, që vranë A.G.  
dolën prej shtëpisë sate.

— Nuk është e vërtetë — i thashë unë duke përsëritur po ato fjalë, që kisha thënë sa e sa herë.

— Mendo mirë — tha togeri.

Asnjëherë ai s'kishte folur aq i qetë, sa asaj nate. Prandaj dhe ishte më i frikshëm. Fytyrat e akullta të SS-ve shkriheshin në ngricën e bajone-tave të tyre.

— Mendo mirë — tha ai.

«Më çuan prapë në qeli dhe unë e përgjumur përsëri kaloja midis hijeve, që sikur ishin të gënjeshtërt, jonjerëzore...», — tha më në fund bibliotekarja.

— Njerëzit vetë tani nuk janë më ata, që ishin dikur. «Ecja zbathur midis hijeve të akullta të SS-ve...» Po nga të gjitha ato, që më tha bibliotekarja, për mua më interesant ishte mendimi se SS-ët ishin «hije të gënjeshtërt, jonjerëzore... Jo më pak të frikshëm e të përbindshëm. Jo. Por «jo e vërtetë, jonjerëzore»... Këtë e thá vetë ajo. Dhe këtë e shoh edhe unë tani. E ndjej, Gardhi i akullt i atyre hijeve vjen prej atyre ditëve të mjegullta gjer tek unë, kërcënonjës, kanosës. Dhe unë i shoh; ata janë të gënjeshtërt, jonjerëzorë... Vetë bibliotekarja e tha këtë. Tani e pa, prandaj dhe tani e tha. Kurse asaj nate, ajo me tjetër sy i shihte SS-ët. Ajo natë ndryshe e shihte veten e saj. «Ato hije të përbindshme, të frikshme... prapa ishin të gënjeshtërt, jonjerëzore...» Bibliotekarja tani shembëllen shumë pak me atë gruan me trup të hollë e nervoz nën fustanin shtëpiak, që nuk dëshironte të kujtonte asgjë. Po s'mundte. Kujtimet vinin tek ajo. Ndërsa kjo bibliotekarja me fytyrë të bardhë e të rrumbullakët, tani e kupton se SS-ët e llahtarshëm «prapë paskë-

shin qenë «të gënjeshtërt, jonjerëzorë. . .» Kështu e sheh ajo tani, kështu i sheh koha e tanishme. Kjo kohë nuk i shikon dot SS-ët si ajo natë. Dhe s'është e domosdoshme. Çdo kohë sheh, ashtu si sheh ajo. E, në qoftë se kjo është e padrejtë, atëhere këtë padrejtësi e bëjnë të gjithë brezat ndaj njëri-tjetrit. Të gjithë. Dhe atëhere nuk është më një padrejtësi. Dhe atëhere nuk duhet të ankohemi. Sepse, sado të dashur e të dhembshur që të jemi, mund të na thonë: hajt, mos u ankoni shumë. Asnjë padrejtësi s'po ju bëjmë. Vetëm se shikojmë me sytë tanë. . .

— Mirë, po jua them unë, ju shihni me sytë tuaj. . . po ama diçka shihni. . . Eh? Dhe ajo që shihni janë pikërisht ato ditë. Ato qëndrojnë kurdoherë para jush, ashtu si ajo statuja e bardhë e porsazbuluar prej toke qëndronte para nesh. Unë shkova atëhere në «Qytezë», siç e quante ai mësuesi, kodrën matanë lumit në fshatin e Q.D-es. Dhe e pashë bustin e bardhë. Plugu i traktorit e kishte gërvishur nga njëra shpatull në tjetrën. Por tërë busti ishte i paprekur. Prej atij busti na shihte njëgrua me ballë të gjerë e me sy të menduar, me gërshetat që i mbulonin gjirin. Traktoristi që e zbuloi, mësuesi e unë, heshtnim para saj e mendonim se ai bust kishte qëndruar me shekuj aty nën dhé. Mbi të me dramën, tragjeditë, komeditë e veta kishte rrjedhur jeta e atyre malësorëve të thjeshtë. Tani ai bust i bardhë, ajo kohë e shkuar, e porsazgjuar na shikonte me ata sy të menduar në ballin e gjerë. Dhe ne e shihnim gjithkush sipas vetes. Dhe ashtu i dilnim përpara njëri-tjetrit. Ajo grua në bust, ne të ngarguar me mendime për të.

Dhjetë ditë më vonë atë e kishin pushkatuar.

Ishin ato dhjetë ditë, që nuk më linin të arrija dot, tek ajo, që hapeshin me zbrazëtirën e tyre midis meje dhe asaj gruaje. Me se do të mbushej ajo zbrazëtisë? Me gjithë kërkimet e mia të pandalshme, askush nuk mund të më tregonte mua diçka tjetër, të panjohur mbi jetën e asaj gruaje. Thua sikur jeta e Q.D-es kishte mbaruar aty, dhjetë ditë para pushkatimit. «Anën», që e përmendte në radhoin e vet vajza e re e burgosur, nuk e kishte njohur kurrkush. Ndofta e kishin sjellë aty përkohësisht e pastaj e kishin transferuar në ndonjë burg tjetër. Tani unë kisha mbetur vetëm me Q.D-en dhe me ato dhjetë ditë, që më ndanin prej vdekjes së saj. Më në fund askush tjetër nuk mund të ndërhynte më midis nesh. Të gjithë, edhe ai burri i saj i dikurshëm, edhe berberi, edhe ai pensionisti trupmadh e babaxhan, ishin larguar dhe kisha mbetur vetëm unë, ajo dhe vdekja e saj. Zbrazëtira e atyre dhjetë ditëve nuk kishte me se të mbushej, veçse me vetë vdekjen e Q.D-es. Dhe unë për atë mendoja tani. Gjatë kërkimeve të mia kisha mësuar se nazistët, asaj dite prilli '944, kishin marrë më parë prej burgut të katër burrat dhe i kishin çuar te xhamia e tabakëve.

— Mos na prishni — u kishte thënë atyre shehu.

SS-ët kishin qëlluar. Pastaj me veturë kishin sjellë dhe Q.D-en.

— I sheh këta? — I kishin thënë asaj duke i treguar të vrrarët. — I sheh këta qenë...

— Ata s'janë qenë — kishte thënë ajo. — Ata janë luftëtarë të lirisë...

Atëhere togeri nazist i kishte rënë pas kresë

me parabel. Ajo ishte përmbysur midis shiut dhe gjakut të vet, atje në mes të asfalteve të qullura.

Këto kishin qenë fjalët e saj të fundit. Kështu më kishin thënë mua. Po ç'efekt do të bënin ato fjalë te njerëzit pas 25 vjetve? Fjalët, edhe ato sikur u ngjajnë monedhave, humbasin shkëlqimin e tyre prej përdorimit të tepërt e papandehur në ndjejmë se si po ato fjalë, që dikur i bënin njerëzit t'u kërcente gjaku në majë të kresë, lëshojnë heraherës tingëllime fare të njohura e të përdorura në buzët e kohëve të mëvonshme. Unë druhesha se mos ato fjalë, që ajo kishte folur atëhere, para vdekjes së vet, do të tingëllonin skematike për ditët e sotme, prandaj gjithë atë zbrazëtirë të atyre dhjetë ditëve, që më ndanin nga 4 prilli 1944 unë i mbushja me forma të ndryshme të vdekjes së asaj gruaje. Ja, njëra prej tyre:

... Q.D. e dinte që do ta pushkatonin.

Atë ditë u hap fjala se në frontin rus ishte vrrarë vëllai i togerit. Atë e lajmëronin me një letër nga shtëpia mbi vdekjen e të vëllait. Gjithë ditën ai nuk ishte dukur në burg dhe u kthye vetëm në mbrëmje. Ishte çuditërisht i qetë dhe, sa u kthye në dhomë, dha urdhër që t'i flisnin Q.D-es.

Gruan e çuan atje. Togerit kishte shkopsitur xhakëtën dhe po rrinte i menduar në karrige. Fytyra e tij ishte e davaritur. Ashtu qëndroi ai për një kohë, kur u kthye e pa Q.D-en që rrinte në këmbë pranë derës së dhomës. I hodhi një shikim të gjatë, të akullt.

— Ti je komuniste? — E pyeti frengjisht.

— Po.

— Pse je komuniste?

— Po ti, pse je nazist? — Gruaja i tha ngadalë ato fjalë po zëri i saj u drodh.

— Ti ke qenë në Paris?

Togeri ishte i qetë.

— Po.

— Edhe unë kam qenë.

— Kur?

— Më 1942.

— Ahere paskemi qenë atje për qëllime të ndryshme.

— Natyrisht — tha gjermani — unë s'kisha ndër mend të shkoja në Paris që të bëhesha komunist.

Gjermani e vërejti prapë gruan me atë shikimin e gjatë, hetues të tij. Gjithshka te ai njeri, që nga flokët e gjer te vetullat e sytë, ishte e verdhë, bionde. Kishte një trup mesatar, të shkathët nën atë xhaketë ushtarake të shkopsitur. Kishte shtrirë këmbët përpara e, pasi shikoi gjatë Q.D-en i ktheu sytë mbi çizmet e tij të zeza. Po shikonte ato, kur tha ngadalë:

— Ty do të të pushkatoj me duart e mia...

Dhe gruaja e besoi menjëherë. Ai e kishte vendosur. Gruaja qëndronte atje, më këmbë, e heshur, te dera e dhomës, kur togери tha:

— Biseda jonë mbaroi.

Q.D. u kthye pas e mori të dilte.

— Si të duket? — erdhi gjer tek ajo pyetja e oficerit nazist.

Gruaja ndali në vend.

— Si të duket? — pyeti përsëri gjermani frëngjisht.

— Diçka naziste — tha ajo.

— Dëgjo — togери gati sa s'kërceu nga karrig-



ja e shkoi te dera. — Dëgjo — tha, duke i he-  
dhur dorën e vet në sup, pastaj në leshra... — Ti  
je grua e bukur... dhe unë do të të pushkatoj me  
dorën time.

Q.D. qëndronte e palëvizur para tij.

— Ti s'e di — tha gjermani — po unë në  
ëndërr, nëpër gjumë kaq herë të kam pushkatuar  
ty. Por çdo vdekje ishte e lehtë... Ti meritoje një  
tjetër vdekje... Një tjetër...

Q.D. qeshi. Në qetësinë e akullt të burgut e të  
natës, ajo qeshi rrëmbyeshëm.

Gjermani e pa i çuditur.

— Ju më dhatë sot gëzimin më të madh të je-  
tës sime — i tha ajo nazistit.

Fytyra e gjermanit u hutua. Ai s'po kuptonte  
asgjë.

— Kurrë s'kam qenë kaq e lumtur — tha grua-  
ja. — Vetëm një armik i vërtetë mund të urrehet  
ashtu. Unë jam armike e betuar e nazistëve... —  
Duke qeshur ajo kaloi prakun e doli te dera. Gjermani  
nuk e ndali. Ai nuk e pengoi as kur ajo thirri:  
«Mbahuni, shokë! Ky është fundi i fashistëve. Ata  
janë tmerruar nga ne... Nëpër tmerrin e tyre po-  
ngrihet bota jonë, po shkrep ajo, që më në fund  
edhe ne mund ta quajmë jetë... Nëpër tmerrin e  
tyre...»

Togeri nazist e shihte nga dera gjysmë e hapur  
e dhomës së vet. Ajo fliste. Ashtu siç e kishin sjellë  
aty këmbëzbathur, me një fustan të hollë në trup.  
I fliste qetësisë së burgut, sepse e dinte, «qetësia»  
dëgjonte.

Ndofta kjo vdekje do t'i dukej pak interesante  
kohës së tanishme? Atëhere ja një vdekje tjetër:

Atë e nxirrnin para gjyqit. E akuzonin se ishte një terroriste e rrezikshme, se kishte luftuar kundër rendit të ri e prandaj dënohej me vdekje.

— Më vjen keq për ty — i thoshte pastaj një gjykatës i moshuar, me zërin e tij të përdhimbshëm. Më vjen keq për ty... Ndofta...

— Pse? — e pyeste ajo — unë vdes për lirinë e vendit tim.

— Për liri? — dhe gjyqtari plak nënëqeshte përdhimbshëm.

— Kur ne themi liri — thoshte ajo — nënkuptojmë bukën e punën, djersën e lirë, qiellin e këngën, zhdukjen e çfarëdo klase e shtypjeje; kur themi liri, ne nënkuptojmë barazinë e plotë të të gjithë popujve, të të gjithë njerëzve, kur themi liri, ne nënkuptojmë një botë të re, pa lufta pa gjak...

— Pa luftë? — Thoshte gjyqtari e nënëqeshte. — Po do të luftojmë ne kundra jush — thoshte ai. Me mijëra e mijëra vjet kemi luftuar e do të luftojmë prapë. Dhe do të ketë përherë të mundur e fitonjës, të shtypur e zotërinj...

— Edhe ne po luftojmë me mijëra e mijëra vjet — thoshte ajo. Dhe do të vazhdojmë të luftojmë. Të shohim, kush do të lodhet? Ju — thoshte ajo — na thoni neve njerëzve të thjeshtë se, edhe sikur të mos ekzistonte zoti, duhej ta krijonim atë. Duhet të krijojmë një perëndi për veten tonë, dhe ky mund të jetë një Hitler, apo një Musolin. Po, kur ne e krijojmë zotin tonë në lirinë, ju tërboheni... Ju pranoni çdo zot tjetër për ne, po jo, kurrë lirinë tonë.

Atë e pushkatonin.

Ndofta kjo vdekje do t'i dukej më interesante

kohës së sotme? Po unë e dija se në të vërtetë Q.D. para vdekjes së saj u kishte thënë thjeshtë nazistëve:

— Ata nuk janë qenë... qenë jeni ju...

Dhe atë e kishin pushkatuar në atë ditë prilli 1944, kur në qytetin tonë të vogël binte papushim ai shi i hollë, i imtë. Ajo kishte rënë përmbys në pellg të gjakut të vet. Ashtu mbeti ajo për një kohë të gjatë në kujtesën time. Ai vizion i ngulur në trutë e mia më nisi nëpër gjurmë të jetës së saj. Po tani (gjë e çuditshme!), sado që dua të kujtoj atë ditë, partizanët e pushkatuar, vetminë dhe heshtjen e trishtuar të xhamisë, SS-ët me automatikë në dorë, turmën e njerëzve, sado që dua t'i kujtoj, prapë ato gjithnjë e më tepër largohen prej meje, shkrihen në atë fytyrën e vogël të asaj gruaje me ata trëndafila të bardhë në duar.

Unë u ula ta kapja, po vala e detit u tërhoq dhe guacka iku përsëri larg. Ndjeva se m'u lagën këmbëzat e pantallonave. Më në fund renda pas saj dhe e zura. Ajo ishte një guackë e madhe, me një ngjyrë të kuqërremtë fërfëritëse. Nëpër të ishin formuar ca gurë të vegjël kristali. Po e mbaja në duar, kur m'u kujtua peshkatari. Një ditë ai kishte ardhur tek unë.

— Të kam sjellë diçka të gëzueshme — më pati thirrur nga larg.

— Çfarë?

— Gjeje vetë...

— U mendova...

— Nuk mundem — i thashë.

— Gjeje... — ai po qeshte.

— Di unë...

— Kam kërkuar dhe ta kam gjetur... adresën e asaj...

— Të kujt?

— Të asaj...

S'po kuptoja asgjë.

— Po të kujt — i thashë i nervozuar.

— Të asaj vajzës, që shpëtoi nga vetëtima në majë të malit. E ëma vdiq. Ajo shpëtoi në djep prej druri. Është laborante në fabrikën KPM.

— Ti e ke kërkuar?

— Po dhe më në fund e gjeta. Duhet të takohesh patjetër — më tha.

Në femini përherë dilnim anës së detit e mblidhnim «xhixhivalle», si i quanim atëherë. Po ajo guac-kë, që papritur më kishte dalë përpara, ishte e rrallë. Unë e mbaja në duar, i gëzohesha dhe më kujtohej peshkatari.

— Po pse atë — i pata thënë unë atij — pse duhet të takoj vetëm atë?

Ai më ishte afruar fare pranë.

— Është ajo, që e qëlloi vetëtima.

— E di... po pse duhet të takoj vetëm atë dhe jo atë tjetrën?

— Cilën? — Zëri i tij përnjëherë ishte ftohur.

— Ti e kupton? Vetëtima ra... nëna u dogj... ajo... vetëm ajo shpëtoi.

— Ajo tjetra lindi në duart e asaj gruaje — i pata thënë unë... Kur artileria naziste gjëmonte e jashtë ulërinte ulkonja për këlyshët e vet.

— Po...

— Ajo ka kërthizën të lidhur prej asaj gruaje...

Peshkatarin më kishte parë në sy i menduar dhe kishte heshtur. Unë luaja me atë guackë të bukur, shikoja detin, kujtoja peshkatarin dhe mendoja.

«Jo, thoshja unë me vete, nuk kam për të takuar asnjë prej tyre. Nuk do t'i takoj ato. Nuk dua që, kur të jem para tyre, të mendoj gjëra të tjera e të tjera... Ku nuk mund të më shkojë mendja... më mjafton...»

Vala vinte gjer te këmbët e mia. Dëgjoja zërat e përhershëm të detit, që shkriheshin nëpër kokrriza të rërës.

— Unë nuk do ta takoj atë vajzën, sepse gjithshka që do të dëgjoj prej saj, gjithshka që do të mendoj për të... Po ç'do të mendoj? Që ajo është e re? Që ajo është e bukur? Ajo mund të jetë ja, si kjo që qenka ulur e po çlodhet tani anës detit, apo si ajo atje tej... E ç'rëndësi ka kjo? E rëndësishme është se, çfarëdo që të më tregojnë e të më thonë ato dy vajza tani, unë përsëri këtë do të mendoj e do të them: njerëzit janë si kohërat... po edhe kohërat janë si njerëzit... Edhe ato i lidhin kërkthizën në trup njëra-tjetrës.

---